

ABDURRAHMAN BIN NASIR ES SEADI


HISTORITË
Pejgamberëve
dobi dhe mësim



ABDURRAHMAN BIN NASIR ES SEADI

HISTORITË E PEJGAMBERËVE

Dobi dhe mësim



Përshtati në shqip:

Fatjon Isufi



Titulli: Historitë e pejgamberëve - *Dobi dhe mësim*

Titulli në origjinal:

قصص الأنبياء

Autori: Abdurrahman Bin Nasir Es Seadi

Përshtati në shqip: Fatjon Isufi

Redaktor gjuhësor: Qani Sulku

Kopertina dhe faqosja: Pelegrini

هذا الكتاب وقف لله تعالى للمرحومين:

فلاح مناحي الحربي

عائشة عبد الله الحربي

غفر الله لهما و رفع درجاتهما في العليين

Ky libër u botua me kontribute nga familja Al - Harbi.

Allahu i mëshiroftë dhe i shpërbleftë me Xhenetin Firdeus:

Falah Al Harbi

Aishe Al Harbi



© Botime: Udha e Besimtarëve

Botimi i parë - Tiranë, 2019

Përmbajtja

<i>Parathënie</i>	5
Hyrje	7
Ademi - Babai i njerëzimit	11
Nuhu - Babai i dytë i njerëzimit	25
Historia e Hudit	39
Historia e Salihut	47
Historia e Ibrahimit - Babai i peygamberëve	53
Historia e Lutit	79
Historia e Shuajbit	85
Historia e Jusufit dhe Jakubit	93
Historia e Musait dhe Harunit	113
Historia e Hidrit me Musain	133
Historia e Junusit	145
Historia e Daudit dhe Sulejmanit	149
Historia e Sulejmanit -Biri i Daudit	155
Historia e Ejubit	171
Historia e Dhul Karnejnit	175
Historia e Isait	181
Banorët e Shpellës	191
Historia e vulës së peygamberëve - Muhamedi	197



Parathënie

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut. Atë falënderojmë, prej Tij kërkojmë ndihmë dhe Atij i drejtohem i falë gjynahet tona. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu prej ligësisë së shpirtave tanë dhe të këqijave të punëve tona. Kë udhëzon Allahu, askush nuk mund ta devijojë dhe kush e humb rrugën, askush përveç Tij nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Një të Vetëm e të Pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi (alejhi salatu ues selam) është rob dhe i Dërguari i Tij.

Të flasësh për historitë e Pejgamberëve dhe ngjarjet e tyre, është diçka shumë tërheqëse. Kjo për faktin se në këto ndodhi ka mësim dhe këshilla shumë të dobishme. Allahu i Lartësuar thotë: **“Në tregimet e atyre (të dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend.”** (Jusuf, 111)

Përmes këtyre historive njeriu kujton kohët e popujve të hershëm dhe ditët e kaluara që ka krijuar Allahu i Lartësuar. **“Sigurisht që atyre u kanë ardhur histori për t’i prapësuar (nga e keqja).”** (ElKamer, 4)

Me anë të këtyre ngjarjeve zemrat e besimtarëve dhe besimtareve gjallërohen dhe bëhen më të qëndrueshme.

Disa dijetarë kanë thënë: “Historitë janë ushtri prej ushtrive të Zotit, me anë të këtyre historive Allahu i përforcon zemrat e të dashurve të Tij. Ajo që e dëshmon këtë është fjala e Allahut të Lartësuar që thotë: **‘Ne po t’i tregojmë ty disa nga historitë e të dërguarve, për të ta forcuar zemrën.’**” (Hud 120)

Gjithashtu, në përmendjen e këtyre ndodhive zbret mëshira e Zotit. Sufjan bin Ujejne (Allahu e mëshiroftë) thoshte: “Kur përmenden njerëzit e mirë e të devotshëm, zbret mëshira e Zotit.” Ndërsa profetët janë kreu i njerëzve të mirë dhe udhëheqësit e njerëzve të devotshëm.

Nisur nga këto që përmendëm, e pamë të arsyeshme të trajtojmë historitë e tyre dhe të nxisim njerëzit që të ndjekin gjurmët e tyre. **“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti (o Muhamed) ndiq rrugën e tyre.”** (En’am 90)

Libri që keni para duarve është një përpjekje në rrugën e njohjes së njerëzve më të mirë dhe shembëlltyrave më të përkryera. Në zanafillë kjo temë është pjesë e një libri të titulluar: “Tejsir Latijf el menan fi hualsati tefsiril Kur’an” të dijetarit Abdurrahman bin Nasir es Seadi, i cili është një përmbledhje e tefsirit të Kur’anit që ndihmon në kuptimin e tij dhe fton në meditim mbi ajetet e tij.

Në mbyllje i lutemi Allahut të na japë sukses në punët që Ai i do dhe me të cilat është i kënaqur, si dhe i lutemi që këtë punë ta bëjë të sinqertë vetëm për Të dhe tu bëjë dobi myslimanëve kudo që ndodhen. Vërtet Allahu i dëgjon lutjet dhe u përgjigjet atyre!

Eshref Abdul Meksud

Ismailije (Egjipt)

10 Ramazan i vitit 1414 Hixhri



Hyrje

Allahu i Lartësuar na ka rrëfyer në Kur'anin famëlartë ndodhi të bukura mbi jetën e profetëve dhe i ka cilësuar ato si historitë më të mira e më të bukura. Ky epitete (*historitë më të bukura*), që vjen nga Allahu i Madhëruar, është tregues se ato janë ndodhitë më të vërteta, më kuptimplotat dhe më të dobishmet për njerëzit.

Prej dobive më kryesore të këtyre historive veçojmë:

1. Nëpërmjet tyre, plotësohet edhe më shumë besimi te profetët e Allahut (Paqja e Zotit qoftë mbi ta). Edhe pse ne besojmë në përgjithësi tek të gjithë profetët, duhet të dimë se besimi i detajuar tek ata, shtohet edhe më tepër nga njohja me historitë e tyre. Nuk duhet të anashkalojmë edhe faktin se, Allahu thotë se ato histori dallohen për besueshmëri të plotë, cilësi unike, ç'ka ua ngre vlerën atyre, për shkak të mirësive dhe dobive që përçojnë te të gjithë llojet e njerëzve, madje ndikimi i tyre arrin deri te kafshët dhe kjo nëpërmjet këshillave dhe udhëzimeve sa i takon kujdesit ndaj kafshëve dhe angazhimit për të drejtat e tyre. Pra nëpërmjet këtij besimi të detajuar te profetët, njeriu arrin besimin e plotë dhe kjo konsiderohet prej faktorëve që e shtojnë imanin (besimin).

2. Në historitë e profetëve, pohohet besimi në të vetmin Zot - Allahun; njësimi, sinqeriteti në adhurime dhe besimi në botën tjetër. Ashtu sikurse sqarohet mirësia e Teuhidit dhe domosdoshmëria e tij, po ashtu sqarohet dhe kotësia e shirkut (idhujtarisë) si shkaku kryesor i shkatërrimit në këtë botë dhe në botën tjetër.

3. Nëpërmjet historive të peygamberëve, besimtarët marrin mësim dhe udhëzohen në të gjitha pjesët (shkallët) e fesë: - Në pjesën e teuhidit dhe zbatimit të adhurimit; Në pjesën e thirrjes (davitit), durimit dhe qëndrueshmërisë në të gjitha sprovat shqetësuese, për t'i përballuar me qetësi, dinjitet dhe qëndrueshmëri të plotë; Në pjesën e vërtetësisë dhe sinqeritetit ndaj Allahut në të gjitha lëvizjet dhe qëndrimet, duke sjellë ndërmend shpërblimin tek Allahu i Lartësuar. Për të mos kërkuar nga krijesat shpërblim, shpagim dhe as falënderim, përveçse çfarë është në dobi të tyre (krijesave).

4. Gjithashtu nga këto histori mësojmë: Unanimitetin e profetëve në një fe të vetme dhe në baza të njëjta; thirrjen e tyre në vlera të larta morale dhe në punë të mira, si dhe qortimin ndaj veprimeve që bien ndesh me to.

5. Në historitë e peygamberëve, përfitojmë edhe dobi nga fikhu (jurisprudenca), dispozita fetare, fshehtësitë e të gjykuarit dhe shumë çështje madhore, të cilat nuk mund t'i anashkalojë një kërkues i dijes.

6. Tek historitë e peygamberëve, gjejmë këshillimin dhe përkujtimin, frikësimin dhe shpresëdhënien, lehtësimin pas vështirësisë, zgjidhjen e çështjeve pas ngërçit të tyre dhe frytet e mira që janë vënë re në këtë botë, si dhe përmendjen e mirë dhe dashurinë në zemrat e njerëzve. E gjithë kjo është përgatitje

për të devotshmit, gëzim për adhuruesit, ngushëllim për të pikëlluarit dhe mësim për besimtarët. Qëllimi i ndodhive të peygamberve, nuk është thjesht rrëfimi i tyre përgjatë netëve të gjata, porse qëllimi primar i tyre është, që të shërbejnë si përkujtim dhe këshillë.

7. Para se të fillojmë, duhet të dimë se, shumë prej historive të profetëve, Allahu i ka përsëritur disa herë në mënyra të përshtatshme sipas situatës. Ndoshta diku përmendet diçka që nuk e hasim diku tjetër, ose përmendet me shprehje dhe fjalë që nuk përsëriten në historinë tjetër, edhe pse kuptimet janë të njëjta apo të përafërta.

8. Nisur nga kjo parantezë, do t'i përmendim dhe do t'i përmbledhim këto ndodhi në një vend, duke treguar kujdes në përdorimin e termave që janë përmendur në Kur'an, nga fillimi i historisë e deri në fund të saj.

9. Gjithësecilës prej historive të peygamberëve, do i bashkangjisim dobitë bazë dhe ato dytësore që ajo përçon, si dhe dobitë që kanë të bëjnë me vlerat morale, mirësjelljen dhe shumë tema të tjera. Shpresojmë tek Allahu që të na japë sukses në këtë punë; t'u përmbahemi fjalëve pa i deformuar; ta kryejmë këtë punë me zemër të sinqertë, ashtu siç do Allahu; të na mundësojë nëpërmjet kësaj pune, dobitë e përgjithshme. Vërtetë Ai (Allahu) është Bujar dhe Fisnik (i përgjigjet lutjes).

Abdurrahman bin Nasir es Seadi

(Allahu e mëshiroftë)



ADEMI

Babai i njerëzimit

Allahu është i Pari pa fillim dhe i Fundit pa mbarim. Ai vepron gjithçka që dëshiron. Asnjë moment dhe asnjë kohë, nuk është e zbrazët nga veprimet dhe fjalët që dalin nga vullneti dhe dëshira e Tij, ashtu siç i shkon përshtat urtësisë së Allahut, të Cilit i atribuohet kjo cilësi (Urtësia) në çdo gjë që paracakton dhe gjykon. Kjo (Urtësi) është e dukshme edhe në dispozitat që ka ligjëruar për robërit e Tij.

Në momentin kur Urtësia e Tij e plotë, Dija gjithëpërfshirëse dhe Mëshira e gjerë kërkoi (një krijim të ri), Ai krijoi Ademin, babain e njerëzimit. Një krijesë të cilën Allahu e ka nderuar në mesin e shumë krijesave të tjera. Ai (Allahu), i njoftoi engjëjt duke u thënë: **“Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë”**. (El Bekare, 30) Që do të trashëgojë krijesat që qenë më parë, krijesa të cilat nuk i di askush veç Allahut.

Ata (engjëjt) i thanë: **“A do të vendosësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të.”** (El Bekare 30)

Këto fjalë (engjëjt) i thanë në shenjë madhërimi dhe nderimi ndaj Allahut, për të kuptuar se mos do të krijohet një krijesë, e cila u ngjan në sjellje disa krijesave të mëhershme. Ose mundet që Allahu t'u ketë treguar për krijimin e Ademit dhe veprimet e pasardhësve të tij.¹

Por Ai (Allahu) u tha engjëjve: **“Unë di atë që ju nuk e dini”**. (El Bekare, 30)

Dija e Tij është gjithëpërfshirëse. Madje ajo përfshin të gjitha ato dobi të panumërta që rezultojnë në krijimin e kësaj krijese (njeriut). Ai i njoftoi për dijen e Tij të plotë dhe u kërkoi të njohin atributet e Tij, dijen e gjerë dhe urtësinë e cila aludon në faktin se, Ai nuk krijon asgjë kot së koti dhe nuk krijon asgjë pa urtësi.

Më pas u tregoi në mënyrë të detajuar, se atë (Ademin) e krijoi me Dorën e Tij, në shenjë nderimi dhe vlerësimi ndaj çdo krijese tjetër. Ai mori një grusht dhé nga të gjitha shtresat e tokës, pjesës së butë dhe të fortë, të mirës dhe të keqes, ku edhe pasardhësit e Ademit do të kishin të njëjtat veçori dhe karakteristika.

Fillimisht (Ademi) ishte dhé, pastaj mbi të hodhi ujë dhe u shndërrua në baltë. Kur uji mbi baltë qëndroi për një kohë të gjatë, balta ndryshoi ngjyrë duke u bërë e zezë dhe pa formë. Më pas (balta e zezë) u tha dhe pasi ia kishte dhënë formën, u bë si baltë e pjekur dhe e ngurtë, ku nëse e çukisje nxirrte

¹ Hafidh ibn Kethir (Allahu e mëshiroftë) thotë: “Ai u tregoi për të vënë në dukje krijimin e Ademit dhe pasardhësve të tij, ashtu siç ndodh kur jepet njoftim për një çështje të madhe para se ajo të ndodhë. Engjëjt pyetën si për të zbuluar dhe për të ditur urtësinë e këtij krijimi dhe jo për ta refuzuar apo për ta quajtur të mangët njeriun, apo në shenjë smire, siç mund ta mendojnë disa injorantë që mundohen të komentojnë Kur'anin.” (El Bidaje uen Nihaje 1/70-71)

tingull sikur godasim gurin. Në këto etapa ai (Ademi) ishte trup pa shpirt dhe kur u plotësua krijimi i trupit, Ai i fryu shpirtin dhe ky trup që ishte i ngurtë, u bë krijesë e gjallë, me eshtra, me mish, nerva, damarë dhe me shpirt. Kjo është zanafilla e njeriut, të cilin Allahu e pajisi me çdo njohuri dhe mirësi.

Më tej, ia plotësoi mirësinë (Ademit) duke i mësuar emrat e të gjitha sendeve dhe siç dihet, njohuritë e plota janë tregues për përsosmëri maksimale dhe vlera të larta morale.

Allahu deshi që engjëjt ta shihnin përsosmërinë e kësaj krijese, kështu që sendet ua paraqiti engjëjve duke u thënë: **“Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!”** (El Bekare, 31)

Fjalët tuaja të para nënkuptonin se mos-krijimi i njeriut është më parësor, mendim i cili ishte momental dhe ashtu iu duk atyre (engjëjve) se do ishte më e mira. Megjithatë, ata e patën të pamundur të dinë emrat e sendeve që iu paraqitën dhe thanë: **“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.”** (El Bekare, 32)

Allahu i Lartësuar tha: **“O Adem, - tha Ai - tregojua atyre emrat e gjërave!”** Kur ai ua tregoi emrat e tyre...” (El Bekare, 33)

Engjëjt e dëshmuan përsosmërinë dhe njohuritë e kësaj krijese dhe gjëra të tjera që nuk i prisnin. U njohën me të në formë të detajuar; dëshmuan gjithashtu urtësinë e plotë të Allahut dhe e nderuan Ademin në maksimum. Allahu deshi ta shfaqte nderimin dhe respektin e engjëjve ndaj Ademit si në dukje ashtu edhe në fshehtësi e brendësi, duke u thënë atyre: **“Përluni në sexhde para Ademit”** (El Bekare, 34)

Përluni në shenjë respekti dhe nderimi, si dhe në shenjë adhurimi, bindjeje, dashurie dhe nënshrimi ndaj Zotit tuaj.

Të gjithë u përlën në sexhde me nxitim, ndërkohë që Iblisi ishte mes tyre dhe urdhri për t'u përlur ishte për të gjithë, përfshirë edhe atë bashkë me engjëjt, edhe pse nuk ishte prej llojit të tyre (engjëjve), por ishte prej xhindëve, i krijuar nga zjarri pa tym. Ai e mbante fshehur mohimin ndaj Allahut dhe smirën që kishte për këtë njeri, të cilin Allahu e kishte dalluar me këtë nder që po i bëhej.

Mendjemadhësia dhe mohimi e shtynë (Iblisin) që të mos përluj para Ademit, duke shfaqur hapur tani mosbesimin e tij ndaj Allahut në njerën anë dhe duke treguar mendjemadhësi në anën tjetër.²

Ai nuk u mjaftua me kundërshtimin ndaj urdhrit të Zotit, por shkoi më tej duke e konsideruar të padrejtë urtësinë e Allahut në lidhje me njeriun, e për këtë tha: **“Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijoje nga zjarri, kurse atë e krijoje nga balta.”** (Arafë, 12)

Allahu i tha: **“O Iblis, ç'të pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij që e kam krijuar Vetë me duart**

² Allahu i Lartësuar tha: “Kur u thamë engjëjve: ‘Përluni në sexhde para Ademit’, ata u përlën, përveç Iblisit. Ai ishte një nga xhindet dhe nuk iu bind urdhrit të Zotit të vet.” (Kehf 50) Hafidh ibn Kethir (Allahu e mëshiroftë thotë: “D.m.th u zbraps nga bindja dhe zbatimi i urdhrit të Allahut qëllimisht nga inati dhe mendjemadhësia. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, sepse lloji i tij i ndyrë e tradhëtoi në momentet kur kishte më shumë nevojë për të, sepse ai është i krijuar nga zjarri. Siç e kemi sqaruar edhe më parë, ne sahihun e Muslimit nga Aisha (Allahu qoftë i kënaqur me të) e cila përcjell se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Engjëjt u krijuan nga drita, ndërsa xhindët u krijuan nga zjarri dhe Ademi u krijua nga ajo që u është cilësuar (dheu).” (El Bidaje uen Nihaje 1/72-73)

e Mia? A mos u bëre mendjemadh apo mendon se je nga të lartët?” (Sad, 75)

Ky mohim, kjo mendjemadhësi, ky refuzim dhe kjo armiqësi e madhe e shfaqur prej tij, qenë arsytet që ai (Iblisi) të përjashtojë nga mëshira e Allahut e të konsiderojë i mallkuar.

Allahu i Lartësuar i tha: **“Atëherë, zbrit prej andej (Xhenetit)! Ti nuk ke të drejtë që të krenohesh në të! Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve”**. (Arafë, 13)

I poshtri, nuk iu nënshtroi Zotit dhe as që u pendua tek Ai, por përkundrazi u kthye me arrogancë dhe u tregua kokëfortë në armiqësinë ndaj Ademit dhe pasardhësve të tij. Ai u betua - sidomos kur pa se i ishte hequr vijë e kuqe nga ana e Allahut deri në përjetësi- që t'i ftojë drejt vetes pasardhësit e Ademit, me fjalë, me vepra dhe me ushtrinë e tij, derisa të bëhen palë me të, e të meritojnë kështu vendin e përgatitur për ta - zjarrin e Xhehenemit.

Ai (Iblisi) tha: **“O Zoti im, më jep afat deri në ditën kur do të ringjallen ata!”** (Sad, 79) Me qëllim që të ketë kohë për t'u angazhuar maksimalisht në armiqësinë ndaj Ademit dhe pasardhësve të tij.

Meqenëse urtësia e Zotit ishte që njeriu të ketë përbërje dhe natyra të ndryshme, pra morale të mira dhe vese të liga, duhej patjetër të dalloheshin (këto morale) duke u vënë njeriu në provë dhe duke u sprovuar. E siç dihet sprova më e madhe do të ishte përballja me këtë armik (Iblisin), i cili do t'i ftonte njerëzit në çdo të keqe.

Allahu i Lartësuar iu përgjigj duke i thënë: **“Zoti tha: ‘Në të vërtetë, ty do të të jepet afat deri në një ditë të caktuar (kur i fryhet Surit për herë të parë)’”**. (Sad 80-81)

Duke e shprehur kundërshtinë ndaj Allahut dhe armiqësinë ndaj Ademit dhe pasardhësve të tij, Iblisi tha: **“Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vësh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!”** (Arafë 16-17)

Ai u shpreh në këtë mënyrë, bazuar te parashikimi dhe hamendësimi i tij, sepse e dinte natyrën e krijmit të njeriut: **“Me të vërtetë, hamendja e Iblisit për ata u vërtetua; ata shkuan pas tij, përveç një grupi besimtarësh të vërtetë.”** (Sebe 20)

Allahu ia mundësoi Iblisit atë që kërkonte tek Ademi dhe pasardhësit e tij. **“(Allahu) tha: “Ik! Kushdo prej tyre që të pason ty, do të ketë Xhehenemin si shpërblim - një shpërblim i plotë. Bëj për vete, me zërin tënd, kë të mundesh nga ata! Lësho kundër tyre të gjithë kalorësinë e këmbësorinë tënde! Merr pjesë në pasurinë e fëmijët e tyre dhe jepu premtime! -Premtimet e djallit janë vetëm mashtrime.”** (Isra 63-64)

Që do të thotë: Nëse mundesh, devijoji nga edukimi i dobishëm i fëmijeve drejt edukimit të dëmshëm të tyre. Edhe pasuritë, bëji që t’i fitojnë e t’i shpenzojnë në forma e mënyra të dëmshme. Gjithashtu, merr pjesë edhe ti kur hanë, pinë apo martohen nëse nuk e përmendin emrin e Allahut përgjatë këtyre veprimeve. Gjithashtu, merr pjesë në pasurinë dhe fëmijët e tyre. **“Dhe Jepu premtime”**, pra urdhëroji që të përgënjeshtrojnë Ringjalljen dhe Gjykimin e të mos përparojnë drejt të mirës. Bëji që t’i frikësohen pasuesve të tu dhe futi frikën atëherë kur duhet të kontribuojnë në gjëra të dobishme, si dhe nxiti për (vepra) të ndyta dhe kopraci. Ky qe vendimi i Allahut, për shkak të shumë urtësive (që do të njihemi me to më pas).

Ndërsa ti, o armik i hapur (i drejtohet Allahu shejtanit)! Nuk do të kesh mundësi gjithmonë t'i devijosh ata. I keqi, ka për ta shfaqur të keqen e tij dhe do të njihet. Ndërsa Allahu nuk ka për ta përfillur e as që ka për t'u marrë me të.

Ndërsa njerëzit e zgjedhur si: profetët dhe pasuesit e tyre; të sinqertët, të drejtët dhe të dalluarit, njerëzit e dashur (evlijatë) tek Zoti dhe besimtarët: Këtyre, Allahu nuk lejon që t'i mposht Iblisi. Përkundrazi, atyre u ngriti një fortifikatë të papërshekueshme, e ajo është mbrojtja dhe ndihma e Tij. Ai i furnzoi me armë, të cilave nuk mund t'u bëjë ballë armiku, e këto armë janë: besimi i plotë në Allahun dhe fuqia e mbështetjes tek Ai. **“Sepse, në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre.”** (Nahl 99)

Për më tepër, Ai i ndihmoi (besimtarët) që t'i bëjnë ballë këtij armiku nëpërmjet disa mënyrave:

- Solli tek ata librat e Tij, që përmbajnë njohuri të dobishme dhe këshilla ndikuese, të cilat nxisin për vepra të mira dhe qortojnë e ndalojnë nga veprat e këqija.

- Dërgoi në mesin e tyre peygamberë, për t'i përgëzuar me shpërblime të menjëhershme ata që besojnë dhe i binden Allahut, si dhe për të qenë qortues ndaj mohuesve, përgënjështuesve dhe atyre që u kthejnë kurrizin (argumenteve) të Allahut, për dënimet e ndryshme dhe të lloj-llojshme që i presin. Atyre që ndjekin udhëzimin e Tij, përmes librave që solli dhe peygamberëve që dërgoi, u siguroi se, nuk kanë për të qenë prej të humburve në këtë botë dhe nuk kanë pse të shqetësohen e të merakosen për fatin e tyre në botën tjetër. Të tillët nuk do të kenë frikë dhe as që do të pikëllohen.

- Nëpërmjet librave që shpalli dhe nëpërmjet fjalëve të peygamberëve, Allahu i udhëzoi drejt gjërave, të cilat mund t'i

mbrojnë nga ky armik i përbetuar. Ai (Allahu) ua sqaroi se për çfarë fton ky djall dhe çfarë mënyrash dhe formash përdor për t'i peshkuar dhe gjuajtur njerëzit.

- Jo vetëm që ua sqaroi, por u tregoi edhe rrugën me të cilën shpëtojnë nga e keqja dhe sprovat e tij. Allahu i ndihmoi në bazë të një paracaktimi të tij, i cili tejkaloi dhe sfidoi çdo mundësi të tyre. Në momentin kur u përpoqën dhe dhanë kontributin e tyre dhe më pas kërkuan ndihmën e të Adhuruarit (Allahut), Ai ua lehtësoi të gjitha rrugët që shpien drejt qëllimit të synuar.

Allahu i Lartësuar e plotësoi edhe më tej mirësinë ndaj Ademit, duke krijuar enkas për të bashkëshorten e tij, Havanë, që do të ishte prej llojit të tij dhe në formën e tij. E gjithë kjo, që të gjente prehje (tek ajo), të plotësoheshin qëllimet e ndryshme të martesës dhe intimitetit, prej të cilave do të mundësohej ardhja e pasardhësve të tyre.

Ai (Allahu) i tha Ademit dhe bashkëshortes së tij: Vërtet shejtani është armiku juaj, prandaj kini shumë kujdes prej tij, që të mos u nxjerrë nga xheneti ku u vendosi Allahu (të qëndroni). Ai u lejoi që të ushqeheni me frutat e xhenetit dhe të shijoni të gjitha kënaqësitë e ofruara, me përjashtim të një peme të caktuar, që gjendet në xhenet, të cilën ua ndaloi duke u thënë: **“Mos iu afroni kësaj peme, se bëheni keqbërës (të padrejtë)!”** (Arafë 19)

Allahu i Lartësuar duke i treguar Ademit se si mund t'i gëzojë kënaqësitë e xhenetit, i thotë: **Këtu nuk do të mbetesh kurrë i uritur e as i zhveshur, dhe nuk do të kesh etje e as vapë.”** (Taha, 119)

Ata të dy qëndruan në xhenet aq sa deshi Allahu, ndërsa armiku (iblisi) i përgjonte, u rrinte në pritë dhe priste rastin e

volitshëm. Kur e pa gëzimin e Ademit në xhenet dhe dëshirën e tij të zjarrtë për të qëndruar aty përgjithmonë, iu afrua në një mënyrë tinzare, në formën e një shoku këshillues dhe i tha: “O Adem! A të të tregoj për një pemë, që nëse ushqehesh prej saj do të jetosh përjetë në këtë xhenet dhe mbretërimi yt nuk do të ketë fund kurrë?”

Ai (Iblisi) nuk i ndërpreu cytjet e tij, me fjalë të bukura e me premtime boshe; me këshilla të hapura, që në fakt ishin mashtrimi më i madh, derisa ia arriti e ranë pre e mashtrimit të tij dhe filluan të hanin nga frutat e pemës, të cilën Allahu ua kishte ndaluar dhe i kishte privuar prej saj. Kur hëngrën prej saj, filluan t’u zbuloheshin pjesët e turpshme të trupit, edhe pse i kishin mbuluar më parë, pastaj nxituan të mbulojnë trupin e tyre me gjethet e xhenetit. Pra i ngjisinin gjethet në trupin e tyre të zhveshur, pasi rrobat u ranë para syve dhe në moment u shfaq dënimi i mosbindjes së tyre. **“Zoti i tyre i thirri: ‘A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapur?’”** (A’rafë, 22)

Allahu i Lartësuar, instaloj në zemrat e të dyve (Ademit dhe Havasë) pendimin e plotë dhe kthimin e sinqertë tek Ai: **“Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin.”** (El Bekare, 37)

“Ata thanë: ‘O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit’”. (A’rafë, 23)

Allahu ua pranoi pendimin, ua fshiu mëkatin që bënë, por çështja për të cilën i paralajmëroi që të kenë kujdes (pema e ndaluar), e cila do t’i nxirrte prej atij xheneti, ishte vendosur dhe kishte marr fund. Kështu u larguan prej aty drejt tokës, aty ku ishte përzier e mira me të keqen, gëzimi me pikëllimin dhe lodhjen.

Allahu u tregoi se ka për t'i sprovuar patjetër ata dhe pasardhësit e tyre. Ai që beson dhe bën vepra të mira, përfundimi (vendi) i tij do jetë më i mirë se ai ku jetuan (ishin) më parë. Ndërsa ai që përgënjështron dhe zbrapset nga besimi, përfundimi i tij do jetë mjerimi i përhershëm dhe dënimi përjetë.

Allahu i Lartësuar ua tërhoqi vërejtjen pasardhësve të Ademit nga ky armik duke u thënë: **“O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrësi djalli, ashtu siç i nxori prindërit tuaj nga Xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t'iu dukur vendet e turpshme! Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë.”** (A'rafë 27)

Rrobën, që shejtani e hoqi nga dy prindërit tanë (në xhenet) e zëvendësoi me një rrobë tjetër që mbulon lakuriqësinë dhe përmes saj mund të arrihet bukuria e jashtme në këtë botë. Gjithashtu i pajisi me një rrobë tjetër më të vlefshme, atë të devotshmërisë. Ajo është rroba e zemrës dhe e shpirtit, besimit, sinqeritetit, pendimit dhe zbukurimit me çdo moral të mirë dhe distancimit nga çdo ves i keq dhe i ulët.

Më pas, nga Ademi dhe bashkëshortja e tij, Allahu krijoi shumë meshkuj e femra, i shpërndau nëpër tokë dhe i la të trashëgojnë njëri-tjetrin për t'i parë se si do të veprojnë.

Mësimet e dobishme nga historia e Ademit (alejhis selam)

1- Këtë ngjarje madhështore, Allahu e ka përmendur në shumë vende në Kur'anin famëlartë, qartazi, pa asnjë fije dyshimi. Kjo ngjarje, konsiderohet prej historive më të mëdha, për vërtetësinë e së cilës kanë rënë dakord të gjithë peygamberët; kanë folur për të, të gjithë librat qiellorë dhe e kanë besuar të gjithë ndjekësit e profetëve, që nga kohët e mëparshme e

deri në kohët e vona. Por në kohët e sotme, mbiu një grup keqdashës dhe i shtthurur, që mohuan çdo gjë që sollën profetët, mohuan Krijuesin dhe nuk pranuan veçse njohuritë dhe faktet shkencore, tek të cilat kanë arritur mendjet e tyre të mangëta e të cekëta!

Bazuar mbi këto ideologji (që beson ky grup), që janë larg të vërtetës, qoftë sipas legjislacionit fetar apo atij logjik, ata mohojnë (ekzistencën) Ademin dhe Havanë, gjithashtu edhe atë që ka përmendur Allahu dhe i Dërguari i Tij në lidhje me Ademin dhe Havanë.³ [1] Ata pretenduan se njeriu në zanafillë ka qenë kafshë dhe pikërisht majmun, ose diçka e ngjashme me majmunin dhe evuloi (kohë pas kohe) derisa erdhi në gjendjen që e shohim sot! Ata u mashtruan pas ideologjive të gabuara të ndërtuara mbi supozime dhe logjikë të prishur dhe për hir të këtyre ideologjive braktisën çdo lloj informacioni të saktë, veçanërisht ato (njohuri) që sollën peygamberët. Allahu e vërtetoi fjalën e Vet kundër tyre kur tha: **“Kur të dërguarit e tyre iu sollën prova të qarta, ata u mburrën me diturinë që zotëronin; por shumë shpejt i goditi ajo, me të cilën talleshin.”** (Gafir 83)

Ky grupacion është i njohur për të gjithë ata që e pohojnë ekzistencën e Zotit dhe e dinë fare mirë se ata janë grupi më i humbur. Por fatkeqësisht, tek disa muslimanë depërtuan disa gjurmë të këtij grupi sekularist, si dhe disa degëzime të ndërtuara mbi teoritë e tyre. Kjo i shtyu disa bashkëkohas që ta komentonin përluljen e engjëjve ndaj Ademit me këto fjalë:

³ Këtij grupi i afrohen shumë në humbje ata që pretendojnë se njeriu ka evoluar dhe është zhvilluar në religjion siç ka evoluar në shpikje dhe në prodhime. Kanë për qëllim: Mohimin e historisë së akides (besimit) siç e ka përmendur Kur’ani në historinë e Ademit dhe Iblisit, si dhe mohimin e shpalljes dhe profetësisë!!

“Kjo botë është në shërbim të njerëzve, madje çdo gjë në tokë dhe nën tokë, Allahu e ka vënë në dispozicion të njeriut dhe pikërisht ky është kuptimi i përlules së engjëjve (ndaj Ademit)”!!

Cilido që e beson Allahun dhe botën tjetër, është i sigurt se këto mendime janë të importuara nga këto ideologji të prishura, madje mund të konsiderohen tjetërsim i Librit të Allahut, njësoj me tjetërsimin që i bëjnë (Librit të Allahut) Karamitët dhe Batinijet⁴

Nëse kjo ngjarje (përlula e engjëjve para Ademit) do të trajtohet e do të merret në konsideratë sipas këtij lloji tjetërsimi, atëherë edhe ndodhitë e tjera të Kur'anit do të pësonin të njëjtën gjë. Ndërsa Kur'ani, që është sqarim për çdo gjë, udhëzim dhe mëshirë për të gjithë, do të kthehej në libër, ku çdo armik i Islamit mund ta komentojë si të dojë, vetëm e vetëm për ta rrëzuar Kur'anin dhe për ta shndërruar udhëzimin e tij (Kur'anit) në humbje dhe mëshirën që ai përçon në fatkeqësi. Larg të metave është Zoti ynë, vërtetë kjo është një shpifje e madhe.

Për ta rrëzuar këtë pretendim të prishur, besimtarit i mjafton të lexojë atë që përmend Allahu në historinë e Ademit dhe përlules së engjëjve, ku kupton qartazi se pretendimi i lartpërmendur bie ndesh plotësisht me atë që ka për qëllim Allahu dhe Profeti i Tij. Edhe pse ndjekësit e këtyre ideologjive, i zbukurojnë dhe i ngjyrosin fjalët e tyre duke ua dedikuar edhe atyre që mendohen të jenë njerëz të mirë. Por besimtari nuk e braktis imanin (besimin); nuk e lë Librin e Zotit të tij për shkak të disa promovimeve mashtruese që vijnë nga njerëz të mashtruar me vetet e tyre.

⁴ Sekte ekstremiste shijite që besojnë se Kur'ani ka kuptim të jashtëm dhe të fshehtë dhe kuptimin e tij të fshehtë nuk e dinë veçse imamët e tyre.

2- Nga kjo ngjarje mësojmë vlerën e dijes, pasi engjëjve kur iu bë e qartë pozita e Ademit me anë të dijes, pranuan përsosmërinë në krijimin e tij dhe se ai meritonte të gjitha nderimet dhe respektet.

3- Atij që Allahu i jep mirësinë e dijes, duhet ta pohojë këtë mirësi që Allahu ia ka dhuruar dhe të shprehë mirënjohje ashtu siç bënë engjëjt dhe profetët: **“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.”** (Bekare 32)

Të ketë shumë kujdes nga e folura rreth gjërave që nuk i di, sepse dija është prej mirësive më të mëdha dhe mirënjohja ndaj kësaj mirësie bëhet duke e falënderuar dhe lavdëruar Allahun për të, duke e përvetësuar (për vete) dhe duke ua përcjell njerëzve të paditur. Të mos i tejkalojë kufijtë duke folur për gjëra që s'i di, por të heshtë.

4- Allahu i Lartësuar e bëri këtë ngjarje mësim për ne, për të na treguar se, zilia, mendjemadhësia dhe lakmia, janë veset më të rrezikshme për njeriun. Mendjemadhësia e Iblisit dhe zilia e tij ndaj Ademit, e çuan atë deri aty ku e pamë se në ç'gjendje përfundoi. Ndërsa lakmia e Ademit dhe bashkshortes së tij, i shtyu të provonin pemën. Nëse nuk do t'i përfshinte mëshira e Allahut, do kishin përfunduar në shkatërrim, mirëpo mëshira e Allahut e plotëson mangësinë, e përmirëson atë që thyhet, e shpëton të mbyturin dhe e lartëson atë që ka rënë poshtë.

5- Njeriu, kur bie në mëkat, duhet të nxitojë drejt pendimit dhe pranimit të mëkatit që ka bërë dhe të shprehet sinqerisht nga zemra, ashtu siç u shprehën prindërit (Ademi dhe Havaja) me zemër të sinqertë dhe pendim të vërtetë. Rastin e pendimit të tyre, Allahu nuk na e tregoi për gjë tjetër, veçse për t'i marrë si shembull, në mënyrë që të arrijmë lumturinë e të shpëtojmë nga shkatërrimi.

Ai (Allahu), nuk na i rrëfeu fjalët e shejtanit dhe kërcënimin e tij (ndaj nesh), veçse për të na treguar vendosmërinë e këtij armiku për të na devijuar në çdo mënyrë. Na lajmëroi që të jemi të përgatitur për t'i bërë ballë këtij armiku, i cili e ka shfaqur haptazi armiqtësinë e tij të tejskajshme dhe të hershme. Allahu kërkon prej nesh që të përballemi me të (shejtanin) me çfarë të mundemi, t'i largohemi rrugës dhe hapave të tij, apo çdo devijimi që na shpie drejt rrjetës së tij. Ai kërkon nga ne që të mbrohemi, nëpërmjet duave (lutjeve) të sakta, dhikrit të zemrës apo duave mbrojtëse. Të pajisemi me armë të cilat e shkatërrojnë atë (shejtanin), si p.sh: iman të sinqertë, mbështetje të fortë tek Allahu, vazhdimësi në vepra të mira, përballimi i cytjeve dhe mendimeve të këqija të shejtanit, të cilat cënojnë çdo zemër dhe kërkojnë ta distancojnë prej dijeve të dobishme dhe fakteve të vërteta e të pakontestueshme.

6- Në këtë ndodhi ka argumente për metodologjinë që ndjek Ehli Suneti dhe Xhemati, të cilët pohojnë për Allahun, atë që Vetë Ai ka pohuar për Vetën e Tij, emrat dhe atributet e Tij të larta, sepse s'ka dallim mes attributeve të qenies së Tij dhe attributeve të veprimeve të Tij.

7- Në këtë ngjarje vërtetohet ekzistenca e dy duarve të Allahut, siç përmendet qartazi në ajet: **“Atë që e kam krijuar me dy duart e mia.”** Ai (Allahu) ka dy duar reale dhe ashtu sikurse Qenia e Tij nuk u ngjason krijesave, ashtu edhe sifetat (cilësitë) e Tij nuk ngjasojnë me sifatat e krijesave.



NUHU

Babai i dytë i njerëzimit

(Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të)

Njerëzimi, pas Ademit (alejhis selam) jetoi për shekuj me radhë si një umet (popull) i pandarë, dhe i udhëzuar.

Më pas, filluan polemikat dhe kundërshtimet mes tyre. Djajtë e shfrytëzuan këtë gjendje duke mbjellë lloj-lloj të këqijash në mesin e njerëzve, e këtë e bënë me mënyra të shumta e të ndryshme:

Kur vdiqën disa njerëz nga populli i Nuhut, të njohur si njerëz të mirë (të devotshëm), pjesa tjetër u pikëllua shumë për vdekjen e tyre. Shejtani u erdhi e i urdhëroi t'i pikturojnë e t'i bëjnë skulpturë portretet e tyre me qëllim që të ngushëllohen dhe të kujtojnë kohët që kishin kaluar me ta. Kjo ishte zanafilla e së keqes.

Kur u shua brezi që i kishte portretizuar (njerëzit e mirë) për qëllimin e lartpërmendur, brezat e tjerë që erdhën më pas, e përzien dijen e tyre me gjëra të kota. Shejtani duke i nxitur u tha: “Këtyre statujave që mbajnë emrat e **Ueddit, Suvait, Jeguthit, Jaukës dhe Nesrit**, të parët tuaj u luteshin,

u kërkonin ndërmjetësim (tek Zoti), përmes tyre kërkonin shiun dhe largonin sëmundjet.” Ai (shejtani) vazhdoi t’i nxiste derisa njerëzit filluan t’i adhuronin këto statuja, edhe pse u këshilluan nga njerëzit e dijshtëm për të mos vepruar në këtë mënyrë.⁵

Më pas, Allahu dërgoi në mesin e tyre Nuhun (alejhis selam), të cilin e njihnin për njëri të singertë, besnik dhe me moral të mirë. Ai u tha: **“O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij!”** (Arafë, 59)

Ai i ftoi drejt të mirave të dynjasë dhe Ahiretit (botës tjetër) dhe u tha: **“O populli im! Në të vërtetë, unë jam për ju një paralajmërues i qartë: që të adhuroni Allahun, t’i frikësoheni Atij e të më bindeni mua, me qëllim që Ai të falë disa nga gjynahet tuaja dhe t’ju lërë (të jetoni) deri në një afat të caktuar.”** (Nuh, 2-4)

Kur Nuhu nisi t’i ftonte që të adhuronin vetëm Allahun, e t’ua pastronte mendimet e kota që ndiqnin, si dhe t’i frikësonte

⁵ Buhariu në Saihun e tij me nr 4920 përcjell nga Ibn Abasi se për fjalën e Allahut që thotë: “Dhe thanë: e thannë Saihun e tij me nr 4920 Mos e lini kurrsesi as Veddin, as Suvain, as Jeguthin, as Jaukën, as Nesrin ku [Nuh 21-23]. Ka thënë: “Këto ishin emra të disa burrave të mirë nga populli i Nuhut. Kur ndërruan jetë, shejtani u erdhi dhe u tha: Vendosi disa idhuj në kuvendet e tyre ku ata rrinin dhe emërtojini me emrat e tyre. Në fakt kështu vepruan por nuk i adhuruan. Dhe në kohën kur brezi u ndërrua dhe dija u rrënu, ata filluan t’i adhuronin.” Ibnul Kajjim (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Shumë prej Selefëve kanë thënë: Kur ata ndërruan jetë, njerëzit filluan të qëndronin pandërprerë tek varret e tyre, më pas vendosën portretet e tyre. Pas një kohe të gjatë, filluan t’i adhuronin. Kurtubiu (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Brezat e parë i portretizuan figurat e tyre që t’i merrnin si shembull dhe të kujtonin veprat e tyre të mira, që të përpiqeshin (në adhurime) siç përpiqeshin ata dhe të adhuronin Allahun tek varret e tyre. Por më pas erdhën breza të tjerë që nuk e kuptuan qëllimin e tyre dhe shejtani i cyti duke u thënë: Të parët tuaj i adhuronin këto portrete dhe i madhëronin.” Për më tepër shih Fer’hul Mexhid (1/281,282).

me dënimin e Zotit në dynja dhe ahiret, ata u përgjigjën:
“Ne të shohim ty në humbje të qartë”. (A'raf, 60]

“Shohim, që ty të vijnë pas vetëm më të pavlerët nga ne, pa menduar fare. Ne nuk shohim se ti ke diçka më të mirë se ne, madje ju konsiderojmë gënjeshtarë”. (Hud, 27)

Ata kërkuar dëbimin e besimtarëve që qëndronin me të, për shkak se e ndjenin veten mendjemëdhenj dhe për shkak të mospërfilljes që kishin ndaj të vërtetës dhe njerëzve.

Nuhu u sqaroi:

- Se ai nuk ishte prej të humburve, përkundrazi, ata që do ta pasonin atë, do të ishin larg humbjes. Gjithashtu u tregoi se është i Dërguar besnik prej Zotit, mbështetur mbi fakte dhe argumente të qarta nga Zoti i tij.

- Nuhu u tregoi gjithashtu se, besimtarët nuk meritojnë të dëbohen, por përkundrazi, të nderohen e të respektohen.

- Gjithashtu u sqaroi se, nuk pretendonte se kishte ndonjë cilësi hyjnore, prandaj u tha: **“Unë nuk ju them se kam thesarin e Allahut apo se e di të padukshmen. As nuk them se jam engjëll e as do t'u them atyre të cilët janë të nënçmuar në sytë tuaj se Allahu nuk do t'u japë kurrfarë të mire.”** (Hud: 31)

Ai i ftoi ditën dhe natën, fshehurazi dhe haptazi, e megjithatë thirrja e tij nuk u shtoi veçse largim nga mesazhi i tij. Madje porositën njëri-tjetrit që t'i qëndronin besnikë adhurimit të idhujve dhe të kapen fort pas tyre.

Nuhu tha: **“O Zoti im, ata më kundërshtuan mua dhe pasuan ata, të cilëve pasuria e tyre dhe fëmijët e tyre nuk u sollën gjë tjetër veçse shkatërrim. Ata kurdisë një kurth të madh dhe thanë: ‘Mos i braktisni kurrsesi zotat tuaj! Mos e lini kurrsesi Veddin, Suvain, Jeguthin, Jeukën, as Nesrin!’”** (Nuh, 21-23)

Nuhu (alejhi selam), kur pa se këshilla dhe përkujtimi i tij nuk po u bënë dobi atyre në asnjë formë dhe se brezi pasardhës ishte më i keq se ai i mëparshmi: **“Dhe Nuhu tha: ‘O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë femohues, sepse, nëse Ti i lë, ata do t’i shpien në humbje robërit e Tu dhe do të lindin vetëm kriminelë dhe jobesimtarë!’”** (Nuh, 26-27)

Allahu iu përgjigj lutjes së tij. E urdhëroi të ndërtonte një anije nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e vet Allahut. Ai (Allahu) ia mësoi ndërtimin e anijes dhe kjo ishte një nga mirësitë që Allahu u dhuroi njerëzve.

Merita e ndërtimit të anijes i takoi Nuhut. Me këtë ai arriti përfitime të panumërta jetësore dhe fetare për çdo kohë. Allahu e njoftoi, se do ta përmbyste popullin e Nuhut dhe nuk duhej t’i kërkonte për ta asgjë, sepse ishin popull zullumqarë.

Kur Nuhu kishte filluar ndërtimin e anijes, sa herë që kalonte pranë tij ndonjë grup njerëzish nga populli i tij, talleshin me të. Ai u thoshte: **“Nëse sot ju talleni me ne, ta dini se edhe ne do të tallemi me ju atëherë kur shkatërrimi të bjerë mbi ju.”**

Allahu i shpalli Nuhut (alejhi selam): **“Kur të vijë ai momenti kur uji të gufojë nga sipërfaqja e tokës. Pra, kur e gjithë toka të gufojë në burime, deri dhe nga zonat e largëta, merr nga një çift nga të gjitha llojet e kafshëve, mashkull**

dhe femër”, me qëllim që të mbetet raca e tyre, pasi ishte e pamundur t'i merrte të gjitha kafshët.

Ishte urtësia e Allahut që të vazhdonte jetëgjatësia e këtyre kafshëve të krijuara në dobi dhe në shërbim të njeriut.. Gjithashtu, Allahu e urdhëroi (Nuhun) që të merrte me vete të gjithë ata burra e gra që e kishin besuar.

Çështja ishte se atij nuk i besuan veçse pak njerëz! Allahu e urdhëroi që të merrte familjen e tij, me përjashtim të atyre, ndaj të cilëve ishte dhënë vendimi i Zotit për shkatërrim. Kur i mbarti në anije të gjithë ata për të cilët ishte urdhëruar, u tha: **“Përmendeni emrin e Allahut, sa herë që ajo (anija) lundron apo ndalet.”** Sepse shkaqet, sado të mëdha të jenë, ato vijnë nga mëshira dhe butësia e Allahut dhe nuk përmbushen veçse me ndihmën e Allahut.

Kur erdhi momenti i caktuar, Allahu e bëri tokën të gufojë nga burimet, e urdhëroi qiellin të lëshojë shi të bollshëm dhe të furishëm dhe kështu shiu i rënë nga qielli u bashkua me ujin e tokës dhe vërshoi në zonat e ulëta. Kështu niveli rritej e rritej duke mbuluar të gjitha lartësitë, derisa filluan të mbuloheshin edhe majat e maleve më të larta, ndërsa anija lundronte bashkë me ta në dallgë si të ishin kodra, që e godisnin në të djathtë dhe në të majtë.

Në këto momente të llahtarshme, Nuhu pa djalin e tij mohues, i cili kishte zgjedhur të qëndrojë në fenë e popullit të tij dhe ishte distancuar nga feja e babait të vet. Madje, edhe në këto çaste mendoi të vepronte si shumë të tjerë nga populli i tij, të largoheshin e të merrnin arratinë nga uji i rrëmbyeshëm. Me keqardhje Nuhu e thirri dhe i tha: **“O biri im, hip me ne e mos u bëj me mohuesit!”** (Hud, 42)

Ndërsa i biri u bë peng i vetmashtimit, madje edhe në ato momente kur zemrat ishin gati të copëtoheshin nga frika e ndëshkimit - përveç zemrave të mbushura me besim: **“(I biri) tha: ‘Unë do të strehohem në një mal i cili do të më ruajë nga uji.’”** (Hud, 43)

Menduan se uji nuk do të arrinte deri mbi majat e maleve. Por Nuhu i tha: **“Sot nuk ka strehim nga dënimi i Allahut, përveç atij që Ai e mëshiron!”** (Hud, 43)

As malet, as kështjellat, asgjë tjetër nuk të mbron (nga dënimi) përpos atij që e mëshiron Allahu. Mëshira e Tij në ato momente ishte vetëm për ata që hipën në anije bashkë me Nuhun (alejhis selam).

“Një valë në mes tyre i ndau.” (Hud, 43) Dhe djali i tij përfundoi me ata që u përmytën.

Allahu i përmyti të gjithë mohuesit dhe e shpëtoi Nuhun bashkë me të gjithë besimtarët e tjerë. Kjo ngjarje ishte argument se ajo me të cilën u dërgua Nuhu dhe e cila konsistone në: teuhidin, shpalljen, ringjalljen dhe fenë në tërësi, e gjithë kjo ishte hak (e vërtetë) dhe se ata që e kundërshtuan, ishin në të kotën. Ishte një argument se shpërblimi në këtë botë u takon besimtarëve të cilët meritojnë shpëtim dhe nderim. E përsa u përket mohuesve, ata meritojnë shkatërrim dhe nënçmim.

Kur u arrit qëllimi madhor, Allahu e urdhëroi qiellin që të ndalë shiun dhe tokën që të përpinte ujin sipër saj. Uji filloi të pakësohej pak nga pak dhe ajo (anija) qëndroi - pasi uji filloi të tërhiqej - mbi Xhudij, i cili është një mal i lartë që thuhet se bie në zonat e Mosulit (në Irakun e sotëm). Ky është një fakt, se të gjithë malet janë përmytur nga uji dhe i ka mbuluar tufani apo uragani.

Nuhu u pikëllua për djalin e tij dhe iu lut Zotit me keqardhje dhe përgjërëm: **“O Zoti im, biri im është nga familja ime dhe premtimi Yt është i vërtetë.”** (Hud, 45) Më lejo ta marr familjen time, sepse Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

Zoti i tha: **“O Nuh, ai nuk është nga familja jote.”** (Hud, 46) Pra nga ata që u është premtuar shpëtimi, sepse Allahu pat thënë: **“Përveç atyre ndaj të cilëve është marrë vendimi (se do të përmbysten)”** (Hud, 40)

“Vërtetë kjo është punë e keqe.” (Hud, 46) Pra, nuk është punë e mirë, lutja që bëre për djalin tënd për shpëtim, ndërkohë që ai nuk të pasoi ty, por qëndroi në fenë e popullit të tij. **“Mos më kërko gjëra për të cilat ti nuk ke dije. Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga të paditurit”.** (Hud, 46)

Ky ishte një qortim për Nuhun (alejhis selam), mësim dhe këshillë që të mos bënte një lutje të tillë, edhe pse realisht dihet se keqardhja prindërore ishte ajo që e shtyu të lutej për të birin. Gjatë lutjes elementi kryesor duhet të jetë dija, sinqeriteti dhe kërkimi i kënaqësisë së Allahut të Lartësuar.

Nuhu tha: **“O Zoti im, kërkoj mbrojtje prej Teje nga kërkimi i asaj për të cilën nuk kam dije. Nëse Ti nuk më fal dhe nuk më mëshiron, unë do të jem nga të humburit.** - Atëherë iu tha: **‘O Nuh, zbrit me përshëndetje prej Nesh dhe me bekime për ty dhe pasardhësit e atyre që gjenden me ty. Disa popujve (pas teje), Ne do t’u japim kënaqësi e pastaj do t’i godasë nga Ne dënimi i dhembshëm! (për shkak të mosbesimit të tyre)’**” (Hud, 47-48)

Atëherë Nuhu zbriti nga anija dhe Allahu e begatoi te pasardhësit e tij, duke i dhënë mundësinë që ta nisin jetën nga e para. Djemtë e tij quheshin: Jafith, pasardhësit e të cilit u

shpërndanë në Lindje. Hami, pasardhësit e të cilit u shpërndanë në Perëndim dhe Sami, pasardhësit e të cilit u shpërndanë mes Lindjes dhe Perëndimit.

Nuhu, qëndroi tek populli i tij plot 950 vjet, duke i ftuar njerëzit të adhuronin Allahun. Pas përmytjes katastrofike që shkaktoi uragani, ai jetoi aq sa deshi Allahu. Ai ishte nga profetët më të zgjedhur dhe njëri prej 5 peygamberëve, të cilët do të kenë të drejtën e ndërmjetësimit Ditën e Gjykimit. Ai ishte i pari peygamber që u dërgua tek njerëzit dhe babai i dytë i njerëzimit (paqja dhe nderimet e Allahut qofshin mbi të).

Mësimet që do të marrim nga historia e Nuhut (alejhi selam)

1- Të gjithë peygamberët, që nga Nuhu e deri tek Muhamedi (alejhis salatu ues selam) kishin si detyrë parësore të tyren, thirrjen (e njerëzve) në monoteizmin e pastër (në një Zot të vetëm) dhe ndalimin e tyre nga shirku (idhujtaria). Nuhu (alejhis selam) dhe peygamberë të tjerë, të parën fjalë që u thonin njerëzve ishte: **“O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni të adhuruar tjetër përveç Tij!”** (Arafë, 59) Këtë parim e përsërisnin (kohë pas kohe) në forma dhe mënyra të ndryshme.

2- Mësojmë etikën e thirrjes (Davetit) dhe përsosmërinë e saj. Nuhu (alejhi selam) e ftoi popullin e tij ditën dhe natën, haptazi dhe fshehurazi, në çdo kohë e në çdo situatë, të cilën e konsideronte si të përshtatshme për Davet. Ai i përgëzonte njerëzit me shpërblimin e shpejtë në këtë botë për çdo vepër të mirë që do të bënin; me shpëtimin nga dënimi dhe përjetimin e kënaqësisë në pasuri dhe fëmijë, si dhe shtimin e rizikut, nëse do të besonin në shpërblimin e amshueshëm (të botës tjetër). Në të njëjtën kohë i paralajmëronte për të kundërtën e atyre gjërave që i nxiste për t'i vepruar. Nuhu (alejhi selam)

duroi shumë në këtë rrugë, ashtu sikurse kanë duruar dhe pejgamberët e tjerë. Ai i ftoi me fjalë të buta, me dhembshuri e me çdo mënyrë tjetër, e cila tërhiqte zemrat e njerëzve e që mundësonte arritjen e qëllimit. Ai ua përshfaqti argumentet hyjnore dhe ua sqaroi faktet.

3- Dyshimet⁶ që hodhën armiqtë e profetëve ndaj shpalljeve të Allahut, ishin në vetvete fakte që i shuanin dhe i hidhnin poshtë shpifjet e përgënjeshtresve. Kjo sepse dyshimet e tyre, ishin të pabaza dhe të pavërteta, e nuk mund të besoheshin nga njerëz me logjikë të shëndoshë. Kur populli i Nuhut tha: **“Ne shohim se ti je thjesht njeri si ne dhe, shohim, që ty të shkojnë pas vetëm më të pavlerët nga ne, pa menduar fare. Ne nuk shohim se ti ke diçka më të mirë se ne, madje ju quajmë gënjeshtarë”**. (Hud, 27)

⁶ Qëllimi i termit dyshim është: Ajo që nxit luhatje dhe dyshime në sinqeritetin e thirrësit dhe vërtetësisë së mesazhit që ai mban. E gjithë kjo për të penguar të vërtetën, mundësinë e pranimit të saj ose për ta vonuar këtë pranim. Në shumicën e rasteve paria e çdo populli është ajo që hedh dyshimet dhe i zbukurojnë për njerëzit duke i përhapur në mesin e tyre. I përsërisin që ti dëgjojnë njerëzit e thjeshtë dhe të bëhen pjesë e pandarë e shpirttrave të tyre. Kështu ata i besojnë dhe i marrin si fakte të pa mohueshme dhe kjo i shtyn më tej që tu dalin për zot dhe të armiqësojnë të vërtetën dhe ndjekësit e saj. Ndërsa paria qesh dhe tallet me ta sepse ia aritën qëllimit që deshën. Dyshimet janë disa llojesh: 1- Dyshime që kanë të bëjnë me thirrësin siç është sharja e personit të tij, jetës dhe moralit, akuzat dhe goditjet me fjalë si: injoranca, humbja çmenduria, apo shpifje të tilla të ngjashme të cilan kanë për qëllim: Largimin e njerëzve dhe mosbesimin e tyre tek ky thirrës. 2- Dyshime që kanë të bëjnë me tematikën e thirrjes siç është akuza se kjo thirrje është risi dhe largim nga gjendja normale e rrjedhës së atij populli, zakoneve, rendit dhe trashëgimisë. Me këtë synohet largimi i njerëzve nga thirrja për tek Allahu dhe pengimi i tyre nga kjo rrugë. 3- Dyshime që kanë të bëjnë me njerëzit që ftohen, duke treguar në pamje të jashtme preokupim për interesat e tyre, popullin dhe fenë e baballarëve si dhe ruajtjen e mirësive dhe jetesës së qetë, me anë të së cilës synohet që të nxisin ndjenjat e njerëzve kundër thirrësave për tek Allahu. Për më tepër shih “Usul ed Daueh” fq 426,436.

Nëse mediton në fjalët e tyre, do të konstatosh vetëm shtrembërime, që tregojnë dështimin dhe kryeneçësinë e tyre ndaj të vërtetës.

Ata thanë: **“Ne shohim se ti je thjesht njeri si ne.”** Nëse e vërteta vjen nëpërmjet një njeriu, a mund të konsiderohet ky fakt dhe argument se ajo nuk është e vërtetë?

Në thelb, fjalët e mësipërme nënkuptojnë se çdo fjalë që e thotë njeriu, pavarësisht burimit të saj, supozohet të jetë e kotë. Ky konstatim nuk qëndron, madje është akuzë e rëndë për të gjitha dijet dhe shkencat njerëzore të përfituara prej tyre. Realisht, ky preceptim i hedh poshtë të gjitha dijet dhe shkencat. A ekziston ndonjë dije, e që njerëzit të mos e kenë përfutur nga njëri-tjetri, edhe pse në shkallë të ndryshme? Dijet dhe njohuritë më të mëdhaja, më të vërteta dhe më të dobishme janë ato (të përcjella nga profetët e të inspiruara nga shpallja e Allahut.

Gjithashtu, ata i thanë: **“Ne nuk shohim se ti ke diçka më të mirë se ne.”** D.m.th, ne dhe ju jemi njerëz.

Të gjithë peygamberëve, kur i janë thënë këto fjalë, janë kundërpërgjigjur duke thënë: **“Ne jemi vetëm njerëz si ju, por Allahu ia dhuron hirin e Tij kujt të dojë prej robërve të Vet.”** (Ibrahim, 11)

Allahu u dha mirësi profetëve dhe i veçoi me shpallje dhe dërgesë të mesazheve të Tij, edhe pse populli i Nuhut e mohonte diçka të tillë, e kjo konsiderohet injorancë e madhe nga ana e tyre dhe përçmim i mirësive të Zotit. Allahu i Lartësuar më mëshirën dhe urtësinë e Tij, zgjodhi që peygamberët të jeni nga mesi i njerëzve, me qëllim që njerëzit të kenë mundësi të përfitojnë prej tyre. Përgënjeshtresit nga populli i Nuhut mohuan vlerën e kësaj mirësie, si dhe rrugën e drejtë e të dobishme që u erdhi.

Ata thanë: **“Shohim, që ty të ndjekin vetëm më të pavlerët nga ne.”**

Tek njerëzit e mençur është shumë e qartë se, e vërteta njihet nga faktet që ajo mbart dhe jo prej pasuesve të saj. Ndërsa fjalët e tyre erdhën si rezultat i mendjemadhësisë dhe përhumbyes dhe siç dihet mendjemadhësia e pengon robin ta njohë të vërtetën e ta pasojë atë.

Ata gjithashtu thanë: **“Të pavlerët nga ne.”**

Nëse patën për qëllim varfërinë, varfëria nuk është turp. Nëse patën për qëllim moralin (e atyre besimtarëve), kjo akuzë bie poshtë, pasi realisht, me moral të ulët ishin vetë ata që i thanë këto fjalë duke adresuar besimtarët. A mund të cilësohen të ulta besimi në Allah dhe peygamberë?! Bindja ndaj Zotit dhe Profetit?! Nënshtrimi ndaj të vërtetës dhe largimi nga çdo vepër e ulët?! Apo ndjekësit e këtyre vlerave, si të pavlerë? A nuk janë më meritore për t'u konsideruar të tillë (të palverë) ata që lënë detyrën më madhore, njësimin e Allahut, falenderimin ndaj Tij dhe që ushqejnë zemrat e tyre me mendjemadhësi ndaj të vërtetës dhe ndaj njerëzve? Beto hem për Zotin se kjo është poshtërsia më e madhe, por ata ishin popull i humbur dhe akuzat e shpifjet e tyre ndaj njerëzve të zgjedhur (peygamberëve), bëheshin vetëm e vetëm sepse ata (profetët) besonin Allahun, të Plotfuqishmin që meriton çdo lavd e falenderim.

Pastaj i cilësuan besimtarët si njerëz të nxituar që marrin hapa **“Pa menduar fare”**

D.m.th pa u menduar ata nxituan për të besuar tek ti o Nuh, pa pyetur kënd dhe pa ia marr mendimin dikujt. Nëse e pranojmë këtë si të vërtetë atëherë ky është argument që e pohon të vërtetën sepse: E vërteta përshfaq dritë, bukuri, hijëshi, vërtetësi dhe siguri, ç'ka të bën ta pasosh, pa i marr

leje askujt. Rrahje mendimesh dhe konsultime kërkohet për gjërat e panjohura apo të dyshimta, që nuk u dihet vërtetësia apo dobia që mund të kenë ose jo.

Ndryshe ndodh me besimin që është më i qartë se rrezet e Diellit në shkëlqim dhe më i ëmbël se gjithçka tjetër. Ndaj këtij besimi nuk mund të zmbropset veçse një mendjemadh, kryeneç si rasti i këtyre tiranëve djallëzorë.

Pastaj thanë: **“Ne nuk shohim se ti ke diçka më të mirë se ne.”**

Sa të vërteta janë këto fjalë? Me atë që thonë, ata tregojnë veten e tyre dhe fjalët që nxjerrin, përshfaqin çfarë përmban zemra e tyre. Këta njerëz flasin atë që vetë nuk e besojnë. Sidoqoftë, e vërteta duhet pranuar pa marrë parasysh se kush e tha, një i mirë apo një i keq, pasi ajo qëndron më lart se çdo gjë tjetër.

Në fund thanë: **“Madje ju quajmë gënjeshtarë”**

Dihet se hamendësimi është gënjeshtër më e madhe. Nëse do të thonin: Ne e dimë dhe jemi të bindur se ju jeni gënjeshtarë, duhet të kishin argumente për ta vërtetuar atë që thonin, pasi konstatime dhe akuza të pabaza mund të thonë të gjithë.

Por ata s’kishin gjë të vërtetë realisht, e prapë se prapë fjalët e tyre i morrën si fakte dhe argumente, edhe pse nuk qëndronin. Megjithatë, kjo nuk i pengoi profetët që të përballen me ta e t’u sjellin fakte dhe argumente që vërtetonin dhe që s’kishin fije dyshimi se ata (pra mohuesit) ishin në rrugë të gabuar.

4- Prej vlerave të pejgamberëve dhe prej fakteve që vërtetojnë profetësinë e tyre, është sinqeriteti i plotë që kishin ndaj Allahut të Lartësuar, përulja ndaj Tij dhe shërbimi që ofruan në dobi të krijesave, siç ishte thirrja, përcjellja e dijes tek ta, etj. Profetët, gjithmonë e kanë thënë haptazi, duke ia përsëritur herë pas

here popujve të tyre fjalët: **“O populli im! Unë për këtë nuk kërkoj nga ju kurrfarë pasurie. Mua më shpërblen vetëm Allahu.”** (Hud, 29)

Prandaj, prej vlerave më madhore që përfitojnë pasuesit e profetëve, është se ata do ta arrijnë të njëjtën mirësi që patën vetë profetët. Kështu, Allahu prej mirësive të Tij, lartëson dikë në këtë botë dhe në botën tjetër, më tepër se ç'garojnë njerëzit e dunjasë pas dunjasë së tyre.

5-Të flasësh për qëllimet e besimtarëve dhe për mirësitë që Allahu u ka dhënë dhe të flasësh i bindur në emër të Zotit se Ai nuk do u japë mirësi, kjo nuk është asgjë tjetër përveçse shpifje e trashëguar nga armiqtë e profetëve. Për këtë arsye, në momentin kur populli i Nuhut filloi të fliste me kopetencia në emër të Zotit dhe filluan t'i përçmonin besimtarët, ai u tha: “As nuk them se unë jam engjëll e as do t'u them atyre, të cilët sytë tuaj i nënçmojnë, se Allahu nuk do t'u japë kurrfarë të mire. Allahu e di më mirë se ç'ka në shpirtrat e tyre.” (Hud, 31)

6-Njeriu gjithmonë duhet të kërkojë ndihmën e Allahut, të përmendë emrin e Tij sa herë që hipën apo zbret nga diçka, madje në çdo gjendje dhe lëvizje të falënderojë Allahun; të shtojë përmendjen e Tij, sidomos në rastet e shpëtimit nga fatkeqësitë dhe vështirësitë. Allahu i Lartësuar thotë: “Hipni në anije! Me emrin e Allahut ajo lundron dhe ndalet! Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë”. (Hud, 41)

Gjithashtu ka thënë: **“Kur të hipësh në barkë ti dhe ata që janë me ty, thuaj: ‘Qoftë lavdëruar Allahu, i Cili na shpëtoi prej popullit keqbërës!’”** (Muminunë, 28) Ashtu sikurse duhet të bëjë dua për begati aty ku qëndron kalimthi, siç janë vendpushimet në vendet e udhëtimit, apo siç janë dhe shtëpitë e përhershme të banimit. Këtë e themi duke u bazuar në fjalën e

Allahut që thotë: **“Dhe thuaj: ‘Zoti im, më zbarko në vend të bekuar, se Ti je më i miri për të na zbarkuar.’”** (Muminun, 29) E gjithë kjo, nxit në përmendjen e Allahut dhe të jep forcë në lëvizje dhe qëndrime, si dhe tregon forcën e besimit që ke në Zot. Përmendja e Allahut gjithashtu ndikon në zbritjen e begatisë, e cila është shoqëruesja më e mirë për njeriun, në çdo gjendje të tij, e pa të cilën ai nuk bën dot, qoftë dhe për një moment.

7- Devotshmëria ndaj Allahut dhe kryerja e detyrimeve të besimit janë prej shkaqeve, me të cilat fiton këtë botë; fiton gjithashtu pasardhës të shumtë, rizik dhe forcë trupore, pa anashkaluar dhe shumë shkaqe të tjera që mundësojnë dhe ndikojnë në arritjen e atyre që u përmendën më lart. Por duhet ditur se DEVOTSHMËRIA është e vetmja dhe s’ka tjetër përveç saj, me të cilën mund të arrihet mirësia e Ahiretit dhe shpëtimi nga dënimi i tij.

8- Shpëtimi nga dënimet e përgjithshme të kësaj bote, është vetëm për besimtarët, peygamberët dhe pasuesit e tyre. Ndërsa ndëshkimet e përgjithshme iu përkasin vetëm keqbërësve, pasardhësve të tyre dhe kafshëve të tyre, edhe pse këto të fundit nuk kanë mëkate, pasi rastet dhe ndodhitë ku Allahu ka lëshuar dënimin e Tij mbi përgënjeshtresit, i ka përfshirë edhe fëmijët dhe kafshët e tyre.

Ajo që përmendet në disa israilijate (shkrime) mbi popullin e Nuhut apo të tjerë, është se kur Allahu deshi t’i shkatërronte, bëri që gratë e tyre të mos lindnin, me qëllim që të mos përfshiheshin në dënim edhe fëmijët e tyre. Këto fjalë nuk kanë asnjë bazë dhe argument, madje bien ndesh me fjalët e Allahut ku thotë: **“Ruajuni ngatërresave, të cilat nuk i godasin vetëm ata që bëjnë keq; dhe ta dini se Allahu dënon ashpër!”** (Enfal, 25)



HISTORIA E HUDIT

(alejhi selam)

Allahu i Lartësuar e dërgoi Hudin (alejhi salatu ues selam) tek populli i tij (Ad'i i lashtë), të cilët banonin në Ah'kaf e pikërisht në dumat e shkretëtirës së Hadrameutit (Jemen).

E dërgoi në një kohë kur e keqja e tyre u shtua dhe filluan të tregonin kryeneçësi ndaj njerëzve duke thënë: **“Kush është më i fortë se ne?”** (Fussilet, 15) E mbi të gjitha, ky popull adhuronte idhujt dhe përgënjeshtronte të dërguarit e Zotit.⁷

Allahu e dërgoi në mesin e tyre që t'i ftonte në adhurimin e Allahut, të Vetëm dhe të Pashok. T'i ndalonte nga shirku (IDHUJTARIA) dhe kryeneçësia ndaj njerëzve.

E dërgoi që t'i ftonte me çdo mënyrë dhe t'u kujtonte ato mirësi të kësaj bote, që Allahu u kishte dhënë: furnizimin e mjaftueshëm dhe forcën fizike. Por ata e refuzuan thirrjen e

⁷ Pse Allahu i Lartësuar kur përmend popullin e Adit thotë: Populli i Adit përgënjeshtrroi të dërguarit,,” ndërkohë që tek ky popull ishte dërguar vetëm Hudi (alejhi selam)? Dijetarët kanë thënë: Përgënjeshtrimi i një profeti është përgënjeshtrim i të gjithë profetëve.Sh.p.

tij, shfaqën mendjemadhësi në përgjigje dhe thanë: **“O Hud! Ti nuk na ke sjellë kurrfarë prove të dukshme për fjalët e tua.”** (Hud, 53)

Në fakt ata po gënjenin, sepse çdo Pejgamberi, Allahu i ka dhënë prova, me anë të të cilave njerëzit do të besonin.⁸

E megjithatë, nëse Pejgamberët nuk do të posedonin prova të tjera veç faktit se feja me të cilën erdhën të gjithë ishte e njejtë, kjo do të mjaftonte si provë e dukshme se ajo fe është nga Allahu, për shkak të përsosmërisë që ka, rregullit, dobive dhe përshtatetjes për çdo kohë. Pa lënë mënjane vërtetësinë e ngjarjeve, urdhërimit e çdo të mire dhe ndalimit nga çdo e keqe, si dhe faktin se çdo Profet vërtetonte atë që ishte para tij dhe dëshmonte për të, ashtu sikurse e vërtetonte ai (Profet) që vinte pas dhe dëshmonte gjithashtu për të.

Prej provave të veçanta të Hudit: Fakti se ai ishte i vetëm në thirrjen e tij; i vetëm në përballje; i vetëm në momentin kur injoronte mendimet dhe humbjen e tyre; i vetëm kur përçmonte idhujt, ndërsa ata ishin të fuqishëm, tiranë dhe kryeneçë. Ata u munduan ta frikësonin me idhujt e tyre se, nëse nuk tërhiqej, do çmendej ose do t'i ndodhte diçka e keqe. Por ai i sfidoi hapur dhe u tha qartë: **“Unë kam dëshmitar Allahun, dëshmoni dhe ju, se unë jam larg nga idhujt që ju i adhuronin në vend të Tij. Të gjithë ju bëni komplot kundër meje dhe mos më jepni fare afat! Unë i mbështetem Allahut, Zotit tim dhe Zotit**

⁸ E përcjell Buhariu me nr. 4981 dhe Muslimi me nr. 152, 239 nga Ebu Hurejra (radijAllahu anhu). Hafidh ibn Haxher (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Kjo do të thotë se çdo profeti i është dhënë një apo më shumë se një argument me qëllim që nëse njerëzit e shohin do të besonin për shkak të atij argumenti.” (Fet’h el Bari 8/621,622)

tuaj. S'ka asnjë gjallesë që të mos jetë nën pushtetin e Tij. Me të vërtetë, Zoti im është në rrugë të drejtë.” (Hud, 54-56)

Ata nuk mundën ta lëndonin me asgjë të keqe! Pra, a ka provë më të madhe se kjo sfidë, me të cilën ai u përball me këta armiq, që në fakt ishin tepër të interesuar për ta shkatërruar thirrjen e tij (Hudit) me çdo formë?

Kur kryeneçësia e Popullit të Adit mori fund, ai u largua prej tyre dhe i paralajmëroi për zbritjen e dënimit. Dhe ja, dënimi erdhi dhe u shfaq në horizont! Momenti ishte mjaft i vështirë, thatësira dhe nevoja për shi ishte shumë e madhe.

Atë çast (kur panë retë e zeza) u gëzuan dhe thanë: **“Kjo re po sjell shiun!”**.

Allahu tha: **“Jo!” “kjo është ajo që ju e keni shpejtuar.”** Sepse më parë u shprehët duke thënë: **“Sillna atë (dënim) që po na premton dhe të shohim nëse thua të vërtetën!”** (Ahkaf, 22)

“Një erë që mbart një dënim të dhembshëm, që, me urdhrin e Allahut, shkatërron çdo gjë.” (Ahkaf, 24)

“Allahu ua dërgoi atyre shtatë netë dhe tetë ditë pareshtur. Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura. (Hakka, 7)

“E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre të zbrazëta; ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës.” (Ahkaf, 25)

Pasiqë jeta u kishte buzëqeshur, e krenaria kishte arritur kulmet dhe kërkesat e jetesës i kishin të plotësuar. Jo vetëm kaq, por u ishin nënshtruar edhe zonat dhe fiset përreth, megjithatë, as kjo nuk u vlejti, sepse Allahu u dërgoi një erë të

acartë në ditë fatkeqësie. “Për ta shijuar dënimin poshtërues që në këtë jetë; ndërsa dënimi në jetën tjetër do të jetë edhe më poshtërues dhe askush nuk do t’i ndihmojë. (Fussilet, 16)

“Ata i ndoqi mallkimi në këtë jetë dhe në Ditën e Kiametit. Me të vërtetë, fisi Ad e mohoi Zotin e tij. Qoftë larguar (nga mëshira e Allahut) fisi Ad, populli i Hudit!” (Hud, 60)

Allahu e shpëtoi Hudin dhe ata që besuan me të. **“Vërtetë në këtë ndodhi kishte argument”** që tregonte fuqinë e plotë të Allahut dhe nderimin e madh ndaj pejgamberëve dhe ndjekësve të tyre, duke i ndihmuar në jetën e kësaj bote dhe ditën kur të ringjallen krijesat. Është provë e qartë se e keqja shkatërrohet dhe fundi i saj është më i keqi dhe më i shëmtuari. Gjithashtu është argument që pohon ringjalljen dhe tubimin në Ditën e Madhe.

Dobi dhe mësimet të përfituara nga historia e Hudit (alejhis selam)

1- Ia vlen të rikujtojmë dobitë e mëparshme që kemi përmendur tek historia e Nuhut (alejhi selam) e që janë të përbashkëta pothuajse tek historitë e të gjithë profetëve.⁹

2- Allahu i Lartësuar me urtësinë e Tij na rrëfen ndodhitë e atyre popujve që jetuan pranë ose rreth gadishullin Arabik. Kjo për faktin se Kur’ani gjithmonë përmend (përdor) mënyrat më efikase në këshillim. Nëse vëren me kujdes, do të shohësh se

⁹ Aludon në faktin se të gjithë pejgamberët duke filluar me Nuhun e deri tek Muhamedi (alejhis salatu ues selam) ishin në unanimitet për thirrjen (e njerëzve) në monoteizmin e pastër dhe ndalimin e tyre nga shirku (idhujtaria).

si Allahu i Lartësuar i përdor këto këshillime në formën më të dobishme. Pa dyshim edhe në zonat e largëta, në Lindje apo në Perëndim të tokës, Allahu dërgoi peygamberë dhe ashtu sikurse peygamberët e përmendur në Kur'an, edhe këta ishin të pajisur me argumente të ngjashme, dhe njësoj si të tjerët, hasën në kundërshtime, nderime, apo edhe ndëshkime (nga populli).

Tek çdo popull, Allahu ka dërguar peygamberë. Ai na mundësoi që të përfitojmë duke na kujtuar çfarë kemi rreth e përqark, dhe ato (ndodhi) që brezat ia përcjellin njëri-tjetrit. Për më tepër, gjurmët që shohim, ecja pranë vendbanimeve të tyre në çdo kohë, kuptimi i gjuhës dhe natyra e përafërt me natyrën tonë, padyshim që të gjitha këto përcjellin dobi të madhe. Madje, kjo është më parësore se sa të informohemi për ndodhitë e disa popujve për të cilët nuk kemi dëgjuar asnjë lloj lajmi, gjuhën e të cilëve nuk e njohim dhe ngjarjet e të cilëve nuk kanë të bëjnë me ne, apo që s'kanë lidhje me atë që Allahu na tregon.

3- Nga e gjithë kjo, dalim në përfundimin se, përkujtimi i njerëzve me gjërat që i kanë më të kapshme në mendjet e tyre, më të përshtashme për gjendjet e tyre dhe më të perceptueshme nga ana e tyre, kjo u bën dobi atyre më shumë se diçka tjetër dhe është më parsësore se sa këshillimet e tjera, edhe pse mund të jenë të vërteta (të sakta), sepse edhe e vërteta qëndron në grada të ndryshme.

4- Këshilluesi apo mësuesi, nëse ecën në këtë rrugë, përpiket që dijen dhe mirësinë ta përcjellë tek njerëzit me mënyrat (format) që ata i kuptojnë. Mënyra se si komunikon me ta, nuk i bën që të largohen, por përkundrazi, ato çfarë ai u thotë, janë të kuptueshme për ta dhe përforcuese të argumentit që u

paraqet atyre, në këtë rast, ai do përfitojë për veten dhe do u sjellë dobi edhe të tjerëve.

Allahu i Madhëruar e tregoi këtë fakt në fund të historisë së popullit të Adit, ku thotë: **“Edhe më parë Ne kemi shkatërruar vendbanime rreth jush e u kemi shpjeguar atyre shpalljet Tona.”** D.m.th u sollëm argumente në forma dhe mënyra të ndryshme **“Që ata të mund të ktheheshin (në rrugën e drejtë).** (Ahkaf, 27) Pra që përfitimi të ishte më i arrirë!

5- Ndërtesat e larta që ngrihen për mburrje, mendjemadhësi, luks, apo për të treguar tirani ndaj njerëzve, konsiderohen prej veprave të nënçmuara të trashëguara nga popujt tiranë. Allahu i Lartësuar kur rrëfen ndodhinë e Adit dhe mospëlqimin e Hudit për veprimin e tyre, thotë: **“A mos vallë në çdo kodrinë po ngrini përmendore, për t’u tallur, dhe ngrini pallate, sikur do të jetoni gjithmonë?** (Shuara, 128-129)

6- Për ta përmbledhur mund të themi se: Ndërtimet, kështjellat, fortifikatat, shtëpitë apo çfarëdo qofshin ato, ndahen në:

1- Ndërtime sipas nevojës dhe dihet se ato (nevojat) janë të ndryshme dhe të lloj-llojshme. Këto (ndërtime) konsiderohen të lejuara dhe me anë të nijetit (qëllimit) të mirë mund të arrihen mirësi të mëdha.

2-Ndërtime që përdoren si mburojë dhe fortifikatë nga e keqja e armiqve dhe vendstrehime, me anë të të cilave ruhet shteti dhe vatani. Pra, diçka që u sjell dobi muslimanëve dhe i ruan nga e keqja! Ky lloj ndërtimi përfshihet tek ajo që quhet: *luftë në rrugë të Allahut* dhe bën pjesë në urdhrin që kemi për t’u ruajtur nga armiqët.

3- Ndërtime që përdoren për mendjemadhësi, mburrje, tirani ndaj njerëzve dhe harxhim pasurie, pasuri e cila realisht duhet të përdoret në gjëra të dobishme. Ky lloj i ndërtimit

është i nënçmuar dhe mu për këtë, Allahu nuk e pranoi që të praktikohet nga populli i Adit dhe popujt e tjerë.

7- Mendja, logjika, zgjuarsia apo forca materiale, përfundimet dhe gjurmët që vijnë si rrjedhojë e tyre, edhe nëse janë madhore dhe peshojnë rëndë, nuk i bëjnë dobi njeriut, veçse nëse i shoqëron me besimin tek Allahu dhe të dërguarit e Tij.

8- Mohuesi i argumenteve të Zotit, përgënjeshtuesi i Profetëve, edhe nëse i jepet një afat apo joshet pas kësaj bote, duhet ditur se fund i tij është tragjik.¹⁰ Dëgjimi, shikimi dhe logjika nuk kanë për t'i bërë dobi aspak kur të vijë urdhri i Allahut (dënimi). Për popullin e Adit, Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne i kishim bërë ata më të fuqishëm se ju¹¹ dhe u kishim dhënë atyre dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por as dëgjimi i tyre, as shikimi i tyre e as zemra e tyre, nuk u sollën kurrfarë dobie, sepse mohuan shpalljet e Allahut; ata i goditi ajo me të cilën talleshin.** (Ahkaf, 26)

Si dhe në ajetin tjetër ku thotë: **“Hynitë, që ata i adhuronin në vend të Allahut, nuk i ndihmuan aspak, kur erdhi urdhri i Zotit tënd dhe nuk iu shtuan atyre kurrgjë tjetër, përveç humbjes.** (Hud, 101)

¹⁰ Përcillet nga Ukbeh bin Amir nga Profeti (alejhi salatu ues selam) se ka thënë: “Nëse vëren se Allahu i jep dikujt prej dunjasë çfarë të dojë, edhe pse i zhytur në mëkate, dijeni se kjo është joshje (drejt shkatërrimit), më pas lexoi fjalën e Allahut që thotë: **“Kur ata i harruan paralajmërimet Tona, Ne ua hapëm dyert e çdo mirësie. Por, teksa gëzoheshin me atë që u dhamë, Ne i dënuam befasisht dhe atëherë ata u zhytën në dëshpërim.** (En'am, 44) Hafidh el Iraki në librin El Mugnij an Hamlil Esfar ka (3772) ka thënë: E përcjell Ahmedi, Taberaniu dhe Bejhakui në Shuab el Iman me sened të mirë.

¹¹ Banorët e Mekës.



HISTORIA E SALIHUT

(alejhi selam)

Populli Themud - i emërtuar ndryshe si Adi i mbramë - jetonte në Hixhër¹² dhe në zonat përreth. Ata zotëronin bagëti të shumta dhe njiheshin për bujqësi. Mirësitë e Zotit u vinin pandërprerë. Luginat i shfrytëzonin për të ndërtuar kështjella të zbukuruara, ndërsa malet i gdhendnin me preçizitet dhe i kthenin në shtëpi banimi.

Të gjitha këto mirësi ata i refuzuan dhe i mohuan (se ishin prej Allahut), adhuruan të tjerë në vend të Tij. Për këtë arsye, Allahu dërgoi vëllain e tyre Salihun, i cili rridhte prej atij fisi dhe e njihnin shumë mirë prejardhjen dhe trungun e tij familjar. I dinin vlerat e tij, përsosmërinë e moralit, sinqeritetin dhe mbajtjen e amanetin.

Salihu (alejhi selam) i ftoi për tek Allahu; i ftoi që adhurimin t'ia kushtonin vetëm Atij dhe të braktisnin idhujt që i adhuronin në vend të Allahut. Ai u kujtoi mirësitë e vazhdueshme dhe gjeneratat e popujve që kishin jetuar aty pranë, por shumë pak e ndoqën.

¹² Zonë në veri të Arabisë Saudite!

Në momentin kur i këshilloi, u dha fakte dhe prova që pohojnë obligueshmërinë e njësimit të Allahut (në adhurim), kjo i bëri të ndiheshin keq, madje u larguan edhe më shumë dhe treguan mendjemadhësi duke thënë: **“O Salih! Ti ke qenë i nderuar mes nesh dhe shpresa jonë para kësaj (fjale).** (Hud, 62)

D.m.th, ne prisnim se do të ishte më i miri në mesin tonë, për shkak se tek ti buronin moralet e plota dhe sjelljet më të mira.¹³

Ata i pohuan cilësitë e Salihut para se ai t'i ftonte, dhe nuk patën ndonjë arsye tjetër ta shihin me syrin e përçmimit veç faktit se ai i ftoi të adhuronin Krijuesin në vend të krijesave dhe të gëzonin lumturinë e amshueshme. “Faji” i tij ishte se kundërshtoi baballarët e tyre të humbur ndërkohë që pasardhësit ishin edhe më të humbur se ata!

Më pas ai u solli një provë madhështore, një argument mahnitës dhe një mirësi e cila do të vlente për të gjithë fisin Themud. Ai u tha: **“Kjo është deveja e Allahut.”**, e cila nuk ngjan me asnjë deve tjetër në qënien, vlerën dhe dobitë e saj. **“Shenjë e qartë për ju.”**, që pohon siguritetin tim dhe mëshirën e gjerë të Zotit tuaj!

“Prandaj lëreni të kullosë në tokën e Allahut.” (Hud, 64)

¹³ Hafidh ibn Kethiri (Allahu e mëshiroftë) në komentin e fjalës së Allahut që thotë: “Ata thanë: **“O Salih! Ti ke qenë i nderuar mes nesh dhe shpresa jonë para kësaj (fjale).”** (Hud, 62] thotë: D.m.th: Ne shpresonim që logjika jote të ishte më e plotë para se të na i thojë këto fjalë, e që aludojnë në thirrjen që ti na bën në njësimin e adhurimit dhe braktisjen e idhujve që adhurojmë si dhe të largohemi nga feja e baballarëve dhe gjyshërve. Për më tepër thanë: **“A mos vallë po na ndalon ta adhurojmë ato që i kanë adhuruar prindërit tanë? Vërtet, ne jemi në mëdyshje për thirrjen tënde.”** (Hud, 62) (El Bidaje uen Nihaje 1.133)

Allahut i përket furnizimi i kësaj deveje, ndërsa juve, përfitimi nga dobitë e saj. Ajo pinte ujë në njërën ditë, ndërsa i gjithë fisi shkonte dhe përfitonte nga qumështi i saj, gjithsecili i mbushte enët me qumështin e saj. Ditën tjetër keni radhën ju të pini nga burimi dhe kështu ecën gjërat derisa deshi Zoti i Lartësuar.

Në qytetin e tyre ishin nëntë vetë prej shejtanëve njerëz që refuzonin në mënyrë të prerë atë që solli Salihu dhe me këtë i pengonin njerëzit nga rruga e Allahut **“Në qytet kishin qenë nëntë vetë që bënë ngatërresa e nuk vinin rregull.”**

(Neml, 48)

Kohë më parë, Salihu (alejhi selam) ua kishte tërhequr vërejtjen nga therja e devesë, sidomos kur kishte parë mendjemadhësinë dhe refuzimin e të vërtetës nga ana e tyre. E megjithatë, të parën gjë që bënë këta dashakeqë ishte organizimi i një tubimi nga ku do të binin dakort për therjen e devesë dhe kështu ndodhi!

Therjen e devesë e morën përsipër njerëzit më të këqinj. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë).”** (Shems, 12), D.m.th pasi ranë dakort dhe caktuan detyrat e zbatimit të planit dhe ngarkuan një person që ta therte devenë.

Ai u ngrit me të shpejtë, u përgatit mirë dhe mori përsipër therjen e saj, ndërsa ata të gjithë ishin të kënaqur madje e urdhëruan këtë veprim. Po, ai e theri devenë, por ky akt ishte alarmi paralajmërues i shkatërimit të plotë të këtij populli.

Salihu (alejhi selam) kur e ndjeu (se dënimi po afrohej) dhe pa se diçka e tmerrshme do të ndodhte dhe se dënimi ishte i pashmangshëm, sepse krimi (që kishin bërë) kishte kaluar

çdo kufi dhe nuk kishte mbetur asnjë mënyrë përmirësimi për gjendjen e tyre, u tha: **“Jetoni në shtëpitë tuaja edhe tri ditë! Ky është premtimi i vërtetë”**. (Hud, 65) Me këto fjalë ai u solli ndërmend dënimin, si atyre që jetonin aty afër por dhe atyre që jetonin më larg.

Gjatë këtij afati tre ditor, të nëntë personat u mblodhën dhe ranë dakort për të kryer një vepër edhe më të llahtarshme dhe më të frikshme se therja e devesë! Ata vendosën të vrisnin profetin e tyre, Salihun! U zotuan, dhanë besën dhe u betuan me betimet më të forta dhe e mbajtën të fshehur qëllimin e tyre nga frika se mos i pengonte fisi i Salihut, sepse ai i përkiste një familjeje dinjitoze, krenare dhe të ndershme.

Ata thanë: **“Betohuni në Allahun se natën do ta vrasim atë me gjithë familjen e tij.”** (Neml, 49) Pastaj, nëse ata mendojnë se ne e kemi vrarë, u betohemi përpara të afërmeve të tij **“Ne nuk kemi qenë të pranishëm në zhdukjen e familjes së tij dhe se po themi të vërtetën.”** (Neml, 49)

Realisht, ata e organizuan këtë kurth të madh, por nga njëra anë ata bënë kurthe, ndërsa Allahu ia prishte kurthet në favor të Salihut (alejhi selam).

Kur u fshehën rrëzë malit duke pritur rastin e volitshëm për të vrarë Salihun, Allahu e filloi dënimin e tyre. Për të qenë ata të parët që do u prijnë popullit të tyre në Zjarrin e Xhehenemit.

Allahu çoi një shkëmb nga maja e malit dhe i zuri poshtë dhe u vranë në mënyrën më të keqe.

Kur u plotësuan ditët, atyre u erdhi një britmë e madhe nga lart dhe një tronditje e fortë nga poshtë dhe kështu u gdhinë si

të ngujuar. Allahu e shpëtoi Salihun (alejhi selam) dhe ata që besuan bashkë me të.

“Ai u largua prej tyre dhe tha: ‘O populli im, unë ju solla shpalljet e Zotit tim e ju këshillova, prandaj pse të hidhërohem për popullin e pafe?!’” (Arafë, 93)¹⁴

Dobi dhe mësimet të përfituara nga historia e Salihut (alejhi selam)

1- Të gjithë Pejgamberët kanë pasur të njëjtën thirrje! Ai që përgënjeshtroi njërin prej tyre, në fakt i ka përgënjeshtuar të gjithë, sepse përgënjeshtroi të vërtetën që solli gjithsecili prej tyre. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar në çdo ndodhi ku flet për Pejgamberët, thotë: **“Populli i Nuhut, i quante gënjeshtarë të Dërguarit.”** (Shuara, 105) **“Fisi Ad i quante gënjeshtarë të Dërguarit.”** (Shuara, 123) **“Edhe fisi Themud i quante gënjeshtarë të Dërguarit.”** (Shuara, 141)

2- Ndëshkimet e Zotit ndaj popujve kryeneçë kanë ndodhur atëherë kur ata kishin arritur kulmin e tiranisë dhe kufirin

¹⁴ Tregohet për Profetin e Allahut Salihun se, ai i foli popullit pasi që ishin zhdukur, ndërkohë që kishte zënë vendet e tyre duke u thënë: **“Ai u largua prej tyre dhe tha: ‘O populli im! Unë ju solla mesazhin e Zotit tim dhe ju këshillova, por ju nuk i donit ata që këshillojnë’”**. (Arafë, 79) D.m.th u përpoqa shumë që t’ju udhëzoja me çfarë kisha mundësi dhe tregova kujdes për këtë me fjalë, vepra dhe nijet. **“Por ju nuk i donit ata që këshillojnë!”** D.m.th, natyra juaj nuk e pranonte të vërtetën e as që e donte atë, prandaj arritët deri në këtë dënim të dhembshëm, i cili nuk ka për tu ndërprerë ndaj jush deri në pafundësi. Unë nuk kisha asnjë lloj mundësie e as nuk munda të largoja nga ju përveç asaj që kisha për detyrë në kumtimin e shpalljes dhe këshillës ndaj jush, gjë të cilën e kam bërë, por Allahu vepron çfarë të dojë. Në këtë formë edhe Profeti i Allahut, Muhamedi, (alejhi selam) u qe drejtuar të vlarëve në pusin e kalibit pas betejës së Bedrit. Pas tre netëve, ai qëndroi aty, i thirri në emrat e tyre dhe të baballarëve duke u thënë: **“A e gjetët atë që Zoti jua kishte premtuar?”** Pastaj tha: **“Ata në këtë moment dëgjojnë atë që u them.”** Për më tepër shih (El Bidaje uen Nihaje 1/137-138)

maksimal të krimit. Mohimi dhe përgënjeshtrimi i tyre solli shkatërrimin, por ky dënim u bë i patjetërsueshëm atëherë kur e keqja kishte arritur kulmin. Për këtë arsye, momenti më shpresëdhënës që tregon bindshëm afrimin e ndëshkimit të zullumqarëve dhe kriminelëve, është atëherë kur e keqja e tyre arrin majat. Allahu u qëndron në pritë, u jep afat dhe përsëri u jep afat, por kur i ndëshkon, e bën siç i ka hije Krenarisë dhe Plotfuqishmërisë së Tij.

3- Besimet e kota që janë ngulitur tek njerëzit e që janë trashëguar nga njerëzit, mendimi për të cilët përgjithësisht është i mirë si p.sh baballarët, etj, konsiderohen prej pengesave më të mëdha në pranimin e të vërtetës. Gjendja është e tillë se, ata nuk janë as me realitetin dhe as me faktet dhe nuk zënë asnjë vend në argumentimet e sakta që pohojnë të vërtetën. Për këtë arsye, pengesa më e madhe që e bëri popullin e Salihut të kundërshtonte thirrjen e tij ishte: **“A mos vallë po na ndalon të adhurojmë ato që i kanë adhuruar prindërit tanë?”** (Hud, 62)

Madje të gjithë popujt përgënjeshtroes që e refuzuan të vërtetën dhe thirrjen e Profetëve shpreheshin me këto fjalë: **“Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre”**. (Zuhruf, 23)

Kjo rrugë akoma vazhdon të ndiqet nga ndjekësit e të kotës, rrugë të cilën e kanë skicuar shejtanët për t'i larguar njerëzit nga rruga e Allahut. Por është fakt se, rruga e profetëve është rruga e udhëzimit dhe e të vërtetës, e çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes?



HISTORIA E IBRAHIMIT

(alejhi selam)

Babai i pejgamberëve

Allahu i Lartësuar, ka përmendur në librin e Tij shumë ngjarje dhe ndodhi nga jeta e Ibrahimit (alejhi selam). Tek këto ndodhi, ne gjejmë shembullin që duhet të ndjekim nga pejgamberët në përgjithësi dhe nga Ibrahim (alejhi selam) në veçanti.

Allahu i Lartësuar e urdhëroi profetin tonë (Muhamedin) dhe na urdhëroi neve që të ndjekim fenë e pastër të Ibrahimit, besimin, moralet dhe vepra të tjera që kishin të bënë me të, apo që u sjellin dobi të tjerëve.

Zoti i dha pjekurinë, i mësoi urtësinë që në moshë të vogël dhe i mundësoi të shihte mbretërinë e qiejve dhe të tokës. Për këtë arsye, ai ishte njeriu me sigurinë më të madhe (në besim), me dijen më të plotë, më i qëndrueshmi në fenë e Zotit dhe më i mëshirshmi ndaj krijesave.

Allahu e dërgoi atë (Ibrahimin) tek një popull idhujtar që adhuronin Diellin, Hënën dhe yjet. Ata ishin filozofët Sabi'in

që konsiderohen prej sekteve më të djallëzuara dhe më të dëmshme ndaj njerëzve. Ibrahim i ftoi ata në forma dhe mënyra të ndryshme.

Mënyra e parë: I ftoi me një mënyrë, që për një njeri të logjikshëm do të ishte e pamundur të mos i përgjigjej asaj thirrjeje. Ata adhuronin shtatë planetet lëvizëse, mes tyre Diellin dhe Hënën. Madje për këtë ata kishin ndërtuar faltore të posaçme, të quajtura Hejkel.

Në formë bashkëbisedimi logjik, ai u tha: *O populli im! Ejani të shohim se a meritojnë të adhurohen këto planete në Univers!*

“Kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: “Ky është Zoti im!” (En’Am, 76)

Debati, ndryshon nga format e tjera të bashkëbisedimit, në shumë gjëra:

Së pari: Debatuesi, mund të thotë diçka që realisht nuk e beson. Mbi atë, ai ndërton argumentin e vet dhe ngre faktet përballë kundërshtarit të tij.

Në momentin kur Ibrahim theu idhujt dhe populli idhujtar i tha: **“A ti e bërë këtë me zotat tanë, o Ibrahim?!”** (Enbija, 62) Ai (Ibrahimi), bëri me shenjë drejt idhullit që s’e kishte thyer dhe u tha: **“Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre. Pyetini ata, nëse flasin!”** (Enbija, 63)

Dihet se qëllimi i tij ishte t’i sfidonte përballë argumenteve dhe realisht ashtu ndodhi. Nga këtu e kuptojmë më shumë fjalën e tij (Ibrahimit) kur thotë: **“Ky është Zoti im!”** (En’Amë, 76)

D.m.th, nëse ai meriton që të adhurohet, pasi e patë gjendjen dhe cilësitë e tij, atëherë ai është zoti im, ndërkohë ai e dinte shumë mirë se, ky yll nuk meritonte dhe nuk kishte pjesë në zotërim apo adhurim, as edhe sa grimca.

Por ai deshi t'i zinte mat me argument: **“Dhe, kur perëndoi ylli, ai tha: “Nuk i dua ata që perëndojnë”.** (En'amë, 76)

Çdo send që orvatet mes ekzistencës dhe inekzistencës, prezencës apo mungesës, çdo njeri i logjikshëm e kupton se nuk është i plotë, prandaj nuk mund të jetë Zot.

Pas kësaj, ai kaloi tek hëna dhe kur e pa atë duke lindur tha: **“Ky është Zoti im!”** Por, pasi ajo perëndoi, ai tha: **“Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri nga të humburit”.** (En'amë, 77) Me këtë, ai (alejhi selam) po mendohej t'i mësonte.

Ai (Ibrahimi) e vuri veten në rolin e atij që bie dakort me ta, por jo praktikisht duke i ndjekur në bindje e adhurim. Ai, me paraqitjen e argumenteve, në sytë e popullit, nënkuptonte sikur deshte të nxirrte në pah hyjnizimin e yjeve dhe hënës. Në momentin kur ata perëndonin, dhe kjo faktohej me argumente logjike dhe shqisore se hyjnizimi i tyre ishte i pavlerë, atëherë, ai ua bëri të qartë se këto (yjet dhe hëna) nuk janë zota madhështorë që meritojnë të adhurohen.

“Kur vërejti Diellin duke lindur, ai thërriti: “Ky është Zoti im, ky është më i madhi!” (En'am, 78)

D.m.th më i madh nga yjet e tjerë, si hëna në rastin konkret. E nëse diellit i ndodh ajo që u ndodhi edhe yjeve të tjerë (perëndon), atëherë automatikisht merr të njëjtin gjykim si

ata. Ndërkohë, ishte bërë mjaft e qartë tek të gjithë, se adhurimi i diçkaje që perëndon, konsiderohet gjëja më e pavlerë.

Në ato momente, ai i mbërtheu (para fakteve), i detyroi të pranonin, duke iu kundërvënë me argumente dhe duke u thënë: **“O populli im! Unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët”!** (En’am, 79)

Ky ishte një argument i qartë logjik se Ai (Allahu) është Krijuesi i Botës së dukshme dhe të padukshme, dhe që njerëzit duhet ta njohin me adhurim dhe sinjeritet (Allahun), dhe se këto galaktika yjesh janë krijesa nën mbykëqyrjen e Tij dhe nuk kanë cilësi bindëse për të merituar adhurim.

Por ata filluan ta frikësonin Ibrahimin me idhujt e tyre, duke i thënë se ata (idhujt) do i sillnin fatkeqësi. Ky është argument se idhujtarët janë të zhytur në trillime të kota dhe mendime të ulta, sepse besojnë se zotat e tyre kishin fuqi për t’u sjellë dobi atyre që i adhuronin dhe për t’i dëmtuar ata që i braktisnin dhe i cënonin.

Ai (Ibrahimi) u tha atyre qartë se nuk kishte frikë aspak dhe se frika e vërtetë qëndronte pikërisht për gjendjen e tyre. Ai u tha: **“E si të frikësohem nga zotat tuaj të rremë, ndërkohë që ju nuk keni frikë t’i shoqëroni Allahut idhuj, për të cilët Ai nuk ju ka zbritur kurrfarë argumenti?! Cili nga ne e meriton të jetë i sigurt? Më thoni, nëse njihni të vërtetën!”** (En’amë, 81)

Allahu i dha përgjigje kësaj pyetjeje, e cila do të përfshinte rastin e kësaj ndodhie si dhe rasteve të tjera që ndodhin në çdo kohë, duke thënë: **“Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin**

besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.” (En'am, 82)

Allahu e lartësoi të dashurin e Tij Ibrahimin, duke i dhënë dije dhe argument, ndërsa ata (idhujtarët) e patën të pamundur t'i dilnin në mbrojtje të kotës. Përtej këshillave dhe argumenteve të qarta, prapë se prapë mbetën të paluhatur në atë që ishin. Atyre nuk u bëri dobi këshilla, përmendja dhe paraqitja e argumenteve.

Ibrahimi (alejhi salam) vazhdoi t'i ftonë tek Allahu dhe t'i ndalonte nga adhurimi i idhujve. Thirrja e tij ishte e përgjithshme dhe e përvëçme.

Një ndër ta, që i kushtoi thirrje të veçantë, ishte babai i tij Azeri, të cilin e ftoi në disa mënyra të dobishme por: **“Vërtet, ata që merituan Fjalën¹⁵ e Zotit tënd, nuk besojnë, edhe sikur t'u vijnë të gjitha shenjat, derisa të shohin dënimin e dhembshëm.** (Junus, 96-97)

Prej fjalëve që Ibrahim i tha babait: **“...O babai im! Përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi? O babai im! Mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s'të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!** (Merjem, 42-43)

Shiko sa fjalë të bukura këto që tërheqin zemrat. Ai nuk i tha babait se ti je injorant! Por iu drejtua me urtësi e butësi: **“O babai im! Mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s'të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë! O babai im! mos adhuro djallin, sepse ai është gjithmonë i pabindur ndaj të Gjithëmëshirshmit.**

¹⁵ D.m.th. zemërimin dhe dënimin e Tij.

O babai im! Unë kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi e kështu të bëhesh i afërm i djallit”! (Merjem, 43-45)

Me thirrjen e tij, ai (Ibrahimi) kaloi nga një metodë në një tjetër, me qëllim që të kishte sukses dhe të bënte dobi, e megjithatë babai i tha: “... **“O Ibrahim! Si guxon t’i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë”!** (Merjem, 46)

Ibrahimi nuk u zemërua me të dhe nuk ia ktheu me të njëjtat fjalë, përkundrazi, ia ktheu me mirësi duke i thënë: “... **“Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t’i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua.”** (Merjem, 47)

Që do të thotë: Unë nuk do të flas me ty veçse me fjalë të mira, jo me fjalë të vrazhda. Unë nuk e humb shpresën nga udhëzimi i Zotit për ty: **“Do t’i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua.”** (Merjem, 47)

Domethënë: i Butë dhe i Mëshirshëm! Butësia e Tij më ka mësuar për mirësitë dhe bukuritë që ajo (butësia me të tjerët) sjell. Gjithashtu, Ai gjithmonë është përgjigjur ndaj lutjeve të mia.

Ibrahimi (alejhi selam), e vazhdoi thirrjen dhe dialogun me popullin e tij. Ai i sfidoi (idhujtarët) dhe i hodhi poshtë të gjitha argumentet dhe dyshimet e tyre. Ai deshi të përballej me fakte edhe më të forta, e të qëndronte i palëkundur, përballë kryeneçësisë, forcës dhe fuqisë së idhujtarëve, pa u ndrojtur dhe pa u frikësuar aspak prej tyre.

Një ditë, kur idhujtarët dolën në një prej festave të tyre, ai (Ibrahimi) doli bashkë me ta. Hodhi një shikim nga yjet dhe tha: **“Vërtetë unë jam i sëmurë.”** (Safatë, 89)

Ai pati frikë, se nëse do të mbante qëndrim ndryshe, nuk do i'a arrinte qëllimit, sepse e dinin urrejtjen që ushqente Ibrahimi ndaj idhujve të tyre; e dinin se sa shumë i pengonte dhe luftonte ndaj adhurimit të atyre idhujve.

Kur (idhujtarët) mbërritën në shkretëtirë, ai (Ibrahimi) u kthye tek vendi ku qëndronin idhujt dhe i theu, i bëri copë-copë, që të gjithë, me përjashtim të idhullit më të madh. Atë e la qëllimisht, për t'i kushtëzuar para fakteve.

Kur u kthyen nga festa, vajtën menjëherë tek idhujt në shenjë respekti, nënshtrimi dhe dashurie dhe i panë në gjendjen më të keqe të mundshme dhe thanë: **“Kush i bëri kështu zotat tanë? Me të vërtetë, ai është keqbërës!”** Të tjerët u përgjigjën: **“Dëgjuam një djalosh që i përgojonte.”** (Enbija, 59-60)

Domethënë: që fliste për të metat e tyre, në mënyrë ofenduese.

“Atë e quajnë Ibrahim”.

Kur u siguruan se Ibrahimi i kishte thyer në të vërtetë, thanë: **“Atëherë silleni atë para syve të botës, që ata të dëshmojnë.”** (Enbija, 61)

Pra (silleni Ibrahimin), para këtij grumbulli të madh njerëzish, qortojeni sa të mundeni, pastaj ndëshkoheni atë.

Këtë synonte edhe Ibrahim (alejhi selam), sepse donte që e vërteta të shfaqej dukshëm para syve të të gjithëve. Kur njerëzit u mbledhën, ata e sollën Ibrahimin dhe i thanë: **“Ti i bërë kështu zotat tanë, o Ibrahim?” Ai tha: “Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre.”** (Enbija, 62-63)

Kishte për qëllim idhullin që nuk ishte thyer. Me këtë që u tha, ata ishin mes dy alternativave:

1- Të pranonin të vërtetën, nëse do të kishin një logjikë të shëndoshë, sepse dihet që një send i ngurtë, s’mund ta bëjë diçka të tillë.

2- Ose të thonin: Po, ai (idhulli) e ka bërë këtë dhe se ti (Ibrahim) je i pafajshëm dhe i pa ngarkuar me pasoja.

Ibrahimi (alejhi selam), e dinte shumë mirë se ata nuk mund ta pranonin opsionin e dytë. Ai u tha: **“Pyetini ata, nëse flasin!”**

Ai u propozoi diçka, për të cilën ata ishin të bindur që ishte e pamundur.

Aty u shfaq dukshëm e vërteta, ata u dorëzuan para saj dhe iu kthyen vetes me qortime duke thënë: **“Atëherë ata i thirrën mendjes dhe i thanë njëri-tjetrit: “Me të vërtetë, ju vetë jeni keqbërësit.”**

Mohimi që u bënë idhujve nuk zgjati shumë, edhe pse i panë argumentet që nuk mund të kontestoheshin. Megjithatë, shumë shpejt iu kthyen besimeve dhe bindjeve të tyre të kota, që ishin gdhendur në zemrat e tyre dhe ishin kthyer në varësi ndaj tyre. Edhe nëse shihnin diçka që i hidhte poshtë, atë e quanin rastësi, e cila shumë shpejt do të zhdukej.

“Pastaj ulën kokat dhe i thanë: “Sigurisht që ti e di, se këta nuk flasin!” (Enbija, 65)

Në atë moment, pasi që argumentet dolën në pah dhe qenë të pranuar para të gjithë njerëzve, Ibrahimi i nënçmoi: **“Ai u tha: ‘Mos vallë, ju adhuron në vend të Allahut gjëra që nuk mund t’ju sjellin kurrfarë dobie e as dëmi?! Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuron në vend të Allahut! A nuk arsyetoni?!’”** (Enbija, 66-67)

Nëse mendjet tuaja do të logjikonin, nuk do të qëndronin akoma në adhurimin e diçkaje, që nuk i sjell vetes asnjë dobi dhe që nuk largon diçka që mund ta dëmtojë.

Kur e panë veten të mundur para argumenteve, kaluan në përdorimin e forces dhe kryeneçësisë, vetëm e vetëm për të ndëshkuar Ibrahimin (alejhi selam).

“Ata thirrën: ‘Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni të bëni ndonjë vepër!’” (Enbija, 68)

Ata ndezën një zjarr të madh dhe e hodhën Ibrahimin brenda.

I gjendur në këtë vështirësi, Ibrahimi tha: **“Hasbija Allahu ue Niamel Uekil.”** (Më mjafton Allahu, Ai është Mbrojtësi më i Mirë).¹⁶

¹⁶ Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thotë: Fjala “Hasbija Allahu ue niamel Uekil” është fjala që ka përmendur Ibrahimi kur e hodhën në zjarr. Është fjala që ka përmendur Muhmedi (alejhi selam) atëherë kur i thanë: **“Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!” e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!”** (Al imran 173) E përcjell Buhariu me nr. 4563.

“Ne thamë: ‘O zjarr! Bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!’” (Enbija, 69) Zjarri nuk e dëmtoi aspak.

“Ata deshën ta lëndonin.” Me qëllim që t’u dalin në krah idhujve dhe t’i mbanin zemrat e tyre dhe zemrat e ndjekësve, të nënshtruara dhe të përgjëruara, ndaj këtyre idhujve. Por kurthi që përgatitën, u kthye në makth për ta, sepse Ibrahim i ishte ai që triumfoi kundrejt të gjithëve.

Edhe mbreti i tyre debatoi me Ibrahimin me arrogancë dhe kryeneçësi **“Sepse Allahu i kishte dhënë pushtet.”** (Bekare, 258)

Ibrahimi i tha: **“Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje” - ai u përgjigj: “Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje”.** (Bekare, 258)

Ibrahimi (alejhi selam) e detyroi atë, që të hiqte nga mendja një herë e mirë se ai mund të posedonte fuqi absolute dhe i tha: **“Allahu e sjell Diellin nga Lindja. Sille ti nga Perëndimi!”** Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. **Allahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës.** (Bekare, 258)

Pas gjithë kësaj që ndodhi, Ibrahim bashkë me gruan e tij dhe djalë e xhaxhait, Lutin, emigruan fshehurazi për në tokën e Shamit. Gjatë qëndrimit atje, ai shkoi në Egjipt me gruan e tij Sarën, e cila ishte gruaja më e bukur!

Mbreti i Egjiptit, që njihej si tiran, kryeneç dhe i padrejtë, nuk e mbajti veten kur e pa Sarën. Deshi ta kishte të tijën. Ajo iu lut Allahut që ta shpëtonte prej tij dhe gati sa nuk vdiq nga frika. Më pas ai e la të shkonte. Pastaj deshi t’i afrohej përsëri. Sa herë që i afrohej, ajo lutej dhe ai zmbrapsej. Në fund, ajo

u lut përsëri dhe ai e la të ikte. Allahu e ruajti nga e keqja e këtij mbreti, ndërsa ky i fundit i dhuroi asaj Haxheren, një shërbëtore Kobte.¹⁷

Duke qenë se Sara nuk lindte dot fëmijë, ia dhuroi shërbëtoren e saj Ibrahimit, me shpresën se Allahu do ta furnizonte me ndonjë fëmijë. Dhe ashtu ndodhi, Haxherja lindi Ismailin, edhe pse Ibrahimi ishte në moshë të thyer dhe kjo e gëzoi pa masë.

Sara (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) u bë xheloze dhe u betua se nuk do të jetonte me Ibrahimin përsa kohë që Haxherja ishte me ta. Kjo ndodhi për një urtësi të madhe që deshi Allahu të realizohej. Kjo ngjarje do të bëhej shkak që Ibrahimi bashkë me Haxheren t'i drejtohej vendit, ku do të ndërtohej më pas Shtëpia e Shenjtë (Qabja).

Ibrahimi, bashkë me Haxheren dhe djalin e tyre Ismailin u nisën për në Mekë. Asaj kohe, atje (në Mekë) nuk kishte njeri, nuk kishte ujë dhe as bimësi. Ibrahimi i la familjes një enë të mbushur me ujë, një shportë me hurma dhe i vendosi diku pranë pusit të Zemzemit, pastaj u largua.

Kur mbërriti në kodrën Eth-Thenije, prej nga mund t'i shihte që të dy, Ibrahimi u lut me këto fjalë: **“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë.** (Ibrahim, 37)

¹⁷ Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ue selem] ka thënë; “Ibrahimi, profeti i Allahut, nuk ka gënjyer kurrë, përveçse në tri raste; Dy herë për hir të Allahut: kur tha se ishte sëmure; kur tha se

Haxherja iu nënshtrua urdhrit të Zotit, filloi të ushqehet me ato hurma dhe të pinte nga ai ujë, derisa mbaruan hurmat dhe uji. Ajo kishte etje, po ashtu edhe fëmija i saj përpëlitej nga etja.

Në atë gjendje, ajo shkoi për të parë mos shihte dikë për ta ndihmuar. U ngjit në kodrën e Safasë, hodhi një shikim, por nuk pa asgjë. Pastaj shkoi për në kodrën e Meruas, u ngjit lart, hodhi një shikim, por nuk pa askënd.

Kështu vazhdoi të ecte mes dy kodrave, edhe pse ndihej e pikëlluar, kërkonte pa ndaluar ndihmën e Allahut për veten dhe fëmijën e saj. Ajo ecte dhe kthente kokën prapa tek fëmija, nga frika se mos i afrohej ndonjë egërsirë.

Kur zbriste në luginë nxitonte me qëllim që të ngjitej në anën tjetër dhe të mos i ikte nga sytë, fëmija i saj.

atë vepër e ka bërë i madhi i tyre dhe në rastin e Sarës, kur shkoi në tokën e një tirani dhe me vete kishte Sarën, e cila ishte gruaja më e bukur. Ai i tha asaj: “Nëse ky tiran mëson se ti je gruaja ime do t’më mundë kundrejt teje dhe nëse të pyet thuaj se je motra ime, sepse ti je motra ime në Islam dhe nuk di që mbi tokë të ketë musliman tjetër veç meje dhe teje. Kur shkoi në tokën e këtij tirani, atë e panë disa të afërm të tij, që i thanë; “Në tokën tënde ka hyrë një grua, që nuk i takon askujt ta zotërojë veç teje.” Ai dërgoi njerëz tek ajo dhe ia sollën, ndërsa Ibrahim i u ngrit për t’u falur. Kur ai hyri tek ajo, nuk duroi derisa e shtriu dorën e tij drejt saj, por dora i ngriu dhe tha; “Lute Zotin të ma lëshojë dorën dhe nuk do të bëj keq.” Ajo veptoi ashtu, por ai bëri të njëjtin veprim dhe dora iu paralizua më shumë se herën e parë. Ai i tha; të njëjtat fjalë dhe ajo veptoi në të njëjtën mënyrë, por përsëri iu kthye veprimit të tij dhe dora iu paralizua edhe më shumë se dy herët e para. Ai i tha; “Lute Zotin të ma lëshojë dorën, sepse të betohem në Zotin, se nuk do të bëj keq”. Ajo veptoi ashtu dhe dora iu lëshua. Ai thirri njeriun që e kishte sjellë dhe i tha; “Më ke sjellë shejtan dhe jo njeri, dëboje nga toka ime dhe jepi Haxheren.” Ajo u kthye duke ecur. Kur e pa Ibrahimin, ai shkoi drejt saj dhe i tha; “çfarë lajmesh kemi?” Ajo i tha; “Të mira. Allahu e largoi dorën e mëkatarit dhe na dhuroi një shërbëtorë.”

Por zgjidhja vjen bashkë me pikëllimin dhe pas vështirësisë vjen lehtësimi. Pas shtatë vajtje - ardhjesh midis dy kodrave, ajo dëgjoji një zë engjëlli dhe kërkoi në vendin ku ndodhej zemzemi dhe aty filloi të buronte ujë.

Gëzimi i saj ishte i madh. Pinte ujë për vete dhe i jepte qumësht djalit të saj. Falënderoi Allahun për këtë mirësi të madhe dhe gërmoi në tokë në formë rrethi me qëllim që uji të mos humbiste (e të shterohej).

I dërguari i Allahut (alejhi salatu ues selam) ka thënë: *“Allahu e mëshiroftë nënën e Ismailit. Sikur ta linte Zemzemin, (pa i bërë pritë), ai do të ishte një burim i bollshëm, i rrjedhshëm dhe i dukshëm.*¹⁸

Atë e gjetën ca njerëz të një fisi arab që quhej Xhurhum! Ata qëndruan aty dhe mirësia u shtua edhe më shumë.

Ismaili u rrit. Ai ishte djalosh i pashëm dhe i mirë dhe fisit i pëlqenin vlerat morale dhe ambicia e lartë e tij.

Kur arriti moshën e pjekurisë, u martua me një vajzë të këtij fisi dhe gjatë asaj kohe, nëna e tij (Haxherja) ndërroi jetë.

Në kohën kur Islamili nuk ishte në shtëpi, babai i tij Ibrahimi, erdhi dhe pyeti gruan e tij për burrin e saj dhe për jetesën që bënin. Ajo e njoftoi se burri i saj kishte vajtur për gjueti dhe se jetesa e tyre ishte shumë e vështirë. Ibrahimi i tha: *“Kur të vijë burri yt, jepi selam nga ana ime dhe thuaji: Ndërroje pragun*

¹⁸ E përcjell Buhariu me nr 3364 nga Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij). Ibn Xheuzi Allahu e mëshiroftë ka thënë: Burimi i Zemzemit ishte mirësi e plotë nga Allahu, pa ndërhyrjen e askujt. Kur ai u shoqërua me ndërhyrjen e Haxheres, sepse nuk e la të rridhte lirshëm, kjo u konsiderua ndërhyrje e njeriut dhe ashtu mbeti. (Fet’hul Bari 6/463)

e derës së shtëpisë.” Ibrahim i largua shpejt, për ndonjë urtësi që e deshi Allahu i Lartësuar.

Kur u kthye Islamili, ndjeu se kishte ngjarë diçka dhe pyeti gruan dhe ajo i tregoi se kishte adhur një i moshuar, me këto tipare dhe kishte pyetur për të dhe ajo i kishte treguar. “Ai pyeti për jetesën tonë dhe unë i tregova për vështirësitë! Ai të dërgon selam dhe më tha të të porosit që ta ndërrosh prapë e derës së shtëpisë!” Ismaili i tha: “Ai ishte babai im, ndërsa ti je pragu i derës, prandaj shko tek familja jote.”

Dhe kështu Ismaili u martua me një grua tjetër.

Pas një farë kohe, Ibrahim erdhi përsëri, ndërkohë që Ismaili kishte dalë për gjueti. Ai hyri tek shtëpia ku qëndronte gruaja e Ismailit dhe e pyeti për Ismailin dhe ajo i tregoi! Ibrahim e pyeti për jetesën që bënë dhe ajo i tha se jetonin në mirësi dhe begati. Ajo ishte grua e mirë dhe falënderuese ndaj Zotit dhe burrit të saj.

Ai i tha: “Kur të kthehet burri, jepi selam nga ana ime dhe thuaj ta përforcoje prapë e derës së shtëpisë!”

Pastaj u largua menjëherë, para se të takohet me Ismailin, për ndonjë urtësi që e deshi Zoti i Lartësuar.

Kur u kthye Ismaili nga gjuetia tha: “A ju ka ardhur dikush?” Ajo i tha: “Erdhi një i moshuar me këto tipare!” Ai i tha: “A ju tha diçka?” Ajo tha: “Na pyeti për ty dhe unë i tregova; na pyeti për jetesën tonë dhe unë e lajmërova, se jemi në mirësi dhe falënderova Allahun.” “Çfarë tha pastaj?” - pyeti Ismaili. Gruaja i tha: “Ai të dërgon selam dhe të urdhëron të përforcosh prapë e derës së shtëpisë!” Ismaili i tha: “Ai ishte babai im, ndërsa ti je pragu i derës së shtëpisë dhe më urdhëroi të të mbaj.”

Ibrahimi, erdhi për herë të tretë dhe e gjeti Ismailin duke mprehur ca shtiza pranë pusit të Zemzemit. Kur e pa Ibrahimin, ai u ngrit dhe veproi siç vepron fëmija i dashur për babain e dashur.

Ai i tha: *“O Ismail! Allahu më ka urdhëruar që të ndërtoj këtu në këtë vend një shtëpi, që të jetë faltore për njerëzit, deri në Ditën e Gjykimit.”* Ismaili i tha: *“Unë do të të ndihmoj për këtë!”*

Ata filluan t'i ngrinin themelet e kësaj shtëpie. Ibrahimi ndërtonte, ndërsa Ismaili i afronte gurët dhe të dy luteshin duke thënë: **“O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka! O Zoti ynë! Na bëj të përlur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti! O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t'u lexojë shpalljet e Tua, t'ua mësojë Librin dhe Urtësinë (rregullat e fesë) e t'i pastrojë (nga gjynahet)! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!”** (El Bekare, 127-129)

Kur mbaroi ndërtimi i Shtëpisë së Shenjtë (Qabes) dhe kur Ibrahimit i mbeti kjo gjurmë e vlefshme, Allahu e urdhëroi atë, t'i ftonte njerëzit dhe t'i thërriste me zë të lartë, që të vinin për të kryer haxhin. Ai thërriste, ndërsa njerëzit vinin tek Shtëpia e Shenjtë nga çdo cep i largët. Vinin dhe dëshmonin krahas dobive të kësaj bote (shit-blerje), edhe dobisë e Ahiretit. Kështu, gjenin lumturinë dhe largonin prej vetes mjerimin.

Sprova e Ibrahimit dhe urdhri i flijimit

Ndërkohë, kur dashuria ndaj Islamilit e kishte pushtuar zemrën e Ibrahimit, Allahu deshë ta sprovonte atë! Për të parë

nëse do të ishte prej atyre që i japin përparësi dashurisë ndaj Zotit, dashuri e cila nuk pranon ortakëri e as konkurrencë. Për këtë arsye, e urdhëroi në ëndërr që ta flijonte Ismailin, ndërkohë që ëndrrat e pejgamberëve janë insiprim (shpallje) nga Allahu.¹⁹

Ibrahimi i tha Ismailit: **“O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?”** - I biri i tha: **“O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!”**

“Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit.”

D.m.th, u nënshtruan ndaj urdhrit të Allahut dhe e pranuan, duke e vënë veten në shërbim të këtij urdhëri jo të këndshëm, ku rrallë mund të gjesh njerëz që tregojnë durim, sa (1/10) një e dhjeta e tij.

“Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë.”

Ndihma dhe zgjidhja vjen nga i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! **“Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit, (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë. Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.”** (Safatë, 103-105)

U zgjidh problemi i kësaj sprove; këtij mundimi të lodhshëm dhe të pakëndshëm. Pasi që u parapri nga pohimi i sigurt dhe i vendosur (për të zbatuar urdhrin), që të dy merituan shpërblim dhe mirësinë; arritën të fitonin nderimin dhe

¹⁹ Hafidh Ibn Haxher (Allahun e mëshiroftë) ka thënë: Ebu Nuajmi përcjell në librin “Ed-Delail” me sened të mirë nga Alkameh bin Kajs, shoqëruesi i Ibn Mesudit, se ka thënë: E para gjë që u jepet profetëve janë ëndrrat, me qëllim që zemrat e tyre të udhëzohen, pastaj u vjen shpallja në gjendje normale (kur janë zgjuar). (Fet’hul Bari 1/9.)

afrimin në piedestale të larta tek Allahu i Lartësuar. Të gjitha këto mirësi nuk janë të pamundura për Zotin tonë Bujar!

Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë! Dhe Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh.”** (Safatë, 105-107)

E ku ka flijim më të madh, se ai me të cilin arrihet qëllimi i një adhurimi, që nuk i ngjan asnjë adhurimi tjetër?!

Ky flijim do të mbetet traditë deri në Ditën e Gjykimit, përmes të cilit, njerëzit do të afrohen tek Allahu dhe do të arrijnë shpërblimet dhe kënaqësinë e Tij.

“Dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë tek brezat e mëvonshëm. “Paqja qoftë mbi Ibrahimin!” (Safat, 108-109)

Pas kësaj që ndodhi, Allahu ia plotësoi mirësitë Ibrahimit, e mëshiroi gruan e tij Sarën, edhe pse ishte e shtyrë në moshë dhe e përgëzoi me një djalë të vyer, i cili do të quhej Is’hak dhe ai (Is’haku), më vonë do të kishte djalë Jakubin.

Allahu e kishte dërguar Lutin tek populli i tij, por ata u ngritën kundër tij. Për këtë arsye, Allahu vendosi që t’i ndëshkonte. Luti ishte nxënës i Ibrahimit dhe ndaj tij kishte shumë detyrime. Engjëjt që u dërguan për të shkatërruar popullin e Lutit, kaluan fillimisht tek Ibrahim, por në formë njeriu.

Kur hynë tek Ibrahim, e përshëndetën me selam dhe ai ua ktheu selamin dhe menjëherë filloi t’i gostsite miqtë (e panjohur). Allahu i kishte dhënë furnizim të bollshëm dhe bujari të madhe. Shtëpia e tij (Ibrahimit) ishte pikë referimi për mysafirët.

Në moment, ai vajti tek familja dhe pa u vënë re solli një viç të majmë e të pjekur mbi një tepsi të madhe. **“Pastaj ua afroi atyre e u tha: ‘A nuk po hani?’”** (Dharijat, 27)

“Kur pa se ata nuk po i zgjasnin duart tek mishi, nuk i pëlqeu dhe ndjeu frikë prej atyre.” (Hud, 70)

Sepse mendoi se ishin hajdutë.²⁰

“(Engjëjt) thanë: ‘Mos u frikëso, Ne jemi dërguar te populli i Lutit’.” (Hud, 70)

Sarën, ndërkohë që po u shërbente, ata e përgëzuan me lajmin se do të bëhej me një fëmijë të ditur. Ajo qeshi nga habia dhe filloi të qëllonte fytyrën. Ishte e habitur dhe e shtangur. Ajo tha: **“Ah! E mjera unë! A mos vallë, kështu plakë do të lind unë.”** (Hud, 72)

Para se t’më vinte ky lajm përgëzues, unë isha beronjë (nuk lindja) **“ndërkohë që edhe burri im është plak! Me të vërtetë, kjo është diçka e jashtëzakonshme!”** Ata (engjëjt), thanë: **“A mos vallë, po çuditesh me urdhrin e Allahut? Mëshira e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi ju - familjen e të Dërguarit. Me të vërtetë, Ai është i Falënderuar dhe i Lavdëruar!”** (Hud, 72-73)

Engjëjt i përgëzuan me Is’hakun i cili do të jetonte, dhe të cilit do t’i lindte një fëmijë që do ta quanin Jakub dhe do ta arrinin (do ta shihnin).

²⁰ Sepse kur i pa se duart e tyre nuk po i afrohen ushqimit, në vetvete mendoi se këta njerëz mund të mbanin diçka të keqe. Kjo sepse miku kur han nga ushqimi i të zotit të shtëpisë, kjo e qetëson dhe e bën të ndihet mirë. Ibn Kajjim në librin e tij “Risale et Tebukije” fq 130.

Ibrahimi, e falënderoi Allahun për mirësitë e plota, duke thënë: **“Qoftë lavdëruar Allahu, i Cili në pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is’hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet!”** (Ibrahim, 39)

Dobi dhe mësimet të përfituara nga historia e Ibrahimit (alejhi selam)

I- Çdo detaj që Allahu i Lartësuar na e ka treguar në historinë e Ibrahimit (alejhi selam), jemi të urdhëruar ta praktikojmë në mënyrë të veçantë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Fenë e babait tuaj, Ibrahimit.”** (Haxh, 78)

D.m.th, përkushtojuni asaj!

“Pastaj ty të shpallëm: ‘Paso me singeritet fenë e Ibrahimit, që nuk ka qenë prej idhujtarëve’.” (Nahl, 123)

“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahimi dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet.” (Mumtehinë, 4)

Ajo që ka të bëjë me teuhidin (njësimin e Zotit në adhurim), bazat e fesë, besimin, vlerat morale dhe çdo gjë për të cilën Allahu na ka treguar për të (Ibrahimin), ndjekja e tij, konsiderohet prej fesë sonë.

Për këtë arsye, meqenëse urdhri për të ndjekur Ibrahimin ishte i përgjithshëm dhe përfshinte të gjitha gjendjet e tij, Allahu veçoi vetëm një rast, duke thënë: **“Përrjashtim (nga ky shembull) bën fjala e Ibrahimit për të atin: ‘Unë do të kërkoj falje për ty.’”** (Mumtehinë, 4)

Domethënë: mos e ndiqni në këtë rast, e të kërkonit falje për idhujtarët, sepse kërkimi i faljes që bëri Ibrahimi, ishte vetëm një premtim që ai ia kishte dhënë babait, por kur iu bë e qartë se ai ishte armik i Zotit, u distancua prej tij.

2- Allahu i Lartësuar e zgjodhi Ibrahimin si halil (të dashurin e Tij) ndërkohë që fjala e përmendur (halilu Allah), nënkupton nivelin më të lartë të dashurisë. Këtë shkallë, nuk e ka arritur askush nga njerëzit, përpos dy të dashurve të Zotit: Ibrahimit dhe Muhamedit (alejhima selam).

3- Ndër mësimet që përfitojmë nga kjo histori është edhe nderimi që Allahu i bëri këtij peygamberi, duke i dhënë mrekulli të ndryshme. Allahu u dha pasardhësve të Ibrahimit profetësinë dhe librat qiellorë. Nxorri prej tyre dy popuj, që do të ishin më të nderuarit: Popullin arab dhe bijtë e Izraelit. Allahu e zgjodhi atë që të ndërtonte Shtëpinë e Shenjtë, e cila është shtëpia më e vlefshme dhe e para faltore e ndërtuar për njerëzit. I dhuroi fëmijë, atëherë kur ishte i thyer në moshë dhe i ishte shuar çdo shpresë. Me emrin e mirë të këtij profeti, mbushi Lindjen dhe Perëndimin. Zemrat e njerëzve i mbushi me dashuri dhe gjuhët e tyre me përmendje të mirë ndaj Ibrahimit (alejhi selam).

4- Allahu e ngriti lart Ibrahimin në dije, në vendosmëri dhe forcën e argumenteve. Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe kështu, Ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të Tokës, që ai të bëhej nga ata që besojnë vendosmërisht.”** (En’amë, 75)

“Ky është argumenti Ynë, të cilin Ne ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë kë të duam në shkallë të lartë. Vërtet, Zoti yt është i Urtë e i Gjithëdijshëm.” (En’amë, 83)

Që të arrinte kulmin e dijes dhe fundin e saj, Ibrahimiu lut Allahut duke thënë: **“Kur Ibrahimiu tha: ‘O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!’ - Zoti i tha: ‘A nuk beson?’ - ‘Besoj’- iu përgjigj Ibrahimiu, ‘por dëshiroj të më qetësohet zemra.’ Allahu i tha: ‘Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërnda në çdo**

kodër nga një copë prej tyre pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (Bekare, 260)

5- Ai që përkushtohet në kryerjen e adhurimeve dhe jep maksimumin në plotësimin e shkaqeve, por i del një pengesë që nuk e lë ta plotësojë, shpërblimi i tij shkruhet tek Allahu. Siç na ka treguar Allahu i Lartësuar, për atë që emigron dhe vdes pa arritur tek vendi i emigrimit.²¹

Ashtu sikurse e përmendi Allahu në ndodhinë e fljimit, se Allahu ia kishte dhënë të plotë shpërblimin Ibrahimit dhe Ismailit, atëherë kur u dorëzuan dhe e pranuan urdhrin. E megjithatë, pas kësaj, Allahu e largoi vështirësinë dhe u dha shpërblimin e kësaj bote dhe të botës tjetër.

6- Mësojmë etikën e dialogimit, mënyrat dhe format e tij të dobishme. Mënyrën si të detyrosh kundërshtarin me forma të qarta, të cilat i pranojnë njerëzit e logjikshëm. Mësojmë se si e detyronte kundërshtarin më të rreptë, që të pranonte realitetin që fliste për kotësinë e rrugës së tij, duke paraqitur argumente ndaj atyre që tregonin kokfortësi, si dhe për t'i orientuar ata që kërkonin udhëzim.

7- Prej mirësive që Allahu u jep njerëzve është dhe mirësia e fëmijëve të mirë dhe të devotshëm. Për këtë dhuratë, njeriu duhet ta falënderojë shumë Allahun dhe t'i lutet Atij për pasardhës të mirë, siç veproi i dashuri i Allahut, Ibrahim (alejhi selam) kur tha: **“Qoftë lavdëruar Allahu, i Cili në**

²¹ **“Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Nisa 100.)

pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is'hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet! O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet! O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari!” (Ibrahim 39-41)

Allahu i Lartësuar, duke i lavdëruar në përgjithësi ata që luten për pasardhës të mirë thotë: **“Dhe kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush 40 vjet, ai thotë: ‘O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!’”.** (Ahkaf, 15)

Njeriu kur vdes, i ndërpriten punët, përpos tri rasteve: Sadakaja rrjedhëse, dija prej të cilës kanë dobi të tjerët dhe fëmija i mirë që lutet për të.²²

8- Vendet e vizitës gjatë periudhës së haxhit dhe ritualët që praktikohen mund t'i përmledhim në këto urtësi: Aty përkujtohen vendet ku Ibrahim i dhe familja e tij kryenin adhurimet, besimin në Allahun dhe peygamberët e Tij. Këto rite na nxisin për t'i ndjekur ata dhe të gjithë profetët në të gjitha gjendjet e tyre që kanë të bëjnë me fenë. Këtë e themi, bazuar në fjalën e Allahut që thotë: **“Bëjeni vendin e Ibrahimit si vend-faljeje!”** (Bekare, 125)

²² Në hadithin e Ebu Hurejras (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) përcillet se Profeti (alejhi selam) ka thënë: Kur vdes njeriu, të gjitha punët e tij ndërpriten përpos tri gjërave: Kur ai lë një sadaka rrjedhëse, dije prej të cilës kanë dobi të tjerët dhe fëmija i mirë që lutet për të. E përcjell Muslimi me nr 1631. Ibn Rexhebi ka një libër të veçantë në komentin e këtij hadithi.

9- Urdhri për pastrimin e xhamisë së shenjtë nga ndytësitë dhe të gjitha mëkatet, në fjalë dhe vepra. E gjithë kjo në shenjë madhërimi ndaj Allahut, si dhe për të ndihmuar dhe nxitur të gjithë ata që adhurojnë Allahun. Të njëjtat fjalë mund të thuhën për të gjitha xhamitë. Kjo duke u bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar që thotë: **“Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që qëndrojnë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përlur”**. (El Bekare, 125)

“Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij. (Ibrahim, 37)

10- Porosia më e vyeshme, është ajo që Ibrahimi (alejhi selam) u dha bijve të tij dhe Jakubit. Ajo është porosia për vazhdimësinë e praktikimit të fesë dhe unitetit rreth saj. Kjo është porosia që Zoti u ka dhënë të parëve dhe atyre që erdhën më pas. Vetëm përmes zbatimit të kësaj porosie, arrihet lumturia e përhershme dhe shpëtimi nga e keqja e kësaj bote dhe e botës tjetër.

11- Punëtori (ai që bën vepra të mira), ashtu sikurse duhet ta perfeksionojë punën e tij, duke e kryer në formën më të plotë, nga ana tjetër duhet të qëndrojë mes frikës dhe shpresës. Ti përgjërohet Allahut që Ai t’ia pranojë (veprat) t’ia plotësojë mangësitë dhe ta falë për të metat dhe gabimet. Kështu vepruan Ibrahimi dhe Ismaili në momentin kur po ndërtonin themelet e shtëpisë së shenjtë. Ata e gëzonin këtë cilësi në formën më të përsosur (mes frikës dhe shpresës).

12- Lutja që njeriu i drejton Allahut, të bashkojë mes mirësive të dynjasë dhe fesë dhe preokupimi për t’i arritur (këto të dyja), është metodë që ndoqën profetët. Feja është origjina (baza) dhe qëllimi për të cilin Allahu krijoi njerëzit. Ndërsa dynjaja është

mjet dhe ndihmesë për arritjen e këtij qëllimi (përmbushjen e fesë). Këtë e themi duke u bazuar në lutjen që i dashuri i Zotit, Ibrahim, bëri për banorët e Shtëpisë së Shenjtë. Ai u lut për dy gjëra, duke nxjerrë në pah urtësinë e lutjes, se gjërat e kësaj bote janë mjet për falënderimin e Allahut. Ai u lut duke thënë: **O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë.** (Ibrahim, 37)

13- Historia e Ibrahimit na mëson si duhet të jetë mikpritja e mysafirit dhe normat e respektit.²³ Allahu i Lartësuar na tregoi për vizitorët e tij se ishin të nderuar, pra ishin të nderuar tek Allahu, por gjithashtu edhe Ibrahim i nderoi me pritjen e tij në fjalë dhe vepra.

Nderimi i mysafirit është prej imanit. Mjafton të dimë se Ibrahim u shërbeu personalisht dhe e filloi i pari mikpritjen para çdo gjëje tjetër.

I priti me ushqimin më të vyer që kishte, mishin e viçit, të pjekur e të majmë dhe ua afroi në tryezë dhe nuk i la të shkonin diku tjetër. U shtroi ushqimin dhe u kërkoi të hanin, me fjalë të buta duke u thënë: **“A nuk po hani?”** (Dharijat, 27)²⁴

14- Ligjshmëria e përsëritjes me selam dhe se ai që e fillon është pikërisht ai që futet brenda (në shtëpi) dhe ai që është duke ecur. Ndërsa kthimi i tij (selamit) është detyrë.

²³ Për më tepër, rreth ajetit dhe gjërave që ai përmbledh për normat e mikpritjes shih librin “Er Risaleh et Tebukije” fq 122-131.

²⁴ Fjala e Ibrahimit: **“A nuk po hani?”** Është mënyrë kërkimi me sjellje ndryshe nga ai që thotë: Zgjatini duart dhe merrni ushqim, hani, afrohuni etj. Shih “Er Risaleh et Tebukije” fq 130.

Si dhe ligjshmërinë e të qëndruarit tek emri i atij që kontakton me ty, qoftë ai shok, apo dikushi apo ndonjë mysafir. Këtë e themi duke u bazuar në fjalën e Ibrahimit që u tha mysafirëve: **“Njerëz të panjohur!”**. (Hixhr, 62)

D.m.th, nuk u njoh më përpara, prandaj kam dëshirë që të prezantoheni personalisht. Kjo fjalë që u tha Ibrahim, ishte shumë më e sjellshme se tu thoshte: Unë nuk ju njoh ju! Apo diçka tjetër.

15- Është mirë dhe inkurajuese që familja apo ata që janë të ngarkuar për mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë, të jenë të vendosur dhe të gatshëm për çdo gjë që kërkohet prej tyre, e që ka të bëjë me çështjet e shtëpisë. Ibrahim (alejhi selam) në momentin kur shkoi tek familja e tij, e gjeti të gatshëm (të gatuar) ushqimin për mysafirët dhe i duhej vetëm ta shërbente atë.²⁵

16- Të kesh fëmijë, të përgëzohesh me ardhjen në jetë të një fëmije, duke qenë në moshë të thyer, konsiderohet mrekulli ndaj Ibrahimit dhe nderim i madh për Sarën. Ngjarja e Ibrahimit tregon mrekullinë ndaj një profeti dhe nderimin e madh ndaj një njeriu të dashur tek Zoti (Sarën).

I ngjashëm me këtë ishte edhe përgëzimi që engjëjt i dhanë Merjemes për Isain dhe përgëzimi që i dhanë Zekerijas dhe gruas së tij për Jahjan. Argumenti që Allahu i dha Zekerijas ishte se për tri ditë radhazi nuk do u fliste njerëzve, dhe pse nuk kishte ndonjë problem shëndetsor. Kjo ishte shenjë dhe sinjal.

²⁵ Fjala e Allahut kur thotë: “Ai shkoi tek familja e tij” tregon se nderimi ndaj mysafirit ishte i gatshëm dhe i gatuar tek familja dhe nuk kishte nevojë të merrte diçka hua tek fqinjët apo të shkonte diku tjetër, sepse nderimi i mysafirit ishte normë që ata e prisnin gjithmonë.

Të gjitha këto, apo fakte të tjera, janë nga Allahu dhe akoma më mahnitës është fakti se Allahu e krijoi Ademin nga dheu.

Larg të metave është Ai, që ka fuqi mbi çdo send.

17- Lavdërimi që Allahu i bëri Ibrahimit (alejhi selam) është se ai u paraqit para Zotit me zemër të pastër. Allahu i Lartësuar thotë: **“Përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”** (Shuara, 89)

Ajo që e përmbledh kuptimin e këtij ajeti: Bëhet fjalë për zemrën e pastër nga të këqiat dhe arsyet që shpien tek e keqja. Është e mbushur me të mira, bamirësi dhe bujari. E ruajtur nga dyshimet që cënojnë dijen, bindjen e plotë, dhe nga epshet që pengojnë robin dhe plotësimin e tij. Është ajo zemër e pastër nga mllefi dhe zilia, e mbushur me teuhid, besim, modesti ndaj të vërtetës dhe njerëzve, këshillimin dhe dëshirën e madhe për tu adhuruar vetëm Allahu dhe për tu sjellë dobi robërve të Tij.

-18 Fjalët që përmend Allahu në rastin e Nuhut dhe Ibrahimit, Musait, Harunit dhe Iljasit ku thotë: **“Paqja qoftë me Nuhun ndërmjet gjithë krijesave!”** (Safat, 79) **“Paqja qoftë mbi Ibrahimin!”** (Safat, 109)

Ai i bashkangjit me fjalët: **“Ne, kështu i shpërblejmë punëdrejtët.”** (Safat, 80)

Allahu i Lartësuar premtoi se do ta shpërblejë çdo punëmirë me përmendje dhe emër të mirë tek njerëzit dhe lutje nga ana e tyre, në varësi të vlerave që ai mban. Ky është shpërblim i shpejtë ndërsa shpërblimi i botës tjetër vjen si përgëzim në jetën e kësaj bote dhe shenjë e lumturisë së vërtetë.



HISTORIA E LUTIT

(alejhi selam)

Historia e Lutit (alejhi selam) është vazhdim i historisë së Ibrahimit. Luti ishte nxënësi i Ibrahimit (alejhi selam) sepse mësoi prej tij, ndërsa ai (Ibrahimi) kujdesej dhe e konsideronte Lutin si djalë të tij.

Allahu i Lartësuar e dërgoi Lutin si Profet në kohën kur Ibrahimi ishte akoma gjallë. Atë e dërgoi tek vendbanimet e Sodomit në Gurr (burimet e thata) të Palestinës.

Përveç idhujtarisë në të cilën kishin rënë, ky popull kryente mardhënie homoseksuale (burrë me burrë), neveri dhe mëkat të cilin askush më parë nuk e kishte praktikuar (tek popujt e mëparshëm).

Luti (alejhi selam) i ftoi që të adhuronin Allahun, të vetëm dhe të pashok, gjithashtu i ndaloi nga ky mëkat. Por kjo, veçse ua shtoi kryeneçësinë duke u thelluar më shumë në mëkatet e tyre.

Allahu i Lartësuar, kur vendosi ta shkatërronte këtë popull, dërgoi engjëjt e Tij. Gjatë rrugës, ata kaluan tek Ibrahimi (alejhi

selam) dhe e njoftuan për çfarë do të ndodhte me atë popull. Ibrahim filloi të debatonte për shkatërrimin e tyre, sepse ishte i dhembshur dhe i butë: **“Ai (Ibrahimi) tha: ‘Por atje banon edhe Luti!’ Ata thanë: ‘Ne e dimë më mirë kush është atje. Ne do ta shpëtojmë atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij.’”** (Ankebut, 32)

Ata i thanë: **“O Ibrahim, shmangu prej kësaj! Me të vërtetë, erdhi urdhri nga Zoti yt dhe ata do t’i gjejë dënimi i pashmangshëm.”** (Hud, 76)

Engjëjt shkuan tek Luti në formë njerëzish dhe djelmoshash, gjë që e rëndoi Lutin, i cili e ndjeu veten shumë keq duke thënë: **“Kjo është ditë e rëndë!”** (Hud, 77)

Sepse e dinte në çfarë gjendje ishte populli i tij dhe guximin e ndyrë që kishin për të mëkatuar.

Në fakt ndodhi ajo së cilës i frikësohej (Luti). Populli i tij erdhi tek Luti me një frymë dhe kërkuan të kryenin mardhënie intime me miqtë e Lutit (alejhi selam). Ai u tha: **“O populli im, këto janë bijat e mia. Ato për ju janë më të pastra.”** (Hud, 78)

Ua tha këtë fjalë nisur nga ajo që dinte prej tyre se diçka e tillë nuk mund të ndodhte. Siç ishte rasti me Sulejaminin (alejhi selam), kur u propozoi atyre dy grave që ziheshin për fëmijën (se cilës i takon?) duke u thënë: **“Më sillni një thikë që ta ndaj (fëmijën) mes jush. Ishte e ditur se kjo gjë nuk do të ndodhte. Edhe fjalët e Lutit (alejhi selam) këtë domethënie kishin.**

Prandaj populli i tha: **“Ti e di se ne nuk kemi të drejtë për bijat e tua. Në të vërtetë, ti e di se ç’duam ne”.** (Hud, 79)

Gjithashtu ai donte të kishte një farë justifikimi para miqve të tij.

Bazuar në këtë interpretim që sapo përmendëm, nuk është e nevojshme që të mbështetemi tek fjalët e disa kometatorëve të Kur'anit, kur thonë: “Fjala e Lutit: **‘Këto janë bijat e mia.’**” D.m.th. kishte për qëllim gratë e tyre, sepse Profeti është në rolin e prindit për popullin e tij.

Por këtë që thanë këta interpretues, e kundërshtojnë dy gjëra:

E para: Fjala e tij (Lutit): **“Këto janë bijat e mia.”** Ai bën me shenjë tek diçka që është prezente (pra tek vajzat e tij).

E dyta: Ky përgjithësim, se ai (Luti) kishte për qëllim gratë e tyre (popullit) nuk ka kuptim. Gjithashtu, Profeti gëzon rolin e babait për besimtarët dhe jo për mohuesit.

Supozimi i interpretuesve të këtij ajeti, bie poshtë përmes asaj që përmendëm fillimisht, fakti se ai (Luti) e dinte se diçka e tillë nuk mund të ndodhte tek vajzat e tij dhe se ai po mendohej t'i largonte me çdo lloj forme.

Situata u bë tepër e vështirë për Lutin. Ai tha: **“Sikur unë të kisha fuqi (që t’ju dëboj) ose të mbështetesh në ndonjë krah të fuqishëm!”** (Hud, 80)

D.m.th, do të përballesha!

Luti, kur i pa se ishin tepër të vendsour në kërkesën e tyre të ndyrë, u tha: **“Frikësojuni Allahut dhe mos më turpëroni para mysafirëve të mi. A nuk ka midis jush një njeri me mend?”** (Hud, 78)

Ata i kaluan kufijtë në arrogancën dhe dehjen e tyre. Në atë moment, engjëjt e lajmëruan Lutin për çështjen e tyre dhe se ata ishin të dërguar (nga Zoti) për t'i shkatërruar këta njerëz.

Xhibrili, ose ndonjë engjëll tjetër goditi ata që qëndronin tek dera dhe kërkonin të hynin me forcë dhe me këtë goditje i verboi shikimet e tyre. Ky ishte ndëshkimi i shpejtë dhe mësim për të gjithë ata që kërkonin të hynin tek shpëtia e lutit dhe t'u afroreshin miqve të tij.

Ata (engjëjt) e urdhëruan Lutin që të largohej gjatë natës me familjen e tij dhe të shpejtonte, me qëllim që t'i linte pas vendbanimet e tyre dhe të shpëtonte nga dënimi i dhembshëm.

Ai u largua me familjen e tij pa gdhirë mëngjesi, Allahu ua ktheu përmbys vendbanimet, ato që ishin lart, i ktheu poshtë dhe i gurëzoi me rrebesh gurësh. **“Mbi ata lëshuam gurë nga balta e pjekur, duke rënë vazhdimisht, si shiu.”** (Hud, 82-83)

“(Ato ishin gurë) të shënuar (për dënim) te Zoti yt.”

“Dënimi nuk është larg nga keqbërësit.”

Për ata që veprojnë si shembulli i tyre!

Dobi dhe mësim të përfituara nga Historia e Lutit (alejhi selam)

1- Kjo ngjarje, është argumenti më i madh se homoseksualiteti është nga mëkatet më të pështira dhe më të ndyra dhe se ndëshkimi për të është shumë i madh. Ai që sprovohet me këtë lloj mëkati, jo vetëm që feja e tij ikën, por këtij njeriu gjërat e mira kanë për t'iu dukur të këqia dhe ka për ta menduar të mirë atë që relaisht është e ndyrë. E thënë ndryshe, ai distancohet nga çdo gjë e mirë dhe ky është argumenti i shthurjes morale.

2- Si tek historia e Lutit, po ashtu edhe tek historia e Ibrahimit (alejhima selam) përfitohet lejimi i përdorimit të fjalëve të tërthorta. Në historinë e Ibrahimit, përfitohet nga fjala e tij kur thotë: **“Pastaj u hodhi një shikim yjeve e tha: ‘Unë jam i sëmure’”**. (Safat 88-89) Ndërsa në hisotrinë e Lutit, përfitohet nga fjala e tij: **“O populli im, këto janë bijat e mia. Ato për ju janë më të pastra.”** (Hud 78). Përdorimi i fjalëve të tërthorta ndodh si në shprehje ashtu dhe në veprime (praktikë) dhe nënkupton: Kur ai që flet apo ai që vepron diçka që s’ka problem (ndalim), duke e bërë tjetrit të kuptojë apo të dëgjojë diçka ndryshe, me qëllim që të arrijë një dobi apo të largojë një dëm prej vetes së tij.

3- Prej shenjave të zgjuarsisë është kur personi është i udhëzuar në fjalët dhe veprat e tij. Kjo duket qartë në rastin kur ai u del në krah njerëzve të shtypur dhe u largon brengat njerëzve në nevojë, urdhëron për mirë dhe ndalon nga e keqja. Kjo është zgjuarsia e vërtetë dhe për këtë arsye Luti (alejhi selam) tha: **“A nuk ka midis jush një njeri me mend?”** (Hud 78) Që të urdhërojë për mirë dhe të ndalojë nga e keqja dhe t’u bëjë ballë ndjekësve të së keqes dhe agresorëve.

4- Prej dobive që përfitojmë nga historia e Lutit (alejhi selam) është: Nxitja për të gjetur njerëz që ndihmojnë në çështje të hajrit, në largimin e së keqes edhe pse ndihmësi mund të jetë mëkatar. Allahu mund ta ndihmojë fenë e tij edhe nëpërmjet njerëzve që nuk besojnë, me njerëz që nuk kanë asnjë vepër të mirë tek Allahu dhe mu për këtë arsye Luti (alejhi selam) tha: **“Sikur unë të kisha fuqi (që t’ju dëboj) ose të mbështetesh në ndonjë krah të fuqishëm!”** (Hud, 80) Shumicën e pejgamberëve, Zoti i ka dërguar në mesin e njerëzve më fisnikë, që përmes kësaj të arrinin ndihmën ndaj të vërtetës dhe mposhtjen e së kotës dhe të gjenin ambientin e përshtatshëm

për thirrjen, gjë e cila nuk mund të ndodhte ndryshe. Këtë e shohim qartë edhe tek Shuajbi dhe fjalët që populli i tij i tha: **“Sikur të mos ishte farefisi yt, do të të kishim mbytur me gurë; ti nuk je i respektuar te ne.”** (Hud, 91) E njëjta gjë ndodhi me Profetin (alejhi selam) i cili u dërgua në shtëpinë më fisnike dhe më krenare të Kurejshve. Populli i tij e sulmoi dhe u tregua armiqësor me të. Ata mblodhën tubime të ndryshme që të hidhnin poshtë fjalën dhe fenë e tij, madje thurnin plane dhe se si ta shkatërronin atë, Muhamedin (alejhi selam). Ajo që më së shumti i ndaloi ata dhe i bëri të qëndronin në kufijtë e tyre, ishte frika që kishin nga fisi i Profetit (alejhi selam). A e keni parë gjendjen e tij atëherë kur ata ia vështirësuan punën, duke nxitur njerëzit dhe duke bërë për vete fisin e tij muslimanë dhe jomuslimanë. Ata nuk e menduan se mund të arrinin të cënonin personalitetin e tij të nderuar, duke përgatitur kurthin e madh, sepse vendosën të caktonin disa njerëz për vrasjen e tij nga çdo fis, me qëllim që gjaku i tij të shpërndahej në fise dhe ata ta kishin të pamundur marrjen e gjakut. E megjithatë: **“Ata bënë kurthe, por edhe Allahu ngrinte kurthe (kundër tyre). Allahu është planifikuesi më i mirë.”**



HISTORIA E SHUAJBIT

(alejhi selam)

Allahu i Lartësuar, e dërgoi Shuajbin si Pejgamber tek banorët e Medjenit.

Përveç idhujtarisë që praktikonin, ata mashtronin në peshë dhe në matje. U merrnin njerëzve të drejtat që u takonin dhe i mashtronin.

Shuajbi (alejhi selam) i ftoi në adhurimin e Allahut, të vetëm, e të pa shok. I ndaloi nga idhujtaria, i urdhëroi për drejtësi në shit-blerje dhe u tërhoqi vërejtjen nga mashtrimi në tregti duke u kujtuar të mirat që Allahu u kishte dhënë dhe rrizkun e llojllojtë dhe se nuk kishin nevojë tu bënë njerëzve padrejtësi në pasuritë e tyre. Ai i frikësoi duke u përkujtuar dënimin e kësaj bote, para dënimit të botës tjetër.

Ata iu përgjigjën me cinizëm dhe ia kthyen gjithë tallje duke thënë: **“Ata thanë: ‘O Shuajb, a mos vallë namazi yt urdhëron që ne t’i lëmë ato që i kanë adhuruar të parët tanë ose që të mos bëjmë me pasurinë tonë çfarë të duam? Qenke njëmend i butë dhe i drejtë ti!’”** (Hud, 87)

D.m.th, ne do t'i qëndrojmë adhurimit që mbajtën baballarët tanë, jemi të vendosur të bëjmë me pasurinë tonë çfarë të duam ne dhe të ndjekim çdo formë (fitimi) dhe nuk do të mbetemi nën urdhërat e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij.

Shuajbi u tha: **“O populli im, mendoni pak! Nëse unë kam provë të qartë nga Zoti im, i Cili më ka furnizuar me begati të mira nga ana e Vet, (Hud, 88)**

D.m.th Allahu më ka dhënë nga mirësitë e Tij: **“Unë nuk dëshiroj të bëj atë, që jua ndaloj juve.”** (Hud, 88)

D.m.th, u ndalova nga shitblerjet e këqia dhe padrejtësia, ndërkohe që unë jam i pari që i kam braktisur ato, edhe pse Allahu më ka dhënë nga mirësitë e Tij, e megjithatë edhe unë kam nevojë për shkëmbime (shitblereje), por e kam kufizuar veten në bindjen ndaj Zotit tim. Kjo që po bëj dhe mesazhi im synojnë përmirësimin e gjendjes suaj fetare dhe jetësore, aq sa kam mundësi. **“Ndërsa suktesi im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem.** (Hud, 88)

Më pas ai (Shuajbi) u kujtoi se çfarë u kishte ndodhur popujve të mëhershëm, të cilët kishin jetuar aty përreth, duke u thënë: **“O populli im, kundërshtimi ndaj meje le të mos ju çojë kurrësesi që t'ju ndodhë ajo, që i ndodhi popullit të Nuhut ose popullit të Hudit apo popullit të Salihut; mos harroni se edhe populli i Lutit nuk është larg prej jush.** (Hud, 89)

Pas kësaj u kërkoi që të pendohen dhe i inkurajoi duke u thënë: **“Kërkoni falje nga Zoti juaj e kthehuni me pendim tek Ai. Me të vërtetë, Zoti im është Mëshirëplotë dhe gjithë dashuri.”** (Hud, 90)

Por kjo nuk u bëri dobi.

Ata thanë: **“O Shuajb, ne nuk kuptojmë shumë nga ato, që na thua ti.”** (Hud, 91) Këtë e thanë për shkak të inatit dhe urrjetjes të tejsakjshme që kishin ndaj të vërtetës. **“Dhe të konsiderojmë të dobët midis nesh. Sikur të mos ishte farefisi yt, do të të kishim mbytur me gurë; ti nuk je i respektuar te ne.”** (Hud, 92)

“Ai tha: ‘O populli im, a mos vallë farefisi im për ju është më i respektuar se Allahu, të cilin po e anashkaloni? Me të vërtetë, Zoti im, ka nën kontroll gjithçka që bëni ju.’” (Hud, 92)

Shuajbi, kur pa refuzimin e tyre tha: **“O populli im, bëni sa të mundni, por edhe unë do të bëj. Ju, shpejt do ta mësoni se kë do ta gjejë dënimi që do ta poshtërojë dhe kush është gënjeshtar. Pritni (fundin), se edhe unë do të pres me ju”. Kur erdhi urdhri Ynë, Ne e shpëtuam me mëshirën Tonë Shuajbin dhe ata që i besuan atij, kurse mohuesit i kaploi një zë i tmerrshëm dhe në shtëpitë e tyre u gdhinë të vdekur e të palëvizshëm.”** (Hud, 93-94)

Allahu u dërgoi një erë të nxehtë që u mori frymën derisa desh u mbytën nga forca e saj. Gjatë kësaj kohe, u dërgoi një re të ftohtë e cila i mbuloi dhe ata filluan të thirrnin njëri-tjetrin që të strehoeshin poshtë saj e të freskoheshin.

Kur u mblodhën që të gjithë poshtë kësaj reje, ajo u kthye në flakë dhe i dogji duke i kthyer në trupa të djegur, të dënuar, të nënçmuar, të mallkuar në të gjitha kohët.

Dobi dhe mësimet të përfituara nga Historia e Shuajbit (alejhi selam)

1- Mashtrimi në matje dhe peshore në veçanti dhe mashtrimi i njerëzve në çështjet e tyre në përgjithësi, konsiderohet prej krimeve më të rënda që nxisin ndëshkimin e kësaj bote dhe botës tjetër.

2- Mëkatit që e bën dikush pa e pasur të nevojshme konsiderohet më i madh. Për këtë arsye, imoraliteti i të moshuarit është shumë më i shëmtuar se imoraliteti që bën i riu. Mendjemadhësia e nevojtarit, është më e shëmtuar se ajo e të pasurit dhe vjedhja e atij që s'ka nevojë, është më e rëndë se vjedhja që ndodh kur dikush ka nevojë.²⁶

Për këtë arsye Shuajbi i tha popullit të vet: **“Unë po shoh se ju gjendeni në begati.”** (Hud, 84)

D.m.th, jetoni në mirësi të shumta, prandaj çfarë u bën kaq të frikësuar që të keni nevojë nga ajo që gjendet në duart e njerëzve, dhe të përdorni mënyra të ndalauara (për t'i arritur ato edhe pse nuk keni nevojë).

3- Fjala e Shuajbit kur thotë: **“Ajo që ju është lënë nga Allahu, është më e mirë për ju.”** (Hud, 86) Është nxitje për ta që të gëzohen me atë që u ka dhënë Allahu dhe të mjaftohen me hallallin, si dhe të shohin atë që kanë dhe jo të mbajnë mendjen tek pasuria e të tjerëve.

²⁶ Për këtë arsye, në një hadith që e përcjell Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), Proeti (alejhi selam) ka thënë: “Tre personave, Allahu nuk do t'u flasë në Ditën e Gjykimit, e as nuk ka për t'i pastruar nga mëkatet: Plaku zinaqar, mbreti gënjeshtar dhe fukarai mendjemadh.” Në një version tjetër thuhet: “Nuk ka për t'u hedhur shikimin dhe do të kenë ndëshkim të rëndë.” E përcjell Muslimi me nr. 107, 172.

4- Mësojmë se namazi është nxitësi kryesor për kryerjen e veprave të mira dhe braktisjen e veprave të këqia, si dhe për këshillimin ndaj njerëzve. Këtë e dinin shumë mirë mohuesit dhe mu për këtë i thanë Shuajbit: **“O Shuajb, a mos vallë namazi yt urdhëron që ne t’i lëmë ato që i kanë adhuruar të parët tanë ose që të mos bëjmë me pasurinë tonë çfarë të duam? Qenke njëmend i butë dhe i drejtë ti!”** (Hud, 87)

Në një ajet tjetër, Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.”** (Ankebut, 45)

Prej këtui, shohim urtësinë e Allahut dhe mëshirën e Tij, sepse Ai na obligoi me këto namaze që përsëriten gjatë ditës dhe natës, për shkak të ndikimit dhe dobisë që sjellin. Për këtë (dhe shumë mirësi të tjera), Allahut i takojnë falënderimet më të plota.

5- Njeriu, në çdo lëvizje të trupit, në sjelljet dhe tregtinë e tij, duhet t’u nënshtrohet dispozitave të Sheriatit. Ato gjëra që i janë lejuar, i praktikon dhe atë që Sheriati ia ka ndaluar, e lë. Ai që mendon se është i lirë të bëjë çfarë të dojë me pasurinë e tij, qoftë ajo tregti e lejuar apo e ndaluar, ai është njëlloj si ai që mendon se edhe me trupin e tij mund të bëjë ç’të dojë. Për të, s’ka dallim mes kufrit (mohimit) dhe imanit (besimit), sinqeritetit dhe gënjeshtërisë, punëve të mira dhe atyre të këqia. Për këta lloj njerëzish të gjitha janë të lejuara.

Siç dihet këto janë parimet e një grupimi që çdo gjë e kanë të lejuar. Ata konsiderohen si njerëzit më të këqinj dhe mënyra e jetesës së popullit të Shuajbit ngjason shumë me këta, sepse e refuzuan Shuajbin kur i ndaloi nga shitblerjet e padrejta dhe u lejoi shitblerjet e lejuara. Ata iu kundërpërgjigjën se ishin të lirë dhe mund të bënin çfarë të donin me pasurinë e tyre.

E ngjashme me këtë, është fjala e atyre që thonë: **“Vërtet shitblerja është si kamata.”** (El Bekare, 275) Ai që barazon mes asaj që e lejon Allahu dhe asaj që e ndalon, ka devijuar nga natyrshmëria, logjika e shëndoshë dhe para së gjithash nga feja e drejtë.

6-Këshilluesi, ai që urdhëron njerëzit apo i ndalon, që këshilla e tij të jetë më e pranueshme duhet që: Kur të urdhërojë me diçka, të jetë i pari që e vepron dhe kur të ndalojë nga diçka, të jetë i pari që largohet prej saj. Kjo bazuar në fjalën e Shuaibit që thotë: **“Unë nuk dëshiroj të bëj atë, që jua ndaloj juve.”** (Hud, 88)

7-Të gjithë pejgamberët u dërguan si përmirësues dhe sjellës të mirësisë. Nga ana tjetër Allahu i ndaloi nga e keqja dhe çrregullimi. Çdo mirësi dhe përmirësim qoftë nga ana fetare apo jetësore, konsiderohet fe me të cilën u dërguan këta Pejgamberë, veçanërisht ai që konsiderohet imami dhe vula e të gjithë pejgamberëve, Muhamedi (alejhi selam).

Ai e shprehu dhe e riktheu përsëri këtë parim, duke rrënjosur parimet e dobishme me të cilat ecin në jetën normale, ashtu sikurse rrënjosi ato parime që kanë të bëjnë me çështjet e fesë (besimit në një Zot të vetëm).

Njeriu, ashtu sikurse duhet të përpiqet të bëjë mirë dhe të përmirësojë, njëkohësisht forcën dhe ndihmën për këtë duhet ta kërkojë nga Allahu i Lartësuar. Le të jetë i bindur se nuk mundet ta përmirësojë apo plotësojë veten, vetëm se me ndihmën e Allahut.

Këtë e themi duke u bazuar në fjalët e Shuajbit (alejhi selam) kur thotë: **“Unë dëshiroj vetëm të përmirësoj atë që mundem. Ndërsa suksesi im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem.”** (Hud, 88)

8- Ai që i fton njerëzit tek Allahu, duhet ta zbukurojë veten me durim, butësi dhe moral të mirë. Atyre që lëndojnë me fjalë dhe vepra t'u përgjigjet me të kundërtën (mirësjellje dhe butësi). Të mos e pengojë ky lëndim që i vjen nga njerëzit dhe të zbrapset nga thirrja e tij.

Profetët (alejhim selam) ishin të përkryer në këtë moral. Shiko për shembull Shuajbin (alejhi selam) dhe sjelljen e mirë me popullin e tij, ftesën që u bëri me çdo lloj forme, edhe pse ata i drejtoheshin me fjalët më të këqia dhe ia kthenin me veprimet më të ulta. E megjithatë, ai duronte, i falte, u fliste fjalë jo si ato që dilnin nga gojët e tyre. Përkundrazi i përfshinte në mirësinë e tij dhe e kalonte lehtë këtë çështje.

Ai që posedon këtë moral të përkryer, ka fituar shumë dhe tek Allahu ka vendin më të lartë dhe shpërblim të përhershëm.

Ai e dinte shumë mirë se po kuronte popuj që ishin mësuar me sjellje çrrënjosja e të cilave ishte më e vështirë se lëkundja e maleve të ngulitura thellë në tokë. Tek ata ishin gdhendur bestytini dhe ideologji, duke sakrifikuar pasuri dhe shpirtra njerëzish, të cilëve u jepnin përparësi para gjithçkaje. A mendon se këta njerëz, do të binden kaq lehtë, vetëm e vetëm duke u thënë se rruga e tyre është e kotë dhe se fjalët që thonë janë të prishura?! A mendon se ata e tolerojnë atë që i cënon me këtë të keqe?! Jo vallahi, nuk është e lehtë! Këta njerëz kanë nevojë për kura të ndryshme dhe forma (mënyra) me të cilat ftuan pejgamberët:

- Pejgamberët u kujtonin mirësitë e Allahut dhe se Ai është Zotëruesi i vërtetë i këtyre mirësive dhe se vetëm Ai meriton adhurimin. Ua kujtonin mirësitë të detajuara, mirësi të cilat nuk numërohen e as nuk llogariten.

- U sqaronin të kotën, lajthitjet, fesadin, parregullësinë dhe kontradiktat që gjendeshin në rrugën që ndiqnin, gjë e cila e lëkundte besimet e tyre dhe i nxiste për t'i braktisur ato.

- U sillnin në kujtesë gjendjen e tyre, gjendjen e atyre që jetuan më parë dhe ngjarjet e popujve që përgënjeshtruan pejgamberët dhe refuzuan njësimin e Allahut në adhurim.

- U tregonin mirësitë dhe vlerat që gëzon besimi në Allahun, teuhidi, feja e Tij, interesat fetare dhe jetike që e tërheqin zemrën dhe lehtësojnë çdo gjë të nevojshme.

Pas gjithë kësaj, përsëri njerëzit kanë nevojë për mirësi dhe sjellje të mirë. Më e pakta është durimi ndaj lëndimeve dhe sabri ndaj gjërave që vijnë prej tyre. Fjalët e buta dhe ndjekia e çdo mënyre urtësie me ta. Të veprosh disa gjëra që shpirtrat ua pranojnë me qëllim që të përshkallëzohesh në plotësimin e tyre.

Të fillosh me gjërat më të rëndësishme, pastaj me të tjerat që janë më pak të rëndësishme.

Ai që i realizoi në mënyrë të përkryer këto që u thanë e shumë të tjera, ishte zotëria dhe vula e Pejgamberëve imami i krijesave në mënyrë absolute, Muhamedi (alejhi salatu ues selam).



HISTORIA E JUSUFIT DHE JAKUBIT

Historia e Jusufit është nga historitë më të çuditshme. Këtë histori Allahu e përmendi të plotë, madje e veçoi në një sure të gjatë në formë të detajuar dhe shumë të qartë. Leximi i sures është i mjaftueshëm ndaj komenteve të saj. Në këtë sure, Zoti i Lartësuar flet për rastin e Jusufit duke e trajtuar qysh në zanafillë e deri në fund, madje të gjitha lëvizjet dhe ndryshimet e gjendjeve të tij.

Për këtë ngjarje Zoti i Lartësuar thotë: **“Për të gjithë ata që pyesin, në historinë e Jusufit dhe të vëllezërve të tij, ka shumë mësimë.”** (Jusuf, 7)

Atëherë le të përmendim dobitë që përfitohen nga kjo histori madhështore dhe duke iu mbështetur Allahut themi:

Dobitë, mësimet dhe dispozitat që përfitohen nga kjo ngjarje!

1- Kjo ngjarje konsiderohet më e bukura dhe më e qarta, sepse aty pasqyrohen të gjitha zhvillimet, duke kaluar nga një gjëndje në tjetrën. Nga një sprovë në tjetrën, nga një dhuratë në një tjetër, nga poshtërimi në krenari, nga frika në siguri, nga pushteti në skllavëri e anasjelltas dhe pas përçarjes dhe

ndarjes në bashkim dhe vëllazërim. Gjithashtu kemi kalimin prej gëzimit në hidhërim dhe anasjelltas, nga bollëku në varfëri e anasjelltas, nga vështirësia në lehtësim e deri në arritjen e një fundi të lavdëruar. I pa të meta është Ai që na e tregoi këtë ngjarje duke e bërë mësim për të zotët e mendjes.

2- Kjo histori përmban bazat e interpretimit të ëndërrave të duhura dhe se dija e interpretimit është shumë e rëndësishme, dije të cilën Allahu ia dhuron kujt të dojë prej robërve të Tij. Shumica e interpretimeve mbështeten në rastet, shembujt dhe ngjashmëritë e tipareve.

Paranteza e ëndrrës së Jusufit ishte se ai pa deillin, hënën dhe njëmbëdhjetë yje të tjera që i përuleshin atij në shenjë nderimi. Këto yje janë zbukurim për qiellin dhe kanë dobi të ndryshme. Gjithashtu edhe peygamberët, dijetarët dhe njerëzit e zgjedhur, janë bukuria e tokës, sepse përmes tyre njerëzit udhëzohen, njësoj siç udhëzohen përmes shkëlqimit të yjeve.

Përderisa nëna dhe babai janë trangu (baza) dhe vëllezërit e tij janë degët, ishte më e përshtatshme që trangu (baza) të kishte më shumë dritë dhe rreze nga degët. Për këtë arsye dielli simbolizonte njërin prind, ndërsa hëna prindin tjetër.

Në ëndërr yjet ishin vëllezërit e tij dhe ishte e përshtatshme se ai që bie në sexhde të ishte i nderuar për atë që përulej, po ashtu dhe ai të cilit i përuleshin të ishte i nderuar dhe me pozitë të lartë.

Ky ishte tregues se Jusufi do të bëhej njeri me pozitë të lartë dhe të nderuar tek babai, nëna dhe vëllezërit, por e gjithë kjo nuk do të plotësohej pa kaluar në disa etapa që do ta shpinin deri aty: Qofshin ato njohuri, punë dhe përzgjedhje nga Allahu i Lartësuar. Prandaj në ajet thuhet: **Dhe kështu, Zoti yt të ka zgjedhur ty.**” (Jusuf, 6)

3- Përshtatshmëria në ëndrrën e dy djelmoshave

Sepse ëndrrën e atij që pa sikur shtrydhte verë e interpretoi duke u mbështetur në faktin se ai që e bënte këtë punë në shumicën e rasteve ishte shërbëtor tek dikush tjetër dhe shtrydhjen e bënte për dikë tjetër dhe dihet se shërbëtori ndjek zotërinë e tij. Pra ky interpretim i kthehej zanatit për të cilin ai njihet, prandaj e komentoi duke i dhënë këtë qasje.

Ndërsa rastin e atij që kishte parë sikur mbi kokë mbante bukë prej të cilës hanin shpendët, e interpretoi duke i thënë se do të kryqëzohej dhe shpendët do të hanin prej trurit të kokës që mbante mbi trup.

Ndërsa ëndrrën e mbretit me lopët dhe kallinj të, e interpretoi me vitet e thata, pa reshje dhe pa bimësi. Përshtatshmëria e këtij interpretimi lidhet me faktin se me mbretërinë lidhen çështjet e udhëheqjes, kujdesit ndaj njerëzve dhe ruajtjen e interesave të tyre. Sepse me përmirësimin e saj ata përmirësohen dhe me prishjen e saj ata prishen dhe përkeqësohen.

Po ashtu edhe vitet, me begatinë apo thatësinë e tyre organizojnë etapat e jetesës, në të kundërtën krijohen probleme. Ndërsa lopët janë mjet për të lëruar tokën dhe për të nxejrrë prodhimet e saj, në këtë rast ai pa shkakun dhe pasojën. Ëndrra e tij që kishte parë shtatë lopë të majme, pastaj shtatë të tjera të dobëta dhe shtatë kallinj të njohmë e të mbushur dhe shtatë të tjerë të tharë, tregojnë se do të vijnë shtatë vite të begata që do ketë prodhim dhe do të hanë në ato vite çfarë kanë mbjellur, duke lënë vetëm atë që e llogarisin për ta ngrënë më vonë, ose do të rrezikojnë duke i konsumuar të gjitha.

Nëse dikush pyet prej nga e nxori fjalën kur tha: **“Pastaj, pas këtyre do të vijë një vit plot shi për njerëzit, vit në të cilin ata do të shtrydhin (rrush, etj.).”** (Jusuf, 49)

Pse disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se kjo ishte shtesë nga Jusufi (alejhi selam) duke u shprehur me shpalljen që i vinte?

Përgjigje: Kjo nuk qëndron, përkundrazi ai e mori këtë nga ëndrra e mbretit, sepse vitet e thata ishin vetëm shtatë dhe tregonte se pas tyre do të vinte një vit me prodhim të madh dhe begati të shumta që do të largonte thatësirën dhe skamjen e madhe që kishte vite dhe të cilën nuk mund ta largonte një vit i thjeshtë me prodhim, por kërkonte prodhim të jashtëzakonshëm dhe kjo duket qartë dhe kuptohet nga numërimi.

4- Në këtë sure shihen qartë faktet e profetësisë së Muhamedit (alejhi selam), sepse Zoti ia tregoi këtë histori të detajuar dhe të zgjatur e që ishte në përputhje me relaitetin duke realizuar kështu të gjithë synimin. Ndërkohë që ai nuk i kishte lexuar librat e popujve të mëparshëm dhe as nuk e kishte mësuar njeri dhe këtë e dinte shumë mirë populli i tij. Ai vetë ishte analfabet, nuk lexonte e as nuk shkruante, prandaj në ajet thuhet: **“Këto janë disa nga historitë e fshehta, të cilat Ne po t'i shpallim ty (o Muhamed). Ti nuk ke qenë me ata, kur vendosnin për punën e tyre dhe kurdisnin dredhira.”** (Jusuf, 102)

5- Njeriu duhet t'u largohet shkaqeve që çojnë në të keqe dhe ta fshehtë atë prej të cilës ka frikë se mos e dëmton. Kjo bazuar në fjalën e Jakubit kur tha: **“O biri im! Mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu, që të mos kurdisin ndonjë gjë kundër teje, sepse, vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.** (Jusuf, 5)

6- Këshilla ndaj tjetrit qoftë edhe për diçka që ai mund ta urrejë, përderisa ajo jepet me sinqeritet dhe në formë vërejtjeje për të apo dikë tjetër. Bazuar në fjalën e Jakubit kur i tha **“që të mos kurdisin ndonjë gjë kundër teje.”** (Jusuf, 5)

7- Mirësia e Zotit ndaj robit i përfshin edhe të tjerët që kanë lidhje me të, qoftë familja, të afërmit, shokët, etj. Mirësia u arrin dhe i përfshin edhe ata, kjo bazuar në fjalën e Jakubit (alejhi selam): **Dhe e plotëson dhuntinë e Vet ndaj teje dhe familjes së Jakubit.**” (Jusuf, 6)

D.m.th nga ajo që po ndodh me ty. Duke u plotësuar mirësia ndaj Jusufit kjo i dha edhe familjes së Jakubit krenarinë, mundësinë e vendqëndrimit, gëzimin, si dhe duke larguar prej tyre të keqen dhe duke sjellë të mirën, siç e përmend Allahu në fund të kësaj ndodhie.

8- Mirësive të mëdha, fetare qofshin apo jetësore, gjithmonë u paraprijnë shkaqe dhe mjete që i mundësojnë ato, sepse Allahu është i Urtë dhe ligjet e Tij nuk ndryshojnë. Ai ka përcaktuar në ligjin e Tij se kërkesat e larta nuk arrihen veçse me mjetet e dobishme, sidomos njohuritë e dobishme dhe çfarë degëzohet prej tyre në vlera morale dhe vepra. Jakubi e dinte se kjo që po arrinte Jusufi, gjë në të cilën do t'i nënshtrohej babai, nëna dhe vëllezërit, ishte një pozitë e lartë dhe gradë e nderuar dhe se Allahu do t'i mundësonte Jusufit ato mjete që do ta çonin deri aty, prandaj tha: **“Dhe kështu, Zoti yt të ka zgjedhur ty dhe të mëson shpjegimin e ëndrrave dhe e plotëson dhuntinë e Vet ndaj teje.”** (Jusuf, 6)

9- Drejtësia kërkohet si në çështjet e mëdha, po ashtu edhe në çështjet e vogla. Ajo kërkohet si në trajtimin që udhëheqësi i bën popullit të tij, po ashtu edhe në marrëdhënien që prindi duhet të ketë me fëmijët e tij. Drejtësia kërkohet po ashtu edhe në zbatimin e detyrimeve që burri ka ndaj grave të veta, në dashuri, altruizëm etj.

Mbajtja e drejtësisë në këto pika u jep drejtim problemeve të vogla dhe të mëdha dhe rob i arrin të fitojë atë që do. Ndërsa

mangësitë e prishin gjendjen dhe robi e pëson të keqen pa e ndjerë atë.

Për këtë arsye, në momentin kur Jakubi i dha përparësi Jusufit në dashurinë e tij dhe u dha shumë pas tij, ndodhi që fëmijët e tjerë të vepronin në dëm të Jusufit, siç edhe përmendet në historinë e tij.

10- Duhet të kemi kujdes nga gjurmët që shkaktojnë mëkatet. Sa e sa raste kanë ndodhur kur një mëkat i vetëm ka çuar në shumë mëkate të tjera dhe e keqja është zgjatur zinxhir si pasojë e mëkatit të parë. Shikoni rastin e krimit që bënë vëllezërit e Jusufit, sepse kur deshën ta ndanin Jusufin nga babai i tij - që konsiderohet krim shumë i madh - ata përdorën hile të ndryshme dhe gënjyen shumë herë duke e mashtruar babain e tyre me këmishën dhe gjakun që ajo mbante.

Po ashtu aktrimi i tyre se si erdhën në darkë duke qarë. Ska dyshim se ky rast ka të bëjë pikërisht me atë që thamë: Lidhjen zinxhir të ngjarjeve dhe degëzimet e ndryshme që ato marrin. Deri aty sa u tentua që të përfshihej edhe Jusufi, sepse sa herë që tentohej të hulumtohej kjo çështje, hulumtimi ishte i ndërtuar mbi gënjeshtër dhe mashtrime, shtu këtu edhe vazhdimësinë e gjurmëve që kjo fatkeqësi kishte lënë tek Jakubi madje edhe tek Jusufi. Prandaj le të ketë kujdes njeriu nga mëkatet, e sidomos nga ato mëkate që kanë efekt zinxhir.

E njëjta gjë thuhet edhe për disa vepra të mira. Mund të jetë një vepër e vetme, por me efektin zinxhir mirësia e kësaj vepre ndiqet me vepra të tjera nga ai që i kryen apo nga dikush tjetër dhe kjo është prej gjurmëve më të mëdha të begatisë që Allahu i jep robët në dijen dhe punën e tij.

11- Tek njeriu ajo që merret parasysht (në konsideratë) është prefeksionimi i fundit dhe jo mangësitë e fillimit. Bijtë e Jakubit

(alejhi selam) i vepruan ato vepra të shëmtuara në fillim të herës, por çështja e tyre u mbyll me pendim të sinqertë dhe pranim plot keqardhje për atë që kishin bërë dhe kështu fituan falje të plotë nga Jusufi (alejhi selam) si dhe nga babai i tyre që u lut për ta për mëshirë dhe falje.

Nëse dikush e fal tjetrin, Allahu ka për ta falur atë, sepse ai është Mëshiruesi dhe Falësi më i Madh.

Për këtë arsye, fjala më e drejtë është se Allahu i bëri ata pejgamberë, sepse ua fali atë që kishin bërë më parë, sikur të mos kishte ndodhur ndonjëherë. Këtë e themi duke bazuar në fjalën e Allahut që thotë: **“Atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit, Eshatëve (12 bijve të tij).”** (Al Imran, 84)

Ata ishin dymbëdhjetë, bijtë e Jakubit dhe pasardhësit e tyre.

Argumenti që e pohon këtë është se në ëndërrën e Jusufit ata u shfaqën si yje të cilat në përbërje kanë dritën dhe efektin udhëzues, e që janë tipare të profetëve. Po edhe po të mos ishin profetë, një gjë është e sigurtë se ata ishin dijetarë dhe adhures të mëdhenj.

12- Mësojmë mirësitë që Zoti i dha Jusufit, mirësi që kanë të bëjnë me dijen, butësinë, moralet e plotat dhe thirrjen për tek Allahu dhe feja e Tij, si dhe faljen ndaj vëllezërve të tij fajtorë, falje të cilën ai e filloi i pari dhe e plotësoi duke ua kujtuar se nuk ka qortim për ta pas kësaj falje, pa harruar dhe respektin e madh që tregoi për babain dhe nënën e tij, mirësinë ndaj vëllezërve dhe ndaj të gjithë njerëzve, siç tregohet qartë në historinë e jetës së tij.

13- Disa të këqia mund të jenë më të lehta se disa të tjera dhe implementimi në dëmin më të vogël, është më me pak zarar se kryerja e diçkaje më të madhe. Vëllezërit e Jusufit

thanë: **“Vriteni Jusufin ose braktiseni në ndonjë vend të largët.”** (Jusuf, 9)

Por njëri nga ata tha: **“Mos e vrisni Jusufin, por hidheni në fund të ndonjë pusi; do ta marrë ndonjë karvan; nëse përnjëmend doni të bëni diçka me të”.** (Jusuf 10)

Fjalët e tij ishin më të mira dhe më të lehta se fjalët e të tjerëve dhe kjo ua lehtësoi vëllezërve, sepse nuk ranë në mëkatin e madh (të vrasjes). E gjithë kjo përfshihet në grumbullin e shkaqeve të cilat Allahu i kishte paracaktuar për Jusufin me qëllim që ta arrinte atë që synonte.

14- Një mall që përdoret dhe kalon në duart e njerëzve dhe përfshihet në atë që quhet pasuri (që blihet dhe shitet) dhe përdoruesi nuk ka informacion nëse ai mall plotëson kushtet legislative fetare, për atë që e shet apo e blen apo përfiton nga përdorimi i tij, nuk ngarkohet me mëkat. Jusufin e shitën vëllezërit e tij me shitje të ndaluar, por e blenë disa që kaluan duke u nisur nga ajo se ai ishte skllavi i vëllezërve të Jusufit që po e shisnin, pastaj e morën dhe e çuan në Egjipt dhe atje e shitën përsëri. Pas kësaj ai qëndroi tek zotëria i vet si skllav dhe Allahu e quajti atë zotëri dhe Jusufi tek ai ishte skllav por i nderuar. Allahu i Lartësuar e mori në konsideratë dhe e quajti blerje, si atë të udhëtareve, po ashtu edhe blerjen e tij në Egjipt, siç e përmendëm pak më lart.

15- Kujdesi që duhet të tregojmë nga veçimi me gratë e huaja, sidomos ndaj atyre që mund të shkaktojnë joshje ose tundim. Gjithashtu duhet treguar kujdes nga ajo dashuri që mund të dëmtojë. Gruas së ministrit i ndodhi ajo që i ndodhi për shkak të veçimit që kishte me Jusufin dhe dashurisë së madhe që kishte për të. Dashuri e cila nuk e la derisa e çoi në atë tentativë të cilën e shoqëroi me gënjeshtëri ndaj Jusufit e si pasojë çoi në burgosjen e tij për një kohë të gjatë.

16- Dëshira e Jusufit dhe braktisja e saj për hir të Allahut si dhe për shkak të imanit që Allahu kishte vendosur në zemrën e tij u bë shkak që Jusufi të ngritej në pozita të larta tek Allahu i Lartësuar. Dëshira është nxitëse e shpirtit që gjithmonë e urdhëron nefsën për të vepruar keq. Është pjesë e natyrës në të cilën është krijuar njeriu, prandaj kur ndizet dëshira për mëkat dhe robi nuk ka me çfarë t'i bëjë ballë, sepse mungon imani apo dhe frika nga Allahu, në këtë rast ka për të ndodhur mëkati. Por nëse ky njeri është besimtar me iman të plotë, atëherë këtë dëshirë të natyrshme kur e vë përballë imanit të saktë dhe të forte, kjo e ndalon nga pasojat edhe nëse xtësi është i fortë. Prandaj Jusufi i përkiste shkallës më të lartë të këtij lloji. Allahu i Lartësuar thotë: **“Sikur të mos kishte parë provën e Zotit të vet. Kështu e larguam nga e keqja dhe vepra e shëmtuar, sepse ai, në të vërtetë, ishte nga robërit Tanë të sinqertë.”** (Jusuf, 24)

Për arsye se Allahu e kishte zgjedhur dhe për shkak të imanit dhe sinqeritetit që ai kishte, Ai e ruajti nga rënia në mëkat dhe kështu u bë nga ata që iu frikësuan madhërisë së Zotit duke e frenuar veten nga dëshirat. Përveç kësaj ai do të përfshihet në shtatë kategoritë e njerëzve që do të strehohen nën hijen e Tij, atë ditë kur nuk do të ketë hije veç hijes së Tij. Mes tyre profeti Muhamed ka përmendur: “Një burrë të cilin e fton një grua me pozitë dhe bukuri dhe ai i thotë: ‘Unë kam frikë Allahun.’”²⁷

Ajo e dëshiroi në momentin kur nuk kishte pengesë dhe vazhdoi duke e ftuar, ndërsa dëshira e Jusufit ishte e çastit, por u largua menjëherë pasi pa argumentet e Zotit të tij.

17- Atij që imani i ka depërtuar në zemër, e që ndriçohet me njohjen e Zotit dhe me dritën e besimit dhe tregohet i

²⁷ E përcjell Buhariu me nr. 660,1423,6806. Muslimi me nr. 1031, 91 nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

sinqertë me Allahun gjatë jetës së tij, këtë njeri për shkak të imanit dhe sinqeritetit, Allahu do ta ruajë nga të gjitha llojet dhe shkaqet e ligësisë, veprave të shëmtuara dhe mëkateve. Shpërblim për imanin dhe sinqeritetin e tij. E themi këtë sepse Allahu e arsyetoi largimin e Jusufit nga kjo vepër e shëmtuar duke thënë: **“Sepse ai, në të vërtetë, ishte nga robërit Tanë të sinqertë.”** (Jusuf, 24)

18- Nëse dikush sprovohet duke rënë në një ambjent sprove (joshje, tundimi) apo në shkaqe që shpien në mëkate, i kërkohet të largohet prej aty menjëherë dhe sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim që të shpëtojë nga kjo e keqe. Të veprojë ashtu siç veproi Jusufi (alejhi selam) duke ikur me të shpejtë për nga dera, dhe edhe pse ajo e kapte për rrobe, ai sërish mundohej të largohej prej saj.

19- Me provat e tërthorta mund të punohet në çështje të komplikuar dhe në padi gjyqësore. Kjo sepse dëshmitari që dëshmoi apo që gjykoi për Jusufin dhe gruan e ministrit mori si argument diçka të tërthortë duke thënë: **“Nëse këmisha e tij është shqyer përpara, atëherë ajo thotë të vërtetën, kurse ai gënjen. Por, nëse këmisha e tij është shqyer prapa, atëherë ajo gënjen, ndërsa ai thotë të vërtetën”.** (Jusuf, 26)

Gjykimi i tij në këtë rast ishte në përputhje me të vërtetën. Prej argumenteve të tërthorta ishte dhe gjetja e kupës në thesin e vëllait, rast i ngjashëm me atëqë sapo përmendëm.

20- Mësojmë bukurinë e jashtme dhe të brendshme që gëzonte Jusufi (alejhi selam). Bukuria e jashtme detyroi gruan e ministrit që ta donte përtej çdo limiti dhe ta joshte vazhdimisht, por në momentin kur gratë e tjera e qortuan, ajo **“i thirri ato në gosti, çdonjërës i dha nga një thikë dhe (i) tha (Jusufit): ‘Dil para tyre!’ Kur e panë, gratë u mahnitën nga bukuria**

e tij, prenë duart dhe thanë: ‘O Zot, o Zot! Ky nuk është njeri, por qenka një engjell fisnik!’” (Jusuf, 31)

Ndërsa bukuria e tij e brendshme shfaqet tek dëlirësia, paçka se ekzistonin nxitësit e shumtë për vepra të shëmtuara. Megjithatë me imanin dhe nurin e tij, me sinqeritetin dhe forcën e tij nuk mund të largohen vlerat dhe s’mund të rrinë bashkë antivlerat.

Gruaja e ministrit ua tregoi grave të tjera bukurinë e jashtme të Jusufit, të cilat e pohuan me gjuhët e tyre bukurinë e tij të rrallë të pashfaqur ndër njerëz. Ajo u tha: **“Jam përpjekur ta josh, por ai është ruajtur nga gjynahu.”** (Jusuf, 32)

Pas një farë kohe ajo gruaja e Azizit (ministrit) tha: **“Tani do të dalë në shesh e vërteta! Unë u përpoqa që ta joshja atë; ai është vërtet njeri i drejtë”.** (Jusuf, 51)

21- Jusufi zgjodhi të shkonte në burg dhe nuk pranoi të bënte mëkat. Kështu që nëse ndodh që robi të vihet në provë për të zgjedhur mes dy mundësive:

1- Ose të shkojë pas mëkatit.

2- Ose të ndëshkohet penalisht në këtë botë. Ai duhet të zgjedhë ndëshkimin e kësaj bote që i jep edhe shpërblimin nisur nga disa aspekte:

a- I mundëson shpërblimin në aspektin se ai përzgjedhi imanin kundrejt sigurisë nga ndëshkimi i kësaj bote.

b- Shpërblim në aspektin se kjo e pastron besimtarin dhe e lartëson atë. E gjithë kjo konsiderohet si pjesë e luftës që bën njeriu në rrugë të Zotit.

c- Shpërblim në aspektin e fatkeqësisë që i bie dhe dhimbjes që i ka rënë.

I pa të meta është Ai që sjell mirësi edhe përmes sprovave dhe tregohet i butë me të zgjedhurit e Tij. Kjo konsiderohet adresa e imanit dhe shenja e lumturisë së vërtetë.

22- Robi duhet t'i drejtohet Zotit dhe të mbrohet me Të në momentin kur gjenden shkaqet e shkuarjes në mëkat dhe të distancohet plotësisht nga mundësitë dhe forcat e veta. Kjo bazuar në fjalën e Jusufit që tha: **“Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).”** (Jusuf, 33)

Njeri i suksesshëm është ai që kërkon ndihmë tek Zoti i tij, për t'ia larguar mëkatet dhe shkaqet që çojnë drejt tyre, ashtu sikurse i kërkon ndihmë në momentin kur kryen adhurimet dhe veprat e mira, sepse Allahu u mjafton atyre që mbështeten tek Ai.

23- Dija dhe logjika e shëndoshë e ftojnë njeriun tek e mira dhe e pengojnë nga e keqja. Ndërsa injoranca e nxit njeriun tek e kundërta e kësaj që thamë. Kjo bazuar në fjalën e Jusufit: **“Unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).”** (Jusuf, 33) Pra nga ata që nuk i njohin çështjet fetare dhe nuk kanë njohuri ndaj realitetit të dobishëm dhe atij të dëmshëm.

24- Ai njeri që e tregon nënshtrimin ndaj Allahut në rast gëzimi dhe bollëku, të njejtën gjë duhet të tregojë edhe në raste vështirësish. Jusufi (alejhi selam) vazhdoi të thërriste në rrugë të Zotit edhe në momentin kur hyri në burg. Ai e vazhdoi thirrjen duke ftuar ata që kishte afër prej të burgosurve, ashtu sikurse i ftoi edhe dy djelmoshat në monoteizëm dhe i ndaloi nga idhujtaria.

Prej zgjuarsisë dhe urtësisë që i kishte dhënë Zoti ishte se kur vuri re se ata ishin të gatshëm për ta dëgjuar sidomos kur

kishin nevojë për interpretimin e endërrave duke i thënë: **“Ne, me të vërtetë, shohim se ti je njeri i mirë.”** (Jusuf, 36)

Ai e shfrytëzoi këtë moment dhe i ftoi për tek Allahu para se ta fillonte interpretimin e ëndrrave që kishin parë, me shpresë që të arrinte tek synimi i tij. Ai u tregoi se kush ishte Ai që e kishte sjellë deri në këtë pozitë të dijës, përsosmërisë, imanit dhe monotezimit. U sqaroi arsyet që e kishin detyruar të braktiste popullin idhujtar. Kjo që bëri Jusufi ishte ftesë përmes gjendjes, pastaj filloi t'i ftonte përmes fjalëve duke u sqaruar se sa i mirë dhe sa i domosdoshëm është monotezimi dhe se sa e keqe dhe e ndaluar është idhujtaria.

25- Duhet filluar me gjërat më të rëndësishme ndaj të tjerave që kanë më pak rëndësi. Nëse dikush pyetet ndërkohë që pyetësi ka nevojë për diçka më emergjente se pyetja e tij, në këtë rast duhet t'i sqarojë më të rëndësishmen, para se t'i përgjigjet pyetjes së tij. Kjo është shenjë që tregon se ky mësues është këshillues i mençur, i cili di të orientojë dhe t'i mësojë të tjerët. Djelmoshat, kur e pyetën Jusufin (alejhi selam) për ëndrrat që kishin parë, shfaqën qartë se nevoja e tyre për iman dhe monoteizëm ishte më e madhe dhe gjëja më madhore që ai duhej t'u jepte atyre.

26- Atij që i ndodh një vështirësi apo sprovë, nuk ka problem të kërkojë ndihmë tek dikush që mundet t'ia largojë atë vështirësi, qoftë nga ana praktike apo edhe duke ia treguar gjendjen e tij. Kjo nuk konsiderohet mangësi e as ankesë e ndaluar tek krijesat. Ky veprim është normal dhe tek njerëzit është bërë e zakonshme që të kërkojnë ndihmën e njëri-tjetrit. Prandaj Jusufi iu drejtua atij që mendoi se do të shpëtonte: **“Përmendëm mua tek pronari yt!”** (Jusuf, 42)

27- Një mësuesi apo thirrësi në rrugë të Allahut i kërkohet që të përdorë sinqeritetin e plotë në mësimdhënien dhe thirrjen e tij dhe të mos e bëjë këtë mjet për të përfituar shuma të hollash, famë, apo ndonjë dobi tjetër. Ai nuk duhet ta ndërpresë mësimdhënien edhe nëse pyetësi nuk e bën atë që i thotë mësuesi. Jusufi vërtetë e kishte porositur njërin nga djelmoshat që ta përmendte atë tek pronari i tij, por ai nuk e përmendi dhe harroi. Megjithatë kur doli në pah nevoja e tyre për të pyetur Jusufin, ata dërguan të njejtin djalosh i cili shkoi dhe e pyeti për ëndrrën dhe Jusufi nuk e qortoi, nuk iu hakërrye pse ai nuk e kishte përmendur tek pronari i tij? Përkundrazi, ai iu përgjigj plotësisht në të gjitha aspektet!

28- Ai që pyetet, në momentin kur jep përgjigjen, duhet ta orientojë pyetësin tek ajo që është më e dobishme për të, për atë kohë sa ka lidhje me pyetjen e tij dhe ta orientojë në atë rrugë që do t'i bëjë dobi në fenë dhe jetën e tij. Kjo përfshihet tek këshilla e plotë, mendimi i tij i mirë dhe orientimi i duhur. Jusufi nuk u mjaftua me interpretimin e ëndrrës së mbretit, por u tregoi dhe u dha mendim se si duhet të vepronin në vitet e bollëkut që të shtonin bujqësinë dhe të ruanin me kujdes prodhimin.

29- Njeriu nuk qortohet nëse mundohet t'i largojë akuzat nga vetja e tij, madje kjo është e nevojshme. Siç ndodhi me Jusufin, i cili nuk pranoi të dilte nga burgu para se të dilte në pah fillimisht pafajësia e tij, duke kujtuar rastin egrave që prenë duart në momnetin kur e panë.

30- Mësojmë vlerën e dijes: Veçanërisht dijen e legjislacionit dhe dispozitave, si dhe dijen e interpretimit të ëndrrave, dijen e menaxhimit dhe edukimit, si dhe dijen e mirëqeverisjes. Jusufi e arriti gradën e lartë në këtë botë dhe në botën tjetër pikërisht me anë të njohurive të tij të ndryshme. Gjithashtu mësojmë se dija e interpretimit të ëndrrave përfshihet tek fetvatë, që do të thotë

se nuk i lejohet askujt që të shprehet prerë në interpretimin e ëndrrave para se ta njohë atë fushë, ashtu sikurse nuk i lejohet të japë fetva në dispozita pa patur dijen e duhur, sepse Allahu e ka quajtur interpretimin e ëndrrës fetva dhe këtë e ka përmendur pikërisht në këtë sure.

31- Nuk ka asnjë problem që njeriu të flasë dhe të tregojë për gjërat e tij, për sjelljen apo dijen e tij, etj., nëse kjo ka dobi, dhe nëse ruhet nga gënjeshtria dhe syfaqësia. Kjo bazuar në fjalën e Jusufit kur thotë: **“Më cakto përgjegjës të depove të vendit, sepse unë jam ruajtës dhe njohës (i mirë i këtyre punëve)”**. (Jusuf, 55)

Gjithashtu nuk përçmohet mandati i dikujt përderisa ai bën aq sa mundet në zbatimin e legjislacionit dhe çuarjen në vend të detyrimeve që u takojnë të tjerëve. Madje nuk ka problem që të kërkojë mandatin e udhëheqjes nëse e meriton dhe ka më shumë përgatitje se të tjerët. Ajo që nënçmohet është kur e kërkon ai që nuk ka përgatitjen e duhur, apo kur ka të tjerë që janë më meritore se ai apo të ngjashëm me të, ose kur nuk janë zbatuar urdhrat e Zotit dhe kur ky që don të sundojë, synon vetëm udhëheqjen dhe interesat personale.

32- Bujaria dhe nderimi i Zotit ndaj robit është shumë i gjerë. Ai i jep robrit prej mirësive të dunjasë dhe botës tjetër. Por mirësia e botës tjetër arrihet përmes dy mënyrave:

1- Me anë të imanit (besimit) në çdo gjë për të cilën na ka njoftuar Allahu.

2- Përmes devotshmërisë që aludon në praktikimin e urdhrave legjislative dhe largimin prej të ndaluarave.

Mirësia e botës tjetër është shumë më e mirë se ajo e dunjasë dhe pushteti i saj. Robi duhet t'i flasë vetes dhe të përballlohet për shpërblimin e Allahut dhe nuk duhet të brengoset përballë

kënaqësive të dunjasë dhe sundimit të saj, nëse nuk mund t'i arrijë ato! Jo, përkundrazi, ai inkurajohet duke kujtuar shpërblimin e botës tjetër, gjë që e mbush me shpresë dhe qetësi shpirtërore. Kjo bazuar në fjalën e Jusufit: **“Ndërsa shpërblimi i jetës tjetër është më i mirë për ata që besojnë dhe e kanë frikë Allahun.”** (Jusuf, 57)

33- Shtimi i rrizkut, nëse ka për qëllim lehtësimin e jetesës së njerëzve pa u bërë dëm atyre nuk ka problem madje është i kërkuar, sepse Jusufi i urdhëroi që t'i ruanin prodhimet dhe ushqimet gjatë viteve të bollëkut me qëllim që të përgatiteshin për vitet e thata dhe përmes kësaj u arrit mirësi shumë e madhe.

34- Mësojmë mirë menaxhimin e Jusufit në momentin kur mori përsipër depot e mbarë Egjiptit nga njëri cep në tjetrin. Ai i dha hov bujqësisë deri aty sa u shtua prodhimi dhe njerëzit që jetonin në zona të tjera synonin Egjiptin për të kërkuar ushqim atëherë kur nuk gjenin në vendet e tyre, sepse e dinin se në Egjipt mund të gjenin. Prej drejtësisë dhe mirëorganizimit të tij dhe frikës se mos tregtarët luajnë me të, ai nuk lejonte askënd të peshonte më shumë ose më pak ngase i nevojitej. Ndërsa atyre që vinin nuk u jepte më shumë se një mushkë me drithëra dhe ajo që kuptohet është se ai u jepte vendasve më pak se aq, sepse ishin më afër dhe mund të ishin prezent në çdo kohë.

35- Mikpritja është e pëlqyeshme. Ajo është traditë e të gjithë peygamberëve, kjo sepse Jusufi tha: **“A nuk e shihni se unë jua jap masën të plotë dhe jam më i miri mikpritës?”** (Jusuf, 59)

36- Opinioni negativ në prezencën e argumenteve të tërthorta që e pohojnë atë nuk është i ndaluar dhe as haram. Kujtoni kur Jakubi u tha djemve të tij: **“A mos vallë t’jua besoj juve, ashtu siç jua pata besuar më parë vëllain e tij?”** (Jusuf, 64)

Gjithashtu u tha: **“Nuk është kështu, por ju keni kurdisur diçka.** (Jusuf, 83)

Në rastin e fundit edhe pse nuk treguan neglizhencë, atyre u kishte ndodhur ajo që e detyroi babain e tyre t'i thoshte ato fjalë dhe të mos qortohej.

37- Përdorimi i shkaqeve që largojnë mësyshin, apo dëme të tjera, apo që e largojnë atë pasi t'i ketë rënë dikujt, nuk është e ndaluar. Edhe pse asgjë nuk ndodh pa caktimin e Allahut dhe paracaktimin e Tij, duhet të dimë gjithashtu se edhe shkaqet përfshihen në caktimin apo paracaktimin e Allahut. Kjo bazuar në fjalën e Jakubit që tha: **“O djemtë e mi, mos hyni nga e njëjta portë (e qytetit), por nga porta të ndryshme.”** (Jusuf, 67)

38- Lejimi i përdorimit të hileve dhe dredhive përderisa të çojnë tek e drejta jote dhe se njohja e të tilla mënyrave që çojnë tek qëllimet, konsiderohet diçka e lavdëruar. Ndërsa hilet që kanë për qëllim rrëzimin e një detyrimi apo veprimin e një vepre të ndaluar, konsiderohen të ndaluara dhe nuk duhen bërë.

39- Ai që do t'i japë të kuptojë dikujt diçka tjetër nga ajo që synon, s'ka problem të përdorë fjalë me shumë kuptime apo veprime që në fakt e ruajnë nga gënjeshtria e qartë. Siç veproi Jusufi kur vendosi kupën në barrën e vëllait të tij, pastaj e nxori prej saj duke u dhënë të kuptonin se ai ishte hajduti, edhe pse këtu nuk thotë se ai e kishte vjedhur, sepse ai përdori fjalë me shumë kuptime. E ngjashme me këtë është fjala e tij kur thotë: **“Allahu na ruajtë, si të marrim atë tjetrin në vend të atij te i cili e kemi gjetur sendin tonë!** (Jusuf 79) Dhe nuk tha: Ai që ka vjedhur mallin tonë.

40- Njeriu duhet të dëshmojë vetëm për ato gjëra që i di dhe i ka vërtetuar me anë të shikimit apo dëgjimit. Bazuar në fjalën e tij: **“Ne dëshmojmë vetëm për atë që dimë.”** (Jusuf, 81)

Si dhe fjalën e tij: **“Përveç atyre që dëshmojnë me të vërtetën duke e ditur atë.”** (Zuhruf, 86)

41- Mësojmë për sprovën e madhe me të cilën Allahu e sprovoi profetin dhe të zgjedhurin e tij Jakubin (alejhi selam) në momentin kur e ndau nga djali i tij Jusufi. Ai e kishte të pamundur të ndahej prej tij qoftë dhe një orë të vetme, ndaj dhe kjo gjendje e pikëllonte shumë. Duke qenë se kjo ndarje zgjati shumë, mërzia kurrë nuk iu largua nga zemra, aq sa sytë iu zbardhën prej pikëllimit. Kjo iu shtua edhe më shumë kur ndodhi ndarja me djalin e tij të dytë, e megjithatë ai përsëri duronte dhe priste shpërblim nga Allahu duke premtuar se do bënte durim të mirë. S’ka dyshim se ai e përmbushi atë që premtoi dhe kjo nuk bie ndesh me fjalën që ai tha: **“Unë dhimbjen time dhe pikëllimin tim ia paraqes vetëm Allahut.** (Jusuf, 86)

Sepse ankimi tek Allahu nuk bie ndesh me durimin, ajo që bie ndesh është ankesa tek krijesat.

S’ka dyshim se përmes kësaj sprove Allahu e ngriti në pozitë të lartë dhe i dha vend nderi, i cili arrihet vetëm përmes këtij durimi.

41- Sa herë që sprova vështirësohet, fitorja është më afër. Në momentin kur vështirësitë u bënë të shumta dhe të llojllojshme dhe robi u ndie shumë ngusht në bartjen e tyre, ato i largoi Ai që largon brengën dhe heq pikëllimin, Ai që u përgjigjet lutjeve të atyre që janë në nevojë (Allahu). Këto janë frytet e saj të lavdëruara, veçanërisht ndaj evlijave të Zotit dhe njerëzve të zgjedhur.

42- Lejohet që njeriu të tregojë mundimin, qoftë sëmundje, varfëri apo diçka tjetër, nëse kjo bëhet jo në formë zemërimi.

Kjo bazuar në fjalën e Jakubit (alejhi selam): **“O i mjeri unë për Jusufin!”** (Jusuf 84) Si dhe fjalët e vëllezërve të Jusufit kur thanë: **“O ministër, ne dhe familjen tonë e ka goditur një fatkeqësi e madhe.”** (Jusuf, 88) Dhe Jusufi e pranoi prej tyre dhe e miratoi atë!

43- Mësojmë vlerat e devotshmërisë dhe durimit dhe se çdo mirësi e kësaj bote dhe e botës tjetër vjen si fryt i devotshmërisë dhe durimit. Mësojmë gjithashtu se fundi i atyre që e kanë (devotshmërinë dhe durimin) është fundi më i mirë. Kjo bazuar në fjalën e Allahut që thotë: **“Allahu na mëshiroi. Atë që ruhet (nga gjynahet) dhe bëhet i durueshëm, Allahu e shpërblen, se Ai kurrë nuk ia humb shpërblimin punëmirëve”.** (Jusuf, 90)

44- Njeriut kur t'i jepet një mirësi pas një fakteqësie apo sprove duhet patjetër të kujtojë gjendjen e tij të mëparshme me qëllim që ta nidejë më shumë atë mirësi që i është dhënë dhe të falenderojë më shumë Allahun e Lartësuar. Prandaj Jusufi tha: **“Mua më bëri mirësi, kur më nxori nga burgu, kurse juve ju solli nga shkretëtira, pasi djalli pati futur ngatërresë midis meje dhe vëllezërve të mi.”** (Jusuf, 100)

45- Nga kjo histori mësojmë të gjitha mirësitë e ndryshme që lehtësuan sprovat, si për shembull ëndrra e parë e Jusufit. Kjo ëndërr mbante në vetvete çlirim dhe mirësi, si për Jusufin ashtu dhe për Jakubin. Ajo ishte një përgëzim për mundësinë e interpretimit të saj dhe mëshirë për Jusufin të cilit i shpalli në kohën kur ai ishte në pus se ai do t'i vinte në dijeni për këtë që bënë dhe ata nuk do ta ndienin. Si dhe kalimet e tij nga një gjendje në një tjetër edhe këtu vihet re mëshira e hapur dhe e fshehtë e Zotit, prandaj në fund të historisë ai thotë: **“Vërtet, Zoti im është i Butë me kë të dojë; Ai është i Gjithëdijsmi dhe i Urti!”** (Jusuf, 100)

Ai tregoi mirësi ndaj tij si në gjendjen e brendshme, po ashtu dhe në gjendjen e tij të dukshme duke i dhënë mundësinë të arrinte lartësitë pa e kuptuar as ai vetë, pra Jusufi (alejhi selam).

46- Njeriu duhet që gjithmonë të lutet me ngulm para Allahut që Zoti i tij ta përforcojë në besim dhe t'i mundësojë fundin e mire, si dhe t'i bëjë ditët e fundit të jetës më të mira se ato të parat dhe punët më të mira ato që mbyllin jetën, sepse Allahu është Fisnik, Bujar dhe i Mëshirshëm.



HISTORIA E MUSAIT DHE HARUNIT

(alejhima salam)

Për Musain, birin e Imranit dhe vëllain e tij (Harunin) Zoti i Lartësuar ka përmendur një histori shumë të gjatë. Në shumë pjesë të librit fisnik, ndodhia e Musait është trajtuar me stile (letrare) të ndryshme, disa herë në formë të shkurtuar, e herë të tjera e detajuar siç e kërkonte nevoja.

Nga historitë që tregohen në Kur'an, nuk ka ngjarje më madhore se ajo e Musait (alejhi salam)! Kjo për faktin se ai (Musai) nga njëra anë i dha fund tiranisë së Faraonit dhe ushtrisë së tij dhe nga ana tjetër kuroi me mund të madh veset e Beni Israilëve.

Ai konsiderohet profeti më i madh i Beni Israilëve, ndërsa libri dhe legjislacioni që ndoqi ishte Teurati, që në realitet ishte referenca e profetëve dhe dijetarëve të Beni Israilëve, ndërsa ndjekësit e tij (Musait) konsiderohen më të shumtit në numër, pas umetit të Muhamedit (alejhi salam).

Ai kishte vendosmëri (forcë) të madhe në zbatimin e fesë së Allahut dhe thirrjes për tek feja e Tij. Këtë e ruante me aq fanatizëm sa nuk mund ta hasësh tek ndonjë i dërguar tjetër.

Ai lindi në një periudhë kur Faraoni po e shtypte popullin e Beni Israilëve, duke vrarë çdo foshnjë mashkull tek beni Israilët nga njëra anë dhe nga ana tjetër duke lënë gjallë vetëm femrat, për të shërbyer dhe për t'i përçmuar.

Kur lindi Musai (alejhi salam) nëna e tij u frikësua shumë, sepse Faraoni kishte lënë mbikqyrës tek beni Israilët për të parë gratë që lindnin. Shtëpia e saj ndodhej në bregun e lumit Nil dhe Allahu e frymëzoi që të merte një arkë dhe kur të frikësohej për të, ta hidhte në lum pasi ta kishte lidhur arkën me litar me qëllim që të mos e merrte rryma e ujit.

Ishte mëshira e Zotit kur e frymëzoi nënën e tij duke i thënë: **“Jepi gji atij dhe, kur të trembesh për sigurinë e tij, hidhe në lumë, pa pasur frikë dhe as dëshpërim. Me siguri që Ne do të ta kthejmë ty atë dhe do ta bëjmë të dërguar.”** (Kasas 7)

Një ditë kur e la arkën në lumë, litari që e mbante lidhur u zgjidh dhe kështu uji e mori arkën ku qëndronte Musai (alejhi salam). Ishte caktimi i Zotit që ai (Musai) të binte në duart e familjes së Faraonit dhe pikërisht në duart e gruas së tij, Asijas!

Kur e pa (Musain) ajo ndjeu një dashuri të madhe për të, sepse Allahu e kishte hedhur atë dashuri tek Musai (alejhi salam)

Lajmi mori dhenë dhe ra në vesh të Faraonit. Ai e kërkoi dhe deshi ta vriste, por gruaja e tij i tha: **“Ky (djalë) është gëzim për mua dhe ty, prandaj mos e vrisni, sepse mund të jetë i dobishëm ose mund ta birësojmë”** (Kasas 9)

Ky lloj arsyetimi, bëri që ai të shpëtojë nga një vrasje e sigurtë. Kjo gjurmë e mirë, kjo hyrje e mbarë dhe kjo përpjekje e lavdëruar (nga Asija) u bë shkak që ajo më vonë të udhëzohej dhe të besonte Musain dhe profetësinë e tij.

Por nëna e Musait u trondit shumë, zemra e saj u bë si të ishte e zbrazët dhe për pak sa i sosi durimi: **“Edhe pak dhe çdo gjë do të zbulohej, sikur të mos ia kishim forcuar Ne zemrën, që të bëhej besimtare e vërtetë. Ajo i tha motrës së Musait: ‘Shko pas tij!’”** (Kasas 10-11)

Ndiqi gjurmët e tij!

Edhe pse gruaja e Faraonit ua kishte dhënë Musain disa prej grave gjidhënëse, ai se kishte pranuar gjirin e asnjërës prej tyre. Kështu që foshnja ndiente etje, strukej nga uria e madhe dhe kjo i detyroi të dilnin për të kërkuar gjidhënëse, me shpresën se Zoti do ua mundësonte të gjenin dikë.

E motra e vrojtonte atë nga larg, pa u vënë re nga të tjerët. Kur u afrua dhe e kuptoi se ata po kërkonin një gjidhënëse u tha: **“A doni t’ju gjej një familje, e cila do të kujdeset për të, duke e edukuar me kujdes?”** (Kasas 12-13)

Në suren Kasas, Allahu i Lartësuar na e tregon historinë e Musait të detajuar, mjaft të qartë dhe dinamike! Leximi i kësaj sureje është i mjaftueshëm dhe nuk kërkon sqarim të madh për shkak të qartësisë dhe detajeve që ajo sjell.

Allahu e tregoi (këtë histori) të detajuar, me qëllim që të përfitojmë e të nxjerrim mësim.

S’ka dyshim se në historinë e Musait ka shumë dobi dhe mësim, prej të cilave ne do të përmendim:

Dobitë dhe mësimet e përfituara nga historia e Musait (alejhi selam)

1-Në këtë histori, mësojmë butësinë dhe mëshirën e Zotit ndaj nënës së Musait, kur e frymëzoi në atë mënyrë me të cilën e shpëtoi djalën e saj. Pa harruar dhe përgëzimin që Zoti i dha asaj se do t’ia kthente të birin, premtim i cili po të mos kishte

ekzistuar, nënën e Musait do ta kishte mbytur dëshpërimi për djalin e saj.

Allahu e ktheu Musain tek nëna e tij, duke i dhënë strehën e paracaktimit sepse ishte caktim i Zotit që ai (Musai) të mos pranonte asnjë gjidhënëse tjetër, veç nënës së tij.

Nga kjo mësojmë se mëshira e Zotit ndaj të dashurve të Tij ndodh në gjëra që mendja nuk i percepton dhe fjalët nuk arrijnë t'i shprehin.

Medito gjithashtu në ndikimin e këtij përgëzimi, se si i erdhi fëmija që ajo ta ushqente haptazi me gjirin e saj madje dhe të merrte pagesë duke u quajtur kështu nëna e tij, si nga ana biologjike ashtu edhe nga ajo legislative.

Kjo bëri që zemra e saj të qetësohej edhe më shumë dhe besimi i saj të shtoej. Për të vërtetuar fjalën e Allahut që thotë: **“Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju.”** (El Bekare 216)

Për nënën e Musait, nuk kishte gjë më të urreyer që fëmija i saj të binte në duart e familjes së Faraonit, e megjithatë doli që kjo të kishte mirësi dhe fryte shumë të mira.

2-Faktet e Zotit dhe ajo që pësuan popujt e mëhershëm, duhet të na shërbejnë si mësim. Besimtarët përmes këtyre fakteve duhet të ndriçohen, sepse Allahu i tregon këto ndodhi për të përfituar, siç thotë në Kur'anin fisnik: “Ne do të të tregojmë ty pjesë nga historia e Musait me Faraonin, ashtu siç ka qenë me të vërtetë, për njerëzit që besojnë.” (Kasas 3)

3-Allahu kur dëshiron të ndodhë diçka i përgatit shkaqet dhe i sjell ato gradualisht dhe jo të gjitha në një moment.

4-Një popull të shtypur, edhe nëse arrin kulmin e dobësisë, nuk duhet ta mposhtë dembelizmi për të kërkuar të drejtat që i takojnë. Nuk duhet të bjerë në pesimizëm ndaj synimit të

majave, sidmos kur bëhet fjalë për padrejtësi. Ashtu sikurse Allahu i shpëtoi beni Israilët edhe pse ishin të dobët dhe skllevër të Faraonit e parisë së tij, Ai (Allahu) ishte që i ndihmoi dhe u mundësoi qëndrim në tokë dhe përdorimin (trashëgimin) e vendeve të tyre (Faraonit dhe parisë së tij)

5-Një popull i cili qëndron i poshtëruar dhe i përulur dhe nuk i kërkon të drejtat që i takojnë, nuk do të ketë perspektive në ruajtjen e fesë, por as edhe në ngritjen e jetesës në tokë.

6-Frika e natyrshme nga krijesat nuk bie ndesh me imanin (besimin) dhe as nuk e cenon atë, siç i ndodhi nënës së Musait me frikën që ajo pati për djaln e saj, apo edhe vetë Musait, nga gjërat e frikshme që i kanoseshin.

7-Imani shtohet dhe pakësohet, këtë e themi duke u bazuar në fjalën e Allahut kur thotë: **“Që të bëhej besimtare e vërtetë.”** (Kasas 10)

Qëllimi i imanit (besimit) në këtë ajet, është shtimi i tij dhe shtimi i qetësisë me të.

8-Prej mirësive më të mëdha që Zoti i jep robit, është kur i jep forcë në rastet e vështira dhe të mbushura me frikë. Duhet ditur se ashtu sikurse imani dhe shpërblimi i tij rriten, gjithashtu këtij njeriu i mundësohet edhe të thotë të vërtetën dhe të veprojë gjënë e duhur, kurse idetë dhe mendimet e tij qëndrojnë të palëkundura.

Ndërsa ai që nuk e gëzon këtë forcë, për shkak të shqetësimit dhe frikës, fillon t'i humbasë idetë, mendja e tij shpërqendrohet dhe nuk përfiton nga vetja e tij në këtë situatë.

9- Njeriu, edhe nëse e di dhe është i bindur se caktimi dhe paracaktimi i Zotit është i vërtetë dhe se premtimi i Allahut ka për të ndodhur patjetër, nuk duhet t'i neglizhojë shkaqet që

sjellin ndryshimin. Shkaqet dhe rendja pas tyre po ashtu janë pjesë e kaderit të Allahut. Edhe pse Allahu i Lartësuar i premtoi nënës së Musait se do t'ia kthente përsëri Musain, megjithatë kur Musai ra në duart e familjes së Faraonit, ajo dërgoi motrën e tij (Musait) që ta ndiqte, duke marrë në këtë mënyrë masat e duhura për atë situatë.

10- Mësojmë lejin e daljes së gruas për të kryer punët e saj qoftë dhe duke biseduar me gjininë e kundërt përderisa nuk ekziston arsye ndalimi. Si rasti i motrës së Musait, apo atyre dy vajzave nga Medjeni (që komunikuuan me Musain)

11- Lejimi i marrjes së pagesës kundrejt kujdestarisë apo gjidhënies, siç veproi nëna e Musait. E themi këtë, sepse legjislacioni i popujve para nesh konsiderohet legjislacion edhe për ne, përderisa nuk kemi në sheriatin tonë argument që e pezullon atë.

12- Vrasja e jobesimtarit që është në besë të dikujt apo në mbrojtjen e dikujt nuk është e lejuar. Musai (alejhi selam) u pendua për vrasjen e kobtit egjiptian dhe kërkoi falje tek Allahu për këtë veprim dhe Ai ia pranoi pendimin.

13- Ai që vret njerëz padrejtësisht konsiderohet kryeneç dhe prishës i rregullit në tokë, edhe nëse pretendon se me këtë synon thjesht të terrorizojë, apo mendon se është duke përmirësuar! Kjo nuk i lejohet në asnjë mënyrë derisa t'i kthehet legjislacionit dhe të shohë rastet kur i lejohet diçka e tillë.

14- Ta vësh dikë në dijeni duke pasur si qëllim keshillën, në lidhje me gjërat që thuhën për të apo kundrejt tij, nga frika e të keqes që mund t'i kanoset, nuk përbën thashethem! Madje ka raste kur një hap i tillë mund të bëhet detyrë, siç ishte rasti i atij njeriut që erdhi duke nxituar nga cepi i qytetit për t'i treguar Musait, veprim që Kur'ani e tregon në formë lavdërimi.

15- Njeriu, kur frikësohet nga vrasja apo dëmtimi i padrejtë që mund t'i kanoset në vendin ku jeton, nuk duhet ta çojë veten drejt shkatërrimit dhe të dorëzohet para rrënimit. Përkundrazi, le të largohet nga ai vend sipas mundësive që i jepen, ashtu sikurse veproi Musai (alejhi selam).

16- Nëse është e nevojshme që të kryhet njëra prej dy të këqia, atëherë bëhet e detyrueshme që të kryhet ajo që është më pak e dëmshme dhe më shumë e paqtë, për të larguar atë që është më e rëndë dhe më e rrezikshme.

Tek historia e Musait (alejhi selam), kur çështja u bë e tillë mes qëndrimit në Egjipt duke rrezikuar jetën dhe largimit për në një vend tjetër të largët që njerëzit nuk i lidhte rruga me të, pa dyshim që ai zgjodhi hapin e sigurt për të shpëtuar jetën, edhe pse nuk kishte udhërrëfyes për tek ai vend përveç udhëzimit që i vinte nga Zoti.

17- Nga historia e Musait (alejhi selam), ai që e kërkon dijen, mëson diçka të hijshme! Kërkuesit të dijes, që i duhet të punojë apo të flasë me këtë dije, por që nuk i është qartësuar se cili nga mendimet është më i saktë, duhet që udhëzimin ta kërkojë tek Zoti i tij! T'i lutet Allahut që ta udhëzojë tek e drejta mes këtyre dy mendimeve, pasi të ketë synuar të vërtetën dhe të ketë hulumtuar për të. Allahu nuk e zhgënjen atë që gjendet në këtë pozitë, siç ndodhi me Musain, i cili kur synoi kah Medjeni pa e ditur shtegun dhe udhëzuesin për atje, tha: **“Shpresoj se Zoti im do të më tregojë rrugën e drejtë!”** (Kasas 22)

18- Mëshira dhe mirësia ndaj krijesave, duhet të ekzistojë si ndaj atyre që i njeh, ashtu edhe ndaj të tjerëve që nuk i njeh. Prej moralit dhe mirësisë që gëzonin Pejgamberët ishte dhe mundësia për t'u dhënë ujë bagëtive apo ndihma ndaj të vobektëve. Siç i ndodhi Musait me dy vajzat e të moshuarit nga

Medjeni, kur i ndihmoi për t'u dhënë ujë bagëtive të tyre, në momentin kur i pa se ishin të pamundura për ta bërë diçka të tillë pa u larguar barinj të tjerë.

19- Allahu i Lartësuar, ashtu sikurse do që lutësi t'i kërkojë (lutet) Atij përmes emrave dhe attributeve, përmes mirësive të plota dhe të veçanta, po ashtu Ai do që robi t'i kërkojë (lutet) Atij edhe duke treguar dobësinë, paaftësinë, varfërinë dhe pamundësinë për të arritur interesat e tij, apo për të larguar dëmet nga vetja. Siç ndodhi me Musain, kur u lut duke thënë: **“Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!”** (Kasas 24)

Kjo gjendje, shfaq përgjërimin, pamundësinë dhe nevojën e madhe për Zotin e Lartësuar, gjendje e cila karakterizon çdo krijesë.

20- Jeta dhe shpërblimi ndaj mirësisë, kanë qenë gjithmonë etika dhe morali i popujve të mirë.

21- Robi kur kryen një vepër të sinqërtë për Allahun dhe pastaj arrin të marrë një shpërblim të paqëllimshëm, për këtë ai nuk qortohet dhe kjo nuk e cenon aspak sinqeritetin dhe shpërblimin e tij. Si rasti i Musait, i cili e pranoi shpërblimin e babait të dy vajzave, për mirësinë që ai i kishte bërë edhe pse ai nuk e kërkoj dhe as që e synonte një shpërblim të tillë.

22- Lejimi i pagesës në çdo punë të njohur, me çmim dhe kohë të caktuar duke u mbështetur në atë që është bërë zakon tek ai popull. Gjithashtu, lejohet që pagesa të vijë në formë interesi, siç është martesë p.sh. Siç u shpreh i moshuari nga Medjeni: **“Plaku tha: “Unë dua të të jap për grua njërën prej këtyre dy bijave të mia.”** (Kasas 27)

Po ashtu lejohet që vetë babai të kërkojë martesën e vajzës

së tij përderisa është kujdestari i saj dhe kjo nuk konsiderohet mangësi (turp), përkundrazi mund të jetë veprim i dobishëm dhe i përkryer! Siç veproji plaku nga Medjeni me Musain (alejhi selam)

23- Ajeti Kur'anor, ku njëra nga vajzat i drejtohet babait duke i thënë: **“O babai im, - tha njëra nga ato të dyja - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët që dikush mund të marrë në shërbim”**. (Kasas 26)

Me anë të këtyre dy cilësive (tipareve) plotësohen dhe realizohen të gjitha punët. Ndaj cilido që merr përsipër drejtimin e një zone, kryerjen e ndonjë shërbimi, ushtrimin e ndonjë zanati, apo gjëra që synojnë ruajtjen dhe mbikëqyrjen ndaj punëtorisë, duhet të gëzojë patjetër cilësitë e forcës dhe besueshmërisë, sepse vetëm kështu arrihet qëllimi, kryhet puna dhe korren frytet e saj. Ndërsa mangësitë dhe problemet, ndodhin atëherë kur neglizhohet njëra apo që të dyja këto cilësi!

24- Prej moralit të lartë është edhe përmirësimi i sjelljes me të gjithë ata me të cilët ke një marrëdhënie, qofshin shërbëtorë, fqinj, pjesëtarë të familjes, punëtorë etj. Këtu, përfshihet lehtësimi i punës ndaj tyre, kjo bazuar në fjalën e plakut nga Medjeni që i tha Musait (alejhi selam): **“Unë nuk dëshiroj të t'i rëndoj gjërat. Ti do të shohësh, në dashtë Allahu, se jam njeri i mirë.”** (Kasas 27)

Nga ky ajet mësojmë gjithashtu se nuk ka problem nëse punëdhënësi gjatë punës së tij, këmbimeve apo pagesës ta prezantojë veten e tij si njeri me sjellje të mirë, me kusht që të jetë i vërtetë (sinqertë) në atë që thotë.

25- Lejimi i veprimeve, transaksioneve, qerasë, etj., pa patur

nevojë për dëshmitarë, kjo bazuar në ajetin Kur'anor: **“Allahu është Dëshmues për atë që folëm.”** (Kasas 28)

Pak më parë përmendëm se përmes dëshmisë, ruhen detyrimet dhe mënjanojen grindjet. Ndërsa njerëzit që përmbushin këto detyrime janë në nivele të ndryshme.

26- Mrekullitë me të cilat Allahu e ndihmoi Musain, siç ishte transformimi i shkopit në gjarpër që lëvizte dhe rikthimi i tij në gjendjen e mëparshme, apo rasti i dorës, të cilën e fuste në xhepin e tij dhe kur e nxirrte dilte e bardhë pa asnjë mangësi për ata që e shihnin. Apo mëshira e Allahut dhe mbrojtja që i bëri Musait dhe Harunit nga Faraoni dhe paria e tij, duke çarë detin në momentin kur Musai e qëlloi me shkopin e tij, duke hapur kështu 12 shtigje, prej ku kaluan dhe shpëtuan, ndërsa populli i Faraonit u shaktërrua. Apo mrekulli të tjera që vinin radhë për cilindro që i shihte apo dëgjonte, e të cilat janë përcjellë tek ne në formën më të sigurtë, përmes librave qiellorë dhe që i kanë përcjellë brezat. Të gjitha këto, nuk i mohon veçse injoranti, mendjemadhi dhe zindiku. Të gjitha mrekullitë e profetëve janë të këtij rangu (në vërtetësinë që kanë).

27- Mrekullitë e pejgamberëve, rastet e pazakonta të eulajve (të dashurve të Zotit) apo raste të tjera që Allahu i bën të ndodhin e që janë të pamundura për njerëzit, qoftë në ndryshimin e shkaqeve apo ndalimin e shkakësisë së tyre, apo nevojën për shkaqe të tjera si dhe ekzistenca e kundërndikimeve, të gjitha këto janë prej argumenteve të mëdha që pohojnë Njëshmërinë e Zotit dhe se Ai ka fuqi për çdo send.

Po ashtu mësojmë se prej caktimit të Zotit nuk mund të shpëtojë asgjë e vogël apo e madhe. Dhe se këto mrekulli, apo gjëra të pazakonta nuk bien ndesh me atë që Zoti ka krijuar në këto krijesa, prej shkaqeve të prekshme dhe rregullave të

njohura, sepse në ligjin e Zotit nuk ka për të patur ndryshim e as tjetërsim.

Në ligjet e Allahut, të gjitha ngjarjet, si të hershmet apo edhe ato që do të ndodhin më vonë, ndahen në dy kategori:

E para: Janë grupi i ndodhive dhe ngjarjeve, ligjeve legislative dhe universale, si dhe dispozitat e shpërblimit të cilat nuk ndryshojnë e as tjetërsohen nga ajo që njohin apo dinë njerëzit prej shkaqeve që i sjellin ato. Kjo kategori është e përfshirë në fuqinë e Allahut dhe caktimin e Tij. Prej kësaj mësojmë se sa e gjerë është dituria e plotë e Allahut dhe urtësia e Tij në krijim dhe ligjëvënie. Po ashtu tek shkaqet dhe pasojat mësojmë se nëse njeriu ndjek rrugën e duhur, kjo e shpie në përfundime dhe fryte të kënaqshme, ndërsa ai që nuk e ndjek këtë rrugë, apo e ndjek në formë të cunguar, nuk i arrin frytet që janë parashikuar, si në aspektin legjislativ ashtu dhe në ligjin universal. Për më tepër, kjo duhet ta nxisë njeriun që të përpiket më shumë sa i përket shkaqeve fetare dhe jetësore të dobishme (kur don të arrijë diçka), pa lënë mënjanë mbështetjen tek Allahu dhe lavdërimin e Tij, i Cili ia mundësoi dhe ia lehtësoi atë shkak, mjet, apo çdo gjë që e finalizoi atë.

E dyta: Ngjarjet që flasin për mrekullitë e pejgamberëve, e që janë përcjellë në mënyrë aq korrekte sa nuk ndodh të përcillet aq saktë tek mbarë brezat, apo nderimi që Allahu i bën ndonjërit prej robërve të Tij, duke i pranuar lutjen, duke i larguar ndonjë brengë, duke i mundësuar plotësimin e ndonjë kërkesë, apo duke e ruajtur nga ndonjë e keqe, të cilën rob i nuk do të mund ta largonte. Në këtë kategori përfshihen gjithashtu kthjellimet Hyjnore dhe inspirimet që Allahu i hedh në zemrat e disa njerëzve të veçantë, me anë të të cilave ata arrijnë vërtetësinë dhe qetësinë e imanit, njohuri të ndryshme që nuk mund të

fitohen duke kërkuar apo rendur pas shkaqeve, si dhe ndihma që Allahu u jep profetëve dhe ndjekësve të tyre apo poshtërimi që u bën armiqve të tyre, gjë e cila ka ndodhur në shumë raste. Duhet të dimë se në këtë kategori njerëzit e kanë të pamundur të kuptojnë apo të udhëzohen kah shkaqet që i sjellin këto ngjarje, sepse nuk u është dhënë mundësia që ta arrijnë realitetin dhe vërtësinë e tyre. Ato janë ngjarje që Zoti i Madh i ka caktuar të ndodhin, pra nga Ai që ka fuqi për çdo send. Këto (raste) Ai i mundësoi të ndodhin përmes disa shkaqeve dhe ligjeve të cilat nuk i preceptojnë krijesat e as që i konceptojnë shqisat dhe përvoja e tyre nuk ka për t'i kuptuar në asnjë formë.

Këtë (fakt) e besuan pejgamberët nga i pari e deri tek i fundit, ashtu sikurse e besuan edhe ndjekësit e tyre, të parët dhe ata që erdhën më pas, sepse përmes këtij fakti ata njohin madhësitinë e Krijuesit dhe pranojnë se çdo gjë e robëve është në dorën e Tij dhe se çdo gjë që Ai do, ndodh, në të kundërt nuk mund të ndodhë. Mësojmë gjithashtë vërtetësinë e asaj që sollën profetët, sikurse u njohëm në trajtimin e kategorisë së parë. Po ashtu mësojmë se njerëzit nuk kanë asnjë lloj mundësie për të njohur realitetin e asaj që ka për të ndodhur në ditën e fundit dhe atë që është përgatitur në xhenet apo zjarr. Ajo që dimë janë vetëm ato gjëra që na ka mësuar Profeti e që janë përmendur në librat hyjnorë. Mësojmë gjithashtu se banorët e tokës nuk mund të arrijnë tek banorët e qiejve dhe nuk kanë asnjë lloj mundësie që të ngjallin të vdekurit apo të sjellin në jetë shpirtra apo gjëra të ngurta, sepse edhe kjo kategori përfshihet në atë që quhet: Ligj i universit (që i përket vetëm Zotit)

U zgjatëm në këtë çështje - paçka se ishte e nevojshme - për dy arsye:

E para: Sepse heretikët e kohëve tona e mohuan ekzistencën e Zotit dhe mohuan çdo gjë që lajmëruan profetët dhe librat

hyjnorë në çështjet e gajbit (të fshehtave), duke mos pranuar prej dijeve vetëm se ato njohuri që i preceptojnë mendjet e tyre, apo duke u bazuar vetëm në disa eksperimente të mangëta të disa shkencave të universit, duke mohuar gjithçka tjetër dhe duke pretenduar se kjo botë dhe ky rregull i vendosur në të nuk mundet që ta ndryshojë askush, apo që të ndryshojë diçka prej shkaqeve dhe se ato janë gjendur vetvetiu pa qenë e nevojshme për Krijues, dhe se çdo gjë është vegël që lëviz vetë dhe në natyrë nuk ka drejtues, as mbikqyrës, as Zot, e as Krijues.

Këta i njohin të gjithë ndjekësit e feve se sa kryeneç janë dhe sa arrogant tregohen në atë që thonë, sepse ashtu sikurse u zbrazën totalisht nga feja, po ashtu edhe logjika e tyre është zbrazur plotësisht nga e vërteta. Kjo për arsye se mohuan faktet dhe argumentet më të qarta, më të dukshme dhe më të mëdha. Ata humbën me mendjet e tyre të mangëta dhe idetë e tyre të prishura dhe rasti i tyre është i njohur, por...

E dyta: Disa njerëz të ditur bashkëkohorë, të cilët shtiren sikur janë në mbrojtje të Islamit, orvaten me këta heretikë në debate rreth Islamit dhe kërkojnë që përmes përpjekjeve të tyre ose e thënë më mirë mashtrimit me veten, të vënë në provë ligjet hyjnore dhe çështjet e botës tjetër përmes asaj që njerëzit dinë dhe kuptojmë nëpërmjet shqisave të tyre apo që arrijnë t'i gjejnë përmes eksperimenteve. Në këtë mënyrë, e tjetërsuan atë që quhet mrekulli dhe kështu mohuan faktet e qarta dhe nuk përfituan prej kësaj veçse dëmin ndaj vetes dhe ndaj atyre që lexojnë librat dhe studimet e tyre. Imani i tyre u dobësua duke keqinterpretuar mrekullitë e profetëve në atë mënyrë që çon në mohimin total të kësaj kategorie që ka të bëjë me caktimin e Allahut, si dhe dobësuan imain e atyre që lexojnë fjalët e tyre pa patur njohuri fetare, por që shkojnë në mospranimin e kësaj pjese. Ata nuk e arritën atë që pretenduan për t'i tërhequr

materialistët drejt udhëzimit dhe fesë, por thjeshtë ua shtuan mashtrimin në atë që besojnë, sidomos kur panë njerëz si kjo kategori që mundohen t'i rikthejnë edhe njëherë kuptimet e teksteve fetare, mrekullitë e profetëve dhe çështjet që kanë të bëjnë me të fshehtën, duke shkuar drejt njohurive të mangëta, në prova dhe eksperimente që arrihen përmes shqisave. Sa fatkeqësi e madhe dhe sa krim monstruoz! Kështu ndodh kur njohuritë janë të varfëra dhe mahnitja pas heretikëve i çon që t'u përulen fjalëve të tyre. La haule ue la kuete ila bilah (s'ka forcë e as ndryshim pa ndihmën e Allahut)

27- Ndëshkimi më i madh për robin është atëherë kur bëhet udhërrëfyes dhe ftues për tek e keqja, ashtu sikurse prej mirësive më të mëdha është kur robi bëhet udhërrëfyes dhe udhëzues për tek e mira. Allahu i Lartësuar kur flet për Faraonin dhe parinë e tij thotë: **“Ne i bëmë ata udhëheqës, që thërrisnin për në zjarr.”** (Kasas 41)

Ndërsa për të dërguarit, thotë: **“Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë.”** (Enbija 73)

28- Në këtë histori (të Musait) del në pah vërtetësia e profetësisë së Muhamedit (alejhi selam) i cili na tregoi për këtë ndodhi si dhe për ngjarje të tjera në mënyrë të detajuar! Ai tregoi duke i vërtetuar pejgamberët e mëparshëm dhe duke përkrahur të drejtën e qartë. Ai nuk ishte prezent në ato vende, nuk kishte mësuar në asnjë vend që t'i njihje të gjitha ato detaje, e as që ishte ulur me njerëz të ditur! Jo, ajo ishte shpallje nga Mëshiruesi, Mëshirëploti. Ishte Profetësi që zbriti prej Fisnikut, Dhuruesit të mirësive, për të tërhequr vërejtjen e të gjitha krijesave.

Për këtë arsye, në fund të historisë, Allahu i Lartësuar thotë: **Ti (Muhamed) nuk ke qenë as pranë Turit, kur Ne thirrëm Musain.** (Kasas 46)

“Ti (o Muhamed) nuk ke qenë i pranishëm në anën perëndimore (të Turit), kur Ne ia besuam Musait misionin (profetësinë) dhe as nuk ke qenë dëshmitar i kësaj ngjarjeje.”

(Kasas 44)

“Ti nuk ke banuar midis banorëve të Medjenit, që t’iu lexoje shpalljet Tona, por Ne gjithnjë kemi çuar të dërguar.

(Kasas 45)

Kjo është njëra nga format me të cilat pohohet (vërtetohet) Profetësia e Muhamedit (alejhi selam)

29- Shumë dijetarë kanë përmendur se nga përgjigja që Musai i dha Zotit të tij, kur e pyeti për shkopin: **“Ç’është ajo që mban në dorën e djathtë o Musa?” Ai u përgjigj: “Ky është shkopi im, me të cilin mbahem dhe shkund gjethe për dhentë e mia; më shërben edhe për punë të tjera.”**

(Ta ha 17-18)

Kanë thënë: Nga ky ajet përfitohet pëlqimi i mbajtjes së shkopit për shkak të këtyre dobive ndihmëse që gjenden në të, sepse Musia tha: **“Më shërben edhe për punë të tjera.”**

Gjithashtu përfitohet dhe mëshira ndaj kafshëve dhe mirësia ndaj tyre, duke larguar çdo gjë që i dëmton.

30- Fjala e Allahut kur thotë: **“Dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua!”** (Ta ha 14)

D.m.th kur robi e përmend Zotin e tij, kjo është arsyeja për të cilën ai është krijuar dhe aty ai gjen elementin e përmirësimit dhe shpëtimit. Qëllimi i kryejes së namazit është pikërisht arritja e këtij synimi madhor. Po të mos ekzistonte namazi që besimtarët e përsërisin gjatë ditës dhe natës në mënyrë që t’ju kujtojë Allahun, po të mos ishte lidhja me leximin e Kur’anit, lavdërimin e Zotit, lutjen ndaj Tij, përgjërimit para Tij që në

fakt është esenca e adhurimit, po të mos ishin këto mirësi, njerëzit do mbeteshin të shkujdesur (gafil)

Duke qenë se krijesat u krijuan që të përmendin Allahun, duhet të dimë se të gjitha adhurimet janë përmendje e emrit të Tij. Dhikri (përmendja e Zotit) e ndihmon njeriun në zbatimin e adhurimeve edhe pse mund të jenë të vështira për të dhe ia lehtëson gjendjen në monentin kur të qëndrojë para tiranëve dhe ja lehtëson barrën e thirrjes në rrugë të Zotit.

Allahu i Lartësuar në historinë e Musait thotë: **Që të thurim shumë lavde për Ty e të të përmendim Ty vazhdimisht!**

(Ta ha 33-34)

“Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së më përmenduri Mua!” (Taha 42)

31- Mirësia e Musait ndaj vëllaut të tij Harunit, sepse i kërkoi Allahut që edhe ai të ishte Profet bashkë me të dhe i kërkoi bashkëpunim dhe ndihmë në gjëra të mira duke thënë: **“Më jep një ndihmës nga familja ime, Harunin, vëllain tim! Ma rrit fuqinë nëpërmjet atij dhe bëma ortak në punën time.”**

(Taha 29-32)

32- Oratoria dhe elokuenca janë mjete që ndihmojnë në mesimdhënie dhe në plotësimin e thirrjes (davetit) Për këtë arsye, Musai i kërkoi Zotit që t’ja zgjidhte nyjen e gjuhës me qëllim që njerëzit ta kuptonin fjalën e tij. Thuthuqësia nuk ka ndonjë problem përderisa fjalët kuptohen. Dhe prej sjelljes së edukuar të Musait me Zotin e tij është se ai nuk i kërkoi Zotit që t’ja largonte këtë mangësi plotësisht, por i kërkoi që të largonte atë që pengon arritjen e qëllimit (kuptimin e fjalëve)

33- Gjatë bisedave me mbretërit apo udhëheqësit kërkohet që gjatë këshillës apo ftesës të përdoret butësia dhe fjalët e mira të cilat synojnë kuptimin, pa krijuar pengesa dhe pa vrazhdësi. Në fakt butësia kërkohet në çdo rast, por kur flasim për rastin në fjalë ajo kërkohet më shumë, sepse vetëm përmes kësaj metode arrihet synimi i cili qartësohet në fjalën e Allahut: **“Flitini atij me fjalë të buta, se ndoshta kujtohet²⁸ a frikësohet!”** (Taha 44)

34- Ai që jeton me bindje ndaj Allahut, kërkon ndihmë vetëm nga Ai, është i sigurtë në premtimin e Zotit dhe plot shpresë në shpërblimin e Tij, Allahu do të jetë me të dhe atë njeri që e përkrah Zoti, për të nuk ka frikë. Këtë e themi duke u bazuar në fjalën e Allahut që i tha Musait: **“Mos kini frikë”** pastaj e sqaroi duke thënë: **“Unë jam me ju dëgjoj dhe shikoj.”** (Taha 46) Gjithashtu kur flet për Muhamedin (alejhi selam) thotë: **“E ai i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): “Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!”.**” (Teube 40)

35- Shkaqet e dënimit të një populli përqendrohente këto dy tipare: **“Vërtet, neve na është shpallur se dënimi do të godasë këdo, që (i) mohon (shenjat e Allahut) dhe (ii) u kthen shpinën (të dërguarve të Tij)”.** (Taha 48)

D.m.th mohon atë që vjen nga Allahu dhe i dërguari i Tij dhe i kthen shpinën bindjes ndaj Allahut dhe bindjes ndaj të dërguarit të Tij. E ngjashme me këtë është fjala e Allahut: **“Prandaj Unë ju kam tërhequr vërrejtjen me një zjarr që flakëron, ku do të hidhet vetëm më i keqi, që ka mohuar dhe është larguar nga besimi.”** (Lejl 14-16)

²⁸ “ndoshta kujtohet”: pra, ndoshta i kujtohet monoteizmi që kishte predikuar Jusufi (a.s.) në Egjipt, shumë kohë para Musait (a.s.).

36- Fjala e Allahut kur thotë: **“Vërtet, Unë jam Falës i Madh për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”** (Taha 82)

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar ka përmbledhur shkaqet me të cilat arrihet mëshira e Tij:

E para: Pendimi, që aludon në largimin prej gjërave që Allahu i urren, qofshin të dukshme apo të fshehta dhe kalimi tek ato vepra që Ai i do, të dukshme apo të fshehta qofshin ato. Ky lloj pendimi arrin t'i shlyejë të gjitha mëkatet e mëparshme, të vogla apo të mëdha qofshin ato.

E dyta: Imani (besimi) që nënkupton pranimin dhe vërtetimin e sigurtë e të përgjithshëm të çdo gjëje për të cilën Allahu ose i dërguari i Tij na kanë njoftuar dhe që ka të bëjë me pjesën e brendshme, pra me zemrën, e që më pas ndiqet me veprat e gjymtyrëve. S'ka dyshim se imani që gjendet në zemër e që ka të bëjë me besimin në Allahun, librat, të dërguarit, Ditën e Fundit për të cilën s'ka dyshim, ky besim është baza e adhurimeve, është parimi më madhor dhe më themelor. S'ka dyshim se në varësi të forcës së këtij imani njeriu i përzë të këqiat nga vetja, largon atë që akoma s'ka ndodhur dhe e pengon veten të jetë pjesë e saj. Kurse atë që ndodh, e largon duke vënë në praktikë të kundërtën e saj si dhe duke mos e lejuar zemrën të këmbëngulë në atë veprim, sepse besimtari nuk lejon që imani dhe drita që ka në zemër të bashkëjetojnë me mëkatet.

E treta: Veprat e mira. Këtu përfshihen veprat e zemrës, punët e gjymtyrëve dhe fjalët e gjuhës, sepse është e vërtetë që veprat e mira i largojnë të këqiat.

E katërta: Vazhdimësia në iman dhe udhëzim dhe shtimi i të dyjave. Ai që i plotëson këto katër shkaqe që u përmendën më lart, le të përgëzohet me mëshirë të plotë nga Allahu i Lartësuar.

Edhe ajeti vjen me cilësim hiperbolik kur thotë: **“Vërtet, Unë jam Falës i Madh për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”** (Taha 82)

Le të mjaftohemi me këto që u përmendën, paçka se në historinë e këtij Pejgamberi (Musait) gjenden shumë e shumë mësimë dhe dobi të tjera.



HISTORIA E HIDRIT ME MUSAIN

(alejhi selam)

Kjo ngjarje nis kështu: Një ditë Musai u ngrit në mesin e beni Israilëve dhe u mësoi njohuri të shumta. Njerëzit e pëlqyen këtë dhe u mahnitën me dijen e plotë të Musait.

Një i pranishëm i tha: “O profet i Allahut, a ka mbi këtë tokë njeri më të ditur se ti?” Ai tha: “Jo!”

Ai u përgjigj në bazë të asaj që dinte si dhe për t’i nxitur (Beni Israilët) që të përfitonin prej tij. Por Allahu e njoftoi për një rob i cili jetonte në vendin ku bashkohen dy detet dhe që mban njohuri të cilat nuk gjenden tek Musai dhe inspirime që nuk duken të zakonshme.

Musait i lindi dëshira e zjarrtë për ta takuar me qëllim që të shtonte dijen e tij dhe i kërkoi Allahut që ta lejonte për këtë. Allahu i tregoi për vendin ku mund ta takonte, kështu që Musai bashkë me djaloshin përgatitën një peshk si ushqim dhe Zoti ju tha: “Aty ku të humbësh gjurmët e peshkut, ai është vendi ku do ta gjesh këtë njeri të ditur (Hidrin).”

Ai shkoi dhe e gjeti atë dhe pastaj ndodhi ajo për të cilën Allahu na ka treguar në suren El Kehf:

“(Kujto) kur Musai i tha djaloshit që e shoqëronte: ‘Nuk do të pushoj së ecuri, derisa të arrij në vendin ku takohen dy detet, edhe nëse do të më duhet të udhëtoj për shumë kohë.’ Dhe, kur arritën në vendin, ku bashkoheshin dy detet, ata e harruan peshkun e tyre dhe ai rrëshqiti në det, duke e hapur atë si tunel. Kur kaluan më tej, Musai i tha shoqëruesit të vet: ‘Na jep drekën tonë, sepse jemi lodhur nga udhëtimi ynë’.

Ai u përgjigj: ‘Shiko! Kur ndaluan tek ai shkëmbi, unë e harrova peshkun. Vetëm djalli më bëri ta harroj e nuk ta thashë se peshku mori rrugën nëpër det në mënyrë të habitshme!’

(Musai) tha: ‘Kjo është ajo që po kërkojmë’. Andaj u kthyen nëpër gjurmët e veta, dhe gjetën një prej robërve Tanë,²⁹ të cilit i patëm dhuruar mëshirë prej Nesh dhe i kishim mësuar nga ana Jonë dije.

Musai i tha atij: ‘A mund të të shoqëroj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?’ Ai u përgjigj: ‘Ti nuk mund të durosh dot me mua! E si mund të durosh (pa pyetur) para diçkaje për të cilën nuk di asgjë?’

(Musai) tha: ‘Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të të kundërshtoj për asgjë.’ (Hidri) i tha: ‘Nëse vjen pas meje, mos më pyet për asgjë, derisa të ta shpjegoj unë!’ Dhe kështu, u nisën. Kur hipën në një anije, ai (Hidri) hapi një vrimë poshtë. (Musai) tha: ‘Mos vallë, e

²⁹ Sipas transmetimeve të vërteta nga Profeti Muhamed (a.s.), njeriu për të cilin bën fjalë ky varg, quhej Hidër.

hape vrimën për t'i mbytur udhëtarët e saj? Me të vërtetë, ke bërë punë të shumë të keqe'.

(Hidri) i tha: 'A nuk të thashë se ti nuk mund të durosh me mua?' Ai u përgjigj: "Mos më qorto për atë që harrova dhe mos më ngarko me vështirësi në punët e mia!" Dhe që të dy vazhduan të ecin, derisa takuan një djalosh, të cilin ai (Hidri) e vrau. (Musai) tha: 'Përse vrave një njeri të pafajshëm që nuk ka vrarë askënd?! Vërtet që ke bërë një punë të tmerrshme'!

Ai u përgjigj: 'A nuk të thashë se ti nuk mund të durosh me mua?' (Musai) tha: 'Nëse pas kësaj do të të pyes sërish për çfarëdo gjëje, atëherë mos më mbaj më në shoqërinë tënde! Tashmë ke arsye (të mjaftueshme) nga ana ime (për t'u ndarë prej meje)!'

Dhe që të dy vazhduan të ecin, derisa arritën në një fshat dhe u kërkuan banorëve të tij, që t'u jepnin për të ngrënë, por ata nuk i pranuan mysafirë. Aty ndeshën një mur që ishte duke u rrëzuar dhe ai (Hidri) e drejtoi. (Musai) tha: 'Sikur të kishe dashur ti, mund të kërkoje shpërblim për këtë.'

Ai tha: 'Kjo është ndarja ndërmjet meje dhe teje. Unë do t'i shpjegoj ty ato gjëra për të cilat nuk mund të durosh. Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e disa të varfërve, që punonin në det. Unë desha ta dëmtoj, sepse prapa tyre gjendej një mbret, i cili merrte me dhunë çdo anije të mirë.

Sa për djaloshin, prindërit e tij ishin besimtarë. Ne e dinim se (dashuria për të) do t'i çonte ata në të keqe dhe mohim, dhe dëshiruam që Zoti i tyre, në vend të atij t'u jepte një më të mirë, më të pastër dhe më të mëshirshëm.

E, sa i përket murit, ai u takonte dy djelmoshave jetimë në qytet dhe, nën të gjendej një thesar i tyre. Babai i tyre kishte qenë njeri i mirë, prandaj Zoti yt dëshiroi që ata të arrinin moshën e pjekurisë e ta nxirrnin thesarin e tyre, si mëshirë nga Zoti yt. Unë këtë nuk e kam bërë sipas gjykimit tim. Ky është shpjegimi i asaj, për të cilën ti s'munde të duroje!” (Kehf, 60-82)

Dobitë mësimet dhe dispozitat që përfitohen nga kjo ngjarje!

1- Mësojmë vlerën e dijes dhe pozitën e lartë të saj si dhe pëlqyeshmërinë e udhëtimit për nxënien e saj dhe se dija është gjëja më e rëndësishme. Ja tek ishte Musai që udhëtoi për të kërkuar dije në distanca shumë të gjata dhe u përball me lodhje dhe mundime. Ai e braktisi qëndrimin tek Beni Israilët të cilët i mësonte dhe i orientonte dhe zgjodhi udhëtimin për të nxënë dije.

2- Në dije duhet filluar me gjërat më të rëndësishme, e kështu me radhë. Shtimi i dijes personale, është më i rëndësishëm se sa të preokupohesh vetëm me mësimin e të tjerëve. Kështu që mëson për veten, me qëllim që t'i mësosh edhe të tjerët.

3- Lejohet të mbash një shoqërues (shërbëtor) gjatë udhëtimit apo edhe jo udhëtimit. Me qëllim që të të shërbejë dhe të çlodhesh, siç veproi Musai (alejhi selam).

4- Ai që udhëton për të këkuar dije apo për të luftuar, etj., udhëtimi i tij konsiderohet udhëtim në bindje ndaj Zotit dhe këtu përfshihen edhe udhëtime të tjera.

Nëse e kërkon nevoja që të tregojë synimin e udhëtimit dhe se ku do të shkojë, kjo është më e mirë se ta mbajë fshehur. Shfaqja e synimit ka dobinë e mirëpërgatitjes dhe marrjes së gjërave me njohuri të plotë dhe nxit për këtë adhurim të lartë,

sepse Musai tha: **“Nuk do të pushoj së ecuri, derisa të arrij në vendin ku takohen dy detet, edhe nëse do të më duhet të udhëtoj për shumë kohë.”** (Kehf 60)

Profeti ynë (alejhi salam) kur deshi të shkonte në Tebuk i lajmëroi njerëzit për synimin e tij edhe pse në shumciën e rasteve kur donte të ndërmernte një ekspeditë e fshihte qëllimin e tij dhe tregonte ose nxirrte ndonjë gjë tjetër,³⁰ duke parë dobinë në të dyja rastet.

5- E keqja dhe shakqet e saj po ashtu edhe mangësitë, duhet t'i dedikohen shejtanit. Këtë e themi duke u bazuar tek fjala e Muasait që i tha djaloshit për arsyen e harresës: **“Vetëm djalli më bëri ta harroj.”**

6- Lejohet që njeriu të njoftojë (kallzojë) për atë që ndien e që ka të bëjë me gjëra të natyrshme siç është lodhja, etja, uria etj, me kusht që kjo të mos bëhet në formë pakënaqësie (ndaj kaderit) dhe të jetë kallzim real. E themi këtë duke u bazuar në fjalën e tij **“Na jep drekën tonë, sepse jemi lodhur nga udhëtimi ynë”**.

7- Njeriu duhet të mbajë pas vetes shërbyes të zgjuar dhe të mprehtë, me qëllim që t'i arrijë çështjet që ai synon.

Gjithashtu është e pëlqyeshme që zotëria ta ushqejë shërbëtorin e tij nga ushqimi që ha vetë dhe të ulen e të ushqehen bashkë në një vend. Sepse Musai i tha: **“Na jep drekën tonë”** D.m.th ai ishte ushqimi i të dyve.

8- Ndihma ndaj robit zbret në varësi të zbatimit që ai i bën urdhërave legislative dhe se ai që është konform kënaqësisë së Allahut, ndihmohet dhe përkrahet më shumë se ç'mund

³⁰ E përcjell Buhariu me nr. 2948 nga Keab bin Maliku (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

të ndihmohet dikush tjetër. Kjo bazuar në fjalën e tij: **“Sepse jemi lodhur nga udhëtimi ynë”**. Ka për qëllim udhëtimin që e kishte tejkaluar bashkimin e dy deteve, sepse tek udhëtimi i parë Musai nuk u ankua edhe pse ishte i gjatë.

9- Personi të cilin takoi Musai nuk ishte profet, jo, ai ishte rob i devotshëm dhe dijetar i inspiruar. Kjo për faktin se Allahu e përmend me cilësinë e dijes dhe se ai ishte rob i bindur ndaj Zotit si dhe njeri me sjellje të larta. Pra nuk përmendet se ai ishte profet apo i dërguar.

Ndërsa fjala e tij në fund të ndodhisë: **Unë këtë nuk e kam bërë sipas gjykimit tim**. Nuk pohon se ai ishte profet, por tregon dhe argumenton se ai ishte i frymëzuar dhe kjo u ndodh edhe të tjerëve që nuk gëzojnë gradën e profetësisë. Allahu thotë: **“Zoti yt e frymëzoi bletën.”** (Nahl 68) Po ashtu thotë: **“Kështu, Ne e frymëzuam nënën e Musait.”** (Kasas, 7)

10- Dija të cilën Allahu ia mëson robit është dy llojesh:

1- Dije e përfituar, pra që rob i arrin duke e kërkuar atë.

2- Dije hyjnore të cilën Allahu ia dhuron si mirësi kujt të dojë. E themi këtë duke u bazuar në fjalën e tij: **“Dhe e mësuar atë më dije prej nesh.”**

Hidrit iu dha prej kësaj dije (dijes hyjnore) një hise shumë e madhe!

11- Mësojmë se si duhet të jetë mirësjellja me mësuesin dhe butësia në bashkëbisedimin me të, siç u shpreh Musai (alejhi selam): **“A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?”** (Kehf, 66)

Ai i nxori fjalët me shumë mirësjellje duke kërkuar mendimin e tij, pra a më lejon apo jo? Duke shfaqur njëkohësisht nevojën dhe dëshirën e tij për të mësuar duke i dhënë të kuptojë se

ishte i etur për atë dije që ai mbante. Ndryshe nga ç'ndodh me mendjemëdhenjtë dhe të varzhdët të cilët nuk shfaqin interesim për dijen apo për mësuesin. S'ka gjë më të dobishme për nxënësin se të shfaqë interesimin e tij për dijen e mësuesit dhe ta falënderojë për mësidhënien e tij.

12- Mësojmë modestinë që duhet të tregojë njeriu i mirë ndaj përfitimit të dijes qoftë dhe nga ai që mund të jetë më me pak vlera, sepse Musai pa asnjë dyshim ishte më i mirë se Hidri.

13- Mundësinë e përfitimit të dietarit ndaj asaj njohurie në të cilën ai nuk shquhet duke e marrë atë nga ai që shquhet në atë dije, edhe nëse ka diferencë të madhe në njohuritë e tyre.

Musai është peygamber i madh dhe përfshihet tek “Ulu el-Azmi” d.m.th peygamberëve të cilëve Allahu u dha dhe u mundësoi njohuri të cilat nuk i kanë të tjerët. E megjithatë në këto njohuri të veçanta, Hidri kishte njohuri të cilat nuk i kishte Musai, prandaj dhe ai tregoi shumë interes që të mësonte prej tij.

14- Dija dhe mirësitë e tjera, duhet t'i dedikohen mirësisë dhe mëshirës së Allahut, pra të jesh i vetëdijshëm dhe të falënderosh Allahun për këtë. Siç thoshte Musai: **“Që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty.”** (Kehf, 66)

15- Dije e dobishme është ajo që të udhëzon drejt të mirës. Çdo dije që përmban udhëzim dhe orientim drejt rrugës së mirësisë dhe të largon nga rruga e keqe apo nga shkaqet që shpien drejt saj, e gjithë kjo konsiderohet dije e dobishme. Njohuritë e tjera ose janë të dëmshme ose të padobishme, siç thuhet në ajet: **“Që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty.”** (Kehf, 66)

16- Ai që nuk ka durim në shoqërimin e dietarit, apo forcë për të qëndruar në rrugën e nxënies së dijes, ai konsiderohet i mangët dhe nuk meriton të jetë nga ata që nxënë dije. Ai që nuk duron, nuk merr dije. Ndërsa ai që tregon durim dhe bashkëjeton me të, arrin dijen dhe çdo gjë që synon. Hidri i kërkoi ndjesë Musait (nga shoqërimi me të) sepse nuk pati durim ndaj dijes së veçantë që ai posedonte.

17- Ajo që e ndihmon njeriun për të qenë i durueshëm, është kur ai posedon njohuri të plota për dobietë, frytet dhe përfundimin e gjërave që ai synon. Ai që nuk ka njohuri ndaj këtyre gjërave edhe durimi bëhet shumë i vështirë për të. Kjo duke u bazuar në fjalën e tij: **“E si mund të durosh (pa pyetur) para diçkaje për të cilën nuk di asgjë”?** (Kehf, 68)

18- Ne jemi urdhëruar që të mos nxitojmë pa i vërtetuar gjërat, e as të japim gjykime të parakohëshme. Kjo nuk duhet të ndodhë derisa të mësohet qëllimi dhe se çfarë kërkohet prej asaj që është duke ndodhur.

19- Mësojmë lejueshmërinë e lidhjes së gjërave (që kanë për të ndodhur) me vullnetin e Allahut. Kjo bazuar në falën e tij: **(Musai) tha: “Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të të kundërshtoj për asgjë.”** (Kehf, 69)

Dhe se synimi për të bërë diçka nuk është i njëjtë me veprimin e asaj gjëje. Musia synoi durimin por nuk ia arriti!

20- Mësuesi, nëse e sheh të udhës dhe të dobishme që t'i flasë nxënësit që të mos nxitojë në bërjen e pyetjeve derisa të jetë vetë ai (mësuesi) që t'ia bëjë me dije ato, në këtë rast dobia merret parasysht. Apo edhe në rastin kur perceptimi i nxënësit nuk arrin t'i kapë disa gjëra, apo kur e ndalon të kërkojë detajizime apo pyetje që nuk kanë të bëjnë me temën.

21- Lejimi i udhëtimit në det nëse kjo nuk përbën ndonjë rrezik.

22- Ai që harron nuk ngarkohet me faj, qoftë në hakun e Zotit apo në hakun e njerëzve, me përjashtim të rastit kur kjo (harresë) shkatërron pasurinë e dikujt, në këtë rast ai është garant edhe nëse ka harruar. Në ajet thuhet: **“Mos më qorto për atë që harrova.”** (Kehf, 73)

23- Njeriu duhet që në marrëdhëniet e tij me të tjerët të jetë i pajisur me moralin e faljes dhe atë që ata i lejojnë. Nuk duhet t'i ngarkojë të tjerët përtej mundësive që kanë, apo tu krijojë vështirësi duke i lodhur, sepse kjo nxit largim dhe ftohje. Përkundrazi le të marrë më të lehtë me qëllim që gjërat t'i lehtësohen.

24- Çështjet vlerësohen nga aparencia e jashtme dhe aty lidhen e ndërtohen dispozitat e kësaj bote në çdo gjë që ndodh. Musai (alejhi selam) nuk ia pranoi Hidrit prishjen e anijes dhe vrasjen e fëmijës, nisur nga dispozitat e përgjithshme dhe nuk iu kthye paktit që kishte bërë bashkë me Hidrin në fillim të takimit, që të mos e pyeste dhe të mos e kundërshtonte derisa Hidri të ishte ai që do ta sqaronte.

25- Mësojmë rregullin e njohur dhe të madh që thotë: E keqja e madhe largohet duke vepruar një të keqe më të vogël dhe më të lehtë dhe i jepet përparësi interesit më të madh dhe humbjes më të vogël.

Vrasja e djaloshit të vogël s'ka dyshim se ishte e keqe, por qëndrimi i tij derisa të rritej dhe të sprovonte prindërit në fenë e tyre ishte e keqe më e madhe, edhe pse në dukje ishte gjë shumë e keqe. Interesi i madh ishte tek qëndrimi i prindërve të tij në fe, prandaj Hidri e vrau pasi Allahu e kishte frymëzuar

me të vërtetën. Ajo që i erdhi fshehurazi ishte e njëjtë me atë që dukej qartë.

26- Mësojmë një rregull tjetër të madh ku thuhet: Përdorimi i pasurisë së tjetrit kur ka dobi dhe largohet dëmi lejohet edhe pa kërkuar leje. Edhe nëse mund të shkaktojë prishje të një pjese pasurie. Siç ndodhi me Hidrin i cili prishi anijen që të bëhej e mangët dhe të shpëtonte nga plaçkitja e mbretit zullumqar dhe nën këto dy rregulla gjenden dobi të panumërta.

27- Lejohet të punosh në det ashtu sikurse lejohet të punosh në tokë. Në ajet thuhet: **“Që punonin në det. (Kehf, 79)**

28- Vrasja është prej mëkateve më të mëdha.

29- Allahu e mbron robin e devotshëm, pasardhësit dhe pasurinë e tij dhe çdo gjë që ka të bëjë me të. Bazuar në fjalën e Allahut: **“Babai i tyre ka qenë njeri i mirë.” (Kehf, 82)**

T'u shërbesh njerëzve të mirë dhe të punosh për të mirën e tyre, është më e dobishme se të punosh për dikë tjetër, sepse ai (Hidri) e arsyetoi veprimin e ngritjes së murit duke thënë: **Babai i tyre ka qenë njeri i mirë.”**

30- Duhet treguar moral dhe etikë me Allahun edhe në shprehi, sepse Hidri prishjen e anijes ia dedikoi vetes duke thënë: **Unë desha ta dëmtoj (Kehf 79)** Ndërsa të mirën ia dedikoi Allahut kur tha: **“Zoti yt dëshiroi që ata të arrinin moshën e pjekurisë e ta nxirrnin thesarin e tyre, si mëshirë nga Zoti yt.” (Kehf, 82)**

Po ashtu Ibrahim (alejhi selam) thoshte: **“Dhe kur unë sëmurem, Ai më shëron.” (Shurara, 80)**

Ndërsa xhindët thanë: **“Ne nuk e dimë nëse (me këto roja të qiellit) është synuar e keqja (zbritja e dënimit) për ata**

që janë në Tokë apo Zoti i tyre kërkon t'i udhëzojë në rrugë të drejtë?!” (Xhin, 10)

Edhe pse të gjitha këto janë me caktimin e Allahu të Lartësuar.

31- Njeriu nuk duhet të ndahet nga shoku i tij dhe ta lërë shoqërimin me të, përkundrazi duhet të qëndrojë besnik derisa durimi nuk sosit. Të aprovosh fjalët apo mendimet që thotë shoku në gjëra që nuk janë të ndaluara, thjeshtë për të ruajtur shoqërinë, kjo është një arsye më shumë për jetëgjatësinë dhe forcimin e shoqërisë, ashtu sikundër mospërputhja me të, sjell si pasojë shkëputjen e shoqërisë me të.



HISTORIA E JUNUSIT

(alejhi selam)

Junusi (alejhi selam) shihet si një nga Pejgamberët më të mëdhenj të Beni Israilëve, të cilin Allahu e dërgoi tek banorët e Ninevesë në zonën e Mosulit.

Ai i ftoi njerëzit për tek Allahu por ata e refuzuan. Ai e vazhdoi thirrjen e tij por ata përsëri e refuzuan. Junusi i kërcënoi duke u përkujtuar ndëshkimin e Zotit dhe u largua prej tyre pa treguar durimin që duhej të kishte. Pra ajo që ndodhi ishte se ai u arratis i zemëruar prej tyre.

Kur u largua, në zemrat e njerëzve të popullit të tij lindi dëshira për t'u penduar dhe për t'u kthyer, sepse e kishin parë afrimin e dënimit dhe Allahu ua largoi atë.

Me sa duket, Junusi ishte njoftuar se dënimi i Zotit ishte larguar prej tyre dhe përsëri kishte ngulur këmbë që të largohej prej tyre. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë: “**Kur iku i zemëruar.**” (Enbija 87)

Gjithashtu thotë: “**Ai nxitoi drejt një anijeje të mbushur plot e përplot.**” (Saffatë 140)

Ai hipi në një anije të mbushur plot e përplot me njerëz dhe mallra dhe kur arritën në mes të detit anija gati sa nuk u mbyt dhe çështja mbeti: ose të qëndrojnë të gjithë bashkë mbi anije dhe të mbyten, ose të hidhnin disa prej tyre me qëllim që të zbrazej anija dhe të shpëtonin të tjerët. Ata zgjodhën opsionin e fundit dhe për të qenë të drejtë dhe të suksesshëm hodhën short dhe shorti u ra disa njerëzve ku mes tyre ishte edhe Junusi (alejhi selam) **“Dhe hodhi short (me detarët se kush duhej të hidhej)”³¹ dhe humbi.”** (Saffatë 141)

Pra humbi shortin dhe ata e hodhën në det dhe aty e gëlltiti balena e cila nuk i theu asnjë kockë të trupit e as nuk ja dëmtoi mishin.

Kur qe në barkun e balenës në ato errësirat e detit, Junusi thirri duke thënë: **“S’ka të adhurar tjetër me meritë, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”** (Enbija 87)

Allahu e urdhëroi balenën që ta hidhte Junusin në një breg të shkretë. Ai doli nga barku i balenës si një zog që dilte nga veza, në kulmin e dobësisë dhe këputjes, por Allahu e mëshiroi dhe i nxori një bimë kungulli e cila i bëri hije derisa u frocua dhe u çua në këmbë.

Pas kësaj Allahu e urdhëroi që të kthehej tek populli i tij për t’i mësuar e për t’i ftuar në besim. Kështu ata iu përgjigjën thirrjes së tij dhe numri i atyre që besuan arriti nënjëqind mijë apo edhe më tepër, të cilët Zoti i la deri në një afat të caktuar.

³¹ Sipas komentuesve të Kur’anit (konkretisht Ibn Kethirit), për shkak të ngarkesës së madhe, anija ishte gati të mbytej, prandaj detarët ranë dakord ta bëjnë me short se kush do të hidhej nga anija, në mënyrë që pesha e saj të lehtësohej e të shpëtonin nga mbytja.

Dobi dhe mësim

1- Në këtë ndodhi mësojmë qortimin që Allahu i bëri Junusit (alejhi selam) dhe burgosjen e tij në barkun e balenës, që të ishte shlyerje (për gabimin) dhe argument i madh (mrekulli) për Junusin (alejhi selam) Ishte mirësia e Zotit që atij t'i përgjigjeshin kaq shumë njerëz nga populli i tij, sepse numri i madh i ndjekësve është tregues i vlerës që kanë pejgamberët.

2- Lejimin e përdorimit të shortit në çështje jo të qarta apo në gjëra që kanë të bëjnë me meritën apo privimin prej diçkaje përdërisa nuk është e mundur të veprohet diçka tjetër. Praktika e njerëzve që kishin hipur në anije na sjell ndërmend rregullin e njohur që të ndërmiret dëmi më i vogël për të larguar një dëm më të madh. S'ka dyshim se hedhja e disave në det edhe pse në vetvete kishte dëm, ishte shumë më e lehtë se të mbyteshin të gjithë.

3- Robi nëse ka fillim të mirë me Zotin e tij dhe i njeh mirësitë e Zotit në kohë paqeje dhe bollëku, Allahu do t'ia kthejë dhe do ta njohë atë në kohë të vështira duke ia larguar të gjithën (hallin, vështirësinë) ose duke ia lehtësuar atë.³² Prandaj në historinë e Junusit tha: **“Dhe, po të mos ishte nga ata që i luten Allahut, me siguri do të mbetej në barkun e saj deri në Ditën e Ringjalljes.”** (Saffatë 143-144)

³² Imam er-Razi ka thënë: Junusi pasi që e kishte njohur dhe pohuar këtë fjalë, kjo e parapriu dhe ndihmën që Allahu i dha atij për shkak të këtij pranimi. Ndërsa Faraonit iu mohua sepse që në fillim ai kishte ftuar në hyjnizimin e vetes duke thënë: **“Dhe i tuboi njerëzit e u deklaroi: “Unë jam zoti juaj më i lartë!” (Naziat 23-24)** Ndërsa Junusi fton tek Allahu i Lartësuar. Në Kur'an thuhet: **“Kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar (në barkun e balenës)! Gjithashtu tha: “Dhe, po të mos ishte nga ata që i luten Allahut.”** Kjo të tregon qartë se ai që e ruan Allahun kur është vetëm, Allahu do ta ruajë atë kur të jetë në mes të shkretëtirës. (Sherh Esmail Husna fq 157)

4- Fjala e Profetit (alejhi selam) kur thotë: Lutja e vëllait tim Dhen Nunit, për këdo që është në hall dhe lutet me këtë lutje, Allahu ka për t'ia larguar brengën: **“S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”** (Enbija 87)³³

5- Imani e shpëton njeriun nga tmerret dhe vështirësitë. Kjo bazuar në fjalën e Allahut që thotë: **“Kështu ne i shpëtojmë besimtarët.”** (Enbija 88)

D.m.th i shpëtojmë kur janë në vështirësi, për shkak të imanit që ata kanë!

³³ E përcjell Ahmedi 1/170, Tirmidhiu me nr 3505, Hakimi 1/505 duke e saktësuar atë dhe këtë e miratoi edhe Dhehebiu nga Sead bin Ebi Uekasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) Albani në studimin e haditheve të fjalës së bukur fq. 122 ka thënë: “Hadithi është i shkallës që e kanë pohuar Hakimi dhe Dhehebiu.”



HISTORIA E DAUDIT DHE SULEJMANIT

(alejhima selam)

Këta dy pejgamberë ishin nga më të shquarit e Beni Israilëve, tek këta të dy, Zoti i Lartësuar bashkoi Profetësinë dhe pushtetin e madh e të fortë.

Sa i përket Daudit (alejhi selam) ai ishte pjesë e ushtarëve që luftuan krah për krah me Talutin, të cilin njëri nga profetët e beni Israilëve e zgjodhi të ishte mbreti i tyre, për shkak të trimërisë, forcës dhe zgjuarsisë që Taluti kishte në udhëheqje dhe në sistemimin e ushtrisë, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe me fuqi trupore.”**

(El Bekare 247)

Kur u përballën me Xhalutin dhe ushtrinë e tij ndërkohë që ushtarët e Talutit treguan durim dhe i kërkuan ndihmë Zotit, në ato çaste të vështira Daudi u dallua nga të tjerët për trimërinë e tij të madhe, sepse mori përsipër të vriste mbretin e armiqve Xhalutin dhe kështu të binte disfata në pjesën tjetër të ushtrisë. Kësisoj Allahu i ndihmoi Beni Israilët dhe u dhuroi një fitore të madhe.

Allahu i dërgoi shpalljen Daudit dhe i dha urtësi e pushtet shumë të fortë, siç tregon në Kur'anin fisnik: **“Ne ia forcua mbretërinë dhe i dhamë mençuri e dijeni për të gjykuar.”**

(Sad 20)

Allahu i dha qëndrueshmëri në adhurim dhe largpamësi.

Ai e cilësoi Daudin me dy tipare që në fakt ato e plotësojnë robin. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ti duroje atë që thonë ata dhe kujtoje robin Tonë të fuqishëm, Daudin, që përherë i drejtohej Zotit.”** (Sad 17)

Allahu e cilësoi me tiparin e forcës së madhe në çështjen e urdhërave të Zotit dhe me tiparin e pendimit dhe kthimit tek Allahu për arsye të dijes dhe njohjes që ai kishte ndaj Zotit të Lartësuar.

Allahu ia nënshtroi shpendët dhe malet, që e madhëronin Allahun bashkë me të. Atij i dhuroi një zë shumë të bukur, mirësi të cilën nuk ia kishte dhënë askujt tjetër.

Ai flinte gjysmën e natës dhe falej një të tretën dhe flinte një të gjashtën. Ai agjëronte një ditë dhe hante ditën tjetër.³⁴

Kur takohej me armikun njerëzit shihnin tek ai trimëri që i mahniste. Allahu ia kishte zbutur hekurin dhe përpunimin e tij dhe e mësoi se si t'i punonte mburojat mbrojtëse në luftë.

Ai ishte i pari që prodhoi mburojat trupore të luftës që ishin edhe të lehta për t'u mbajtur në trup.

Allahu e qortoi atë për shkak të një mëkati që ai veproi³⁵.

³⁴ Buhariu me nr 1131, Muslimi me nr. 1159, 189 nga hadithi i Abdullah bin Amër bin Asit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

³⁵ Ibn Kethiri (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: Shumë komentatorë të Kur'anit nga selefët dhe ata që erdhën më vonë kanë përmendur në këtë rast disa histori e disa ndodhi që shumica janë prej Israilijateve ku disa prej

Tek Daudi Ai dërgoi dy engjëj në formë njeriu e që ishin në konflikt me njëri-tjetrin.³⁶ Ata u futën tek vendi ku Daudi po

tyre janë ngjarje totalisht të shpikura. Ne nuk i kemi përmendur qëllimisht tek libri ynë duke u mjaftuar dhe duke i rënë shkurt vetëm leximit të ndodhisë nga Kur'ani fisnik, ndërkohë që Allahu udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë. (El Bidaje uen Nihaje 2/13)

³⁶ Dijetari i madh el-Kasimi në librin “Mehasin et teuilj” (14/156-158) përcjell nga Ibn Hazmi kundërpërgjigjen e tij ndaj atyre që e akuzojnë Profetin e Allahut Daudin me këtë ligësi dhe shpifje duke thënë: Ajo që Allahu përmendi për Profetin Daud (alejhi selam) është fjalë e vërtetë dhe e saktë dhe nuk pohon aspak fjalën e atyre që tallen e gënjejnë dhe që janë të lidhur pas legjendave dhe miteve që i shpikën hebretë. Ai që erdhi për tu ankuar ishte popull prej bijve të Ademit pa asnjë dyshim, dhe po kundërshtoheshin për një dele, ku njëri kishte kaluar cakun ndaj tjetrit sipas asaj që përmendet në ajet. Ai që thotë se ata ishin engjëj që kundërshtoheshin për punë grash, ai në fakt gënjen ndaj Allahut të Lartësuar duke i mveshur diçka që nuk e ka thënë si dhe duke shtuar në Kur'an atë që nuk është prej tij dhe përgënjeshtëron Allahun e Lartësuar dhe pohon ndaj vetes ligësinë e madhe, sepse po përgënjeshtëron edhe engjëjt sepse Allahu i Lartësuar thotë: **“A e ke dëgjuar historinë e dy kundërshtarëve.”** Ndërsa këta thonë: Nuk ishin kundërshtarë kurrën e kurrës dhe as që i kanë bërë padrejtësi njëri-tjetrit dhe asnjëri prej tyre realisht nuk ka patur 99 dele dhe as tjetri nuk ka patur një dele dhe as që i ka thënë në realitet ma jep mua atë. Habitem se si e çojnë veten nga e kota? Allahu na ruajt nga turpi. Madje e gjithë kjo pa asnjë lloj argumenti, por vetëm me supozime boshe. Betohem në Zot se secili nga ne e ruan veten e tij që me komshiun të jetë i ruajtur, të ketë kujdes dhe të mos ndodhin gjëra të pahijshme, e jo më të nisë qëllimisht burrin e një gruaje për t'u vrrarë, me qëllim që ta marrë për vete atë grua, apo që ta lërë namazin për shkak të një zogu që e sheh. Këto janë veprimet e mendjelehtëve, keqbërësve dhe intrigantëve dhe jo veprime të njerëzve të mirë e të devotshëm. E si mund të thuhet të gjitha këto për profetin e Zotit, Daudin (alejhi selam) të cilit i la në dorëzim librin e Tij dhe i dha fjalët që t'i fliste dhe lexonte me gojë e tij? Allahu e ka ruajtur që këto gjëra t'i shkonin qoftë edhe në mendje e lëre më t'i vepronte. Ndërsa sa i përket istigfarit të tij dhe rënies në sexhde për të kërkuar mëshirën e Allahut, duhet të dimë se profetët (alejhim selam) janë njerëzit më primarë ndaj këtyre veprave fisnike. Istigfari është veprim i mirë që nuk refuzohet nga mbreti, profeti, mëkatari apo jo mëkatari.”

falej dhe ai u tremb prej tyre, sepse u futën në një kohë kur nuk futej njeri. Ata kapërcyen dhe hynë brenda në mihrab (vendin ku falej) dhe thanë: **“Mos u frikëso! Ne jemi dy kundërshtarë, njëri nga të cilët i ka bërë padrejtësi tjetrit, prandaj gjyko me drejtësi dhe mos u shmang (prej të vërtetës), por na udhëzo në rrugë të drejtë”**. (Sad 22)

Njëri prej tyre filloi të fliste dhe i tha: **“Ky është vëllai im. Ai ka nëntëdhjetë e nëntë dele.”**

Kishte për qëllim gratë.

“Kurse unë kam vetëm një dele, andaj më tha: “Ma jep mua atë!” - dhe më mundi me fjalë.”

D.m.th e folura e tij e mundi të folurën time dhe kështu doli superior ndaj meje.

Atëherë Daudi tha: **“Vërtet, ai të ka bërë padrejtësi që të ka kërkuar delen tënde të vetme, për ta bashkuar me delet e veta. Shumë bashkëpronarë i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira, por ata janë pak”**. (Sad 24)

Daudi e kuptoi se ai po synohej në këtë çështje prandaj erdhi në vete: **“Daudi e kuptoi, se në të vërtetë Ne e kishim vënë në provë atë, prandaj kërkoi falje nga Zoti i vet, ra në gjunjë dhe u përul, duke u penduar. Pastaj, Ne ia falëm këtë e ai te Ne do të jetë i afërt dhe do të ketë strehim të mirë (në jetën tjetër)”** (Sad 25)

Allahu ia shleu gabimin dhe pas pendimit ai arriti në një gjendje më të mirë se më parë. Me këtë ai arriti afrim të madh tek Zoti i tij dhe përfundimi i tij qe i mirë. Allahu i Lartësuar i tha: **“O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas**

**dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut!
Me të vërtetë, për ata që largohen nga rruga e Allahut, ka
dënim të ashpër, ngaqë e kanë harruar Ditën e Llogarisë.”**

(Sad 26)



HISTORIA E SULEJMANIT

(alejhi selam)

Biri i Daudit

Allahu i dhuroi Sulejmanit Profetësinë dhe prej babait (Daudit) ai trashëgoi dijen, profetësinë dhe pushtetin. Por Allahu i dha sundim shumë të madh, sundim dhe pushtet të cilin nuk e ka patur askush më herët e as që do ta ketë dikush në vazhdim.

Allahu i nënshtroi erën e cila frynte me urdhërin dhe orientimin e tij si të donte dhe ku të donte. Me anë të erës, udhëtimin e një muaji ai e bënte brenda një paraditeje ose një pasditeje.

Për të Allahu nënshtroi edhe xhindët, shejtanët dhe ifritët të cilët punonin dhe bënë punë madhështore si t'i donte ai. **“Ata punonin për atë çfarë të dëshironte: faltore dhe statuja, enë të gjera si puse dhe kazanë të mëdhenj të palëvizshëm.”**

(Sebe 13)

Shkonin e vinin me urdhërin e tij ku të donte ai dhe ndaj tij nënshtroi ushtritë e përbëra prej xhindeve, njerëzve dhe shpendëve, të gjithë të radhitur në çeta të gatshme, me një organizim dhe para të mahnitshme.

Allahu i mësoi gjuhën e shpendve dhe të gjitha kafshëve të tjera me të cilat fliste dhe ua kuptonte fjalët që thonin. Rasti konkret është biseda e tij me pupëzën që i solli lajme, po ashtu dëgjoi milingonën kur u foli milingonave të tjera, duke u thënë: **“O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, pa ju vënë re”!** (Neml 18)

Ajo u tërhoqi vëmendjen dhe i urdhëroi që të ruheshin nga ky rrezik dhe e justifikoi Sulejmanin dhe ushtrinë e tij,³⁷ për këtë arsye Sulemani vuri buzën në gaz nga fjalët e saj dhe tha: **“O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!”** (Neml 19)

Pjesë e rregullit të mirë që ai kishte vendosur dhe vendosmërisë që tregoi ishte edhe fakti se ai personalisht i kontrollonte ushtarët, paçka se kishte caktuar përgjegjës që mereshin me këtë punë. Fjalët e Sulejmanit kur thoshte: **“Të gjithë të radhitur në çeta të gatshme.”** është pohim i këtij fakti. Ai i kontrollonte edhe shpendët për t'i parë nëse qëndronin në pozicionet e tyre. Prandaj tha: **“Pse nuk e shoh pupëzën këtu, a nuk është e pranishme ajo?”** (Neml 20)

Dhe nuk është për qëllim ajo që pretendojnë shumë nga komentatorët e Kur'anit se ai e kërkoi pupëzën që të maste distancën se sa larg qëndronte uji, sepse kjo bie ndesh me

³⁷ Dijetari i madh Ibn Kajjim el-Xheuzije (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Milingona u shpreh në dhjetë mënyra komunikimi në këshillën që u dha milingonave të tjera: Ajo përdori pasthirmën, alarmoi, emërtoi, urdhëroi, ishte e drejtpërdrejtë, qortoi, përshtati, mësoi, përgjithësoi dhe justifikoi. “Miftah dar es-Seadeh” (2/151)

tekstin Kur'anor. Allahu i Lartësuar nuk tha: “Ai e kërkoi pupëzën” Por tha: **“Ai bëri kontrollin e shpendëve.”**

Pas kësaj ai (Sulejmani) e kërcënoi për shkak të kundërshtimit që i kishte bërë urdhrin të tij, e përderisa pushteti i tij ishte i ngritur mbi drejtësinë e plotë, ai bëri një përjashtim duke thënë: **“Nëse nuk do të më sjellë arsyetim bindës, do ta dënoj me dënim të rëndë ose do ta ther!”** Nuk vonoi shumë e ajo erdhi dhe tha: **“Kam marrë vesh diçka që ti nuk e ke ditur dhe të kam sjellë lajme të vërteta prej (qytetit të) Shebës. Kam parë një grua që sundonte popullin (e atij qyteti) Ajo zotëronte çdo gjë dhe kishte një fron madhështor. Kam parë se ajo dhe populli i saj adhuronin diellin e jo Allahun. Djalli ua paraqiste të bukura sjelljet e tyre, duke i larguar nga rruga e drejtë, prandaj nuk ishin të udhëzuar. Ata nuk i përulëshin në sexhde Allahut, i Cili nxjerr gjithçka që është e fshehur në qiej dhe në Tokë dhe di çfarë fshihni ju dhe çfarë tregoni haptazi. Allahu është Një, s’ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, Zotit të Arshit të madh!”** (Neml 21-26)

Në këtë periudhë kaq të shkurtër pupëza solli këto informacione të mëdha!

Ky shpend e njoftoi Sulejmanin për mbretërinë e atyre vendeve Jemenite dhe se ata i udhëhiqte një grua të cilës i ishte dhënë çdo gjë që i duhej një udhëheqësi dhe se ajo kishte një fron të madh. Përveç asaj që kuptoi nga pushteti dhe forca e këtij populli, pupëza arriti të kuptonte dhe besimin dhe fenë e tyre; se ata ishin idhujtarë që adhuronin diellin, duke e kriktikuar këtë në formën më të prerë. Ky është argument se edhe kafshët e njohin Zotin e tyre, e madhërojnë dhe e veçojnë Atë në adhurim. Ata i duan besimtarët dhe i urrejnë jobesimtarët përgënjeshtues. Sulejmani i tha: **“Do të shohim se a thua të vërtetën apo je duke gënjyer. Shko me këtë letër**

timen e çojua atyre. Pastaj largohu pak nga ata dhe shiko cila do të jetë përgjigjja e tyre!” (Neml 27-28)

Ai e mori letrën dhe e hodhi në prehërin e mbretëreshës së Shebës. Kur e lexoi, ajo e quajti shumë gjë të madhe dhe u frikësua prej saj aq shumë sa u detyrua të mblidhte parinë, të cilëve iu drejtua: **“O paria ime! Mua më ka ardhur një letër fisnike. Ajo është nga Sulejmani dhe është: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Mos u madhështoni para meje dhe ejani të përlurur si besimtarë”!** (Neml 29-31)

Ajo ishte letër me pak fjalë por të përmbledhura që jepnin mesazhin e duhur. Ajo tha: **“O paria ime, më këshilloni se ç’duhet të bëj në këtë çështje!”** (Neml 32)

Më jepni një mendim! Ky është tregues i vendosmërisë së saj dhe mirëudhëheqjes, sepse përdori këshillimin me parinë e popullit të saj duke u thënë: **“Unë nuk do të vendos asgjë pa ju!”** (Neml 32)

Ata i thanë: **“Ne jemi shumë të fortë dhe luftëtarë të guximshëm, por urdhri të takon ty, andaj mendo mirë se ç’do të urdhërosh!”** (Neml 33)

D.m.th ne jemi të gatshëm për çfarëdo që të urdhërosh, për luftë apo paqe, këtë çështje e kemi lënë tek ti që të zgjedhësh. Vendosmëria dhe këmbngulja e saj u shfaqën përsëri dhe, pasi e mendoi mirë këtë punë, ajo u largua nga opsioni i luftës dhe zgjodhi paqen, por në një mënyrë të prerë. Ajo tha: **Tani do t’u dërgoj atyre një dhuratë dhe do të shoh me se do të kthehen të deleguarit.”** (Neml 35)

Nëse është prej atyre mbretërve që nuk synon veçse kënaqësitë e kësaj bote, ndoshta kjo dhuratë ka për ta thyer mendimin e tij, mbase do ta plogështojë vendosmërinë e tij dhe

do të lidhim paqe me të e kështu do të shpëtojmë prej tij, por nëse ndodh e kundërta, atëherë e kuptojmë!

Ajo dërgoi disa njerëz të mençur, të vendosur, me eksperiencë dhe të ditur. Kur shkuan tek Sulejmani me dhuratën ai u tha: **“A mos doni të më ndihmoni me pasuri?! Ajo që më ka dhënë Allahu, është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve. Por ju gëzoheni me dhuratën tuaj. (Neml 36)**

Ai ua bëri të qartë se synimi i tij nuk ishte kënaqësia e kësaj bote, por ngritja e fesë së Zotit dhe dëshira që njerëzit të hynin në Islam.

Pas kësaj i porositi të deleguarit duke mos patur nevojë që t'i shkruante fjalët e tij dhe u tha: **“Kthehuni tek ata! Ne do të sjellim ushtri, të cilën nuk do të mund ta përballojnë ata dhe, me siguri, do t'i dëbojmë ata prej Shebës të poshtëruar dhe të përulur”.** (Neml 37)

Sulejmani e kuptoi se ata do të bindeshin dhe do të dorëzoheshin, prandaj u tha atyre që ishin në mexhlis: **“O parësi, kush prej jush do të më sjellë fronin e saj, para se ata të vijnë të dorëzuar?”** Njëri nga xhindet - Ifriti, tha: **“Unë do të ta sjell ty para se të ngrihesh prej vendit; unë për këtë jam i fuqishëm dhe i sigurt”.** (Neml 38-39)

Sulejmani jetonte në vendet e Shamit dhe mes tij dhe atij populli kishte distancë dy muaj udhëtim, dy muaj vajtje dhe dy muaj kthim. **“Por ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: “Unë do të ta sjell ty sa çel e mbyll sytë”.** (Neml 40)

Ka shumë mundësi dhe këtë e kanë pohuar shumica e komentatorëve të Kur'anit se ai ishte njeri i mirë që dinte emrin më të madh të Zotit me të cilin po të lutesh Ai të përgjigjet. Ai iu lut Allahut dhe froni erdhi para se të çelte sytë.

Ose është e mundur se ky njeri që kishte njohuri nga libri, posedonte shkaqe të cilat Allahu ia kishte mundësuar Sulejmanit, shkaqe përmes të cilave mund të afronte gjëra nga distanca shumë të mëdha dhe të sillte gjëra që ishin shumë larg.

Sidoqoftë ne kemi të bëjmë me një sundues të madh të ciliti vjen në çast gjithë ai fron i madh. Për këtë arsye, Sulejmani kur e pa para vetes, e falënderoi Allahun dhe tha: **“Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijtë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues. (Neml 40)**

Atyre përreth u tha: **“Ndryshojeni edhe fronin e saj!”** (Neml 41)

D.m.th ndryshojeni duke shtuar apo duke paksuar ndonjë gjë. **“Do të shohim se a do ta vërë re këtë apo jo.”** (Neml 41)

Sulejmanit i kishin treguar për urtësinë dhe zgjuarsinë e saj, por ai dëshoi ta shihte realitetin me sytë e tij. Kur erdhi ajo, i thanë: **“I tillë është froni yt?”** (Neml 42)

Ata ja treguan fronin dhe kur e pa e njohu atë, pa ndryshimet që ishin bërë në të dhe sikur nuk e besoi të ishte ai. Duke qenë jo e sigurtë në njërën nga opsionet: Ajo u përgjigj: **“Duket sikur të ishte ai”** (Neml 42)

Ajo nuk tha: Ai është në të vërtetë! Për shkak të ndryshimeve që ishin bërë në të dhe nuk e mohoi të ishte ai sepse e njohu atë, por përdori një shprehje që përshtatej me të dy opsionet.

Sulejmani e kuptoi zgjuarsinë e saj dhe tha: **“Para saj na është dhënë dituria dhe para saj i jemi nënshtruar Allahut”.** (Neml 42)

Nëse këto ishin fjalët e Sulejmanit, atëherë do të thotë: Se ne ishim të informuar për logjikën dhe dijen e saj para se të ndodhte kjo, por e vërtetuam atëherë kur e vumë në provë.

Por nëse ishin fjalët e mbretëreshës së Shebës duket sikur ajo po thotë: Na është dhënë dituria për pushtetin e Sulejmanit dhe se ai është mbret profetësie dhe mesazhi dhe se ai posedon forcë të madhe para se të ndodhte ky rast dhe ishim të dorëzuar të bindur për atë që tha Sulejmani pasi që e vërtetuam çështjen e tij.

Me të drejtë dikush mund të thotë: Me gjithë logjikën dhe mendimin e drejtë të saj, si është e mundur që ajo të adhuronte diçka tjetër në vend të Allahut? Si mund të bëhen bashkë logjika dhe idhujtaria ndaj diçkaje që nuk sjell as dëm e as dobi, por përkundrazi vetëm sa e dëmton robin? Përgjigjen e mësojmë tek fjala e tij: **“Atë (Belkisën) e kishte penguar (nga Islami) ajo që adhuronte në vend të Allahut, sepse ajo ishte nga populli mohues.** (Neml 43)

D.m.th besimet me të cilat rritet njeriu dhe ideologjitë e prishura të cilat mbizotërojnë mendjen e çdo të logjikshmi, duke i larguar thelbin e logjikës, e mundin njeriun, derisa t'i vijnë shkaqet e dobishme të cilat i sqarojnë të vërtetën dhe e nderojnë me ndjekjen e saj.

Sulejmani posedonte një ndërtesë prej xhami poshtë të cilës rridhin lumenj. Kushdo që e shihte mendonte se është ujë që rridhte, sepse xhami ishte i tejdukshëm. Kur i thanë Belkisës hyr në këtë ndërtesë ajo e pa dhe mendoi se ishte ujë dhe përveli rrobat duke zbuluar këmbët. Asaj i thanë se kjo është ndërtesë e gdhendur prej xhami. Ajo tha: **“O Zoti im, me të vërtetë unë e paskam dëmtuar veten dhe tani, bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve!”** (Neml 44)

Ajo i besoi Allahut dhe populli i saj e ndoqi në këtë besim dhe thuhet se Sulejmani u martua me të, por sidoqoftë Allahu e di më së miri!

Në kohën e Sulejmanit Allahu i kishte nënshtruar shejtanët në interes të tij, por i erdhën lajme se me përzierjen e tyre me njerëzit kishin filluar t'u mësonin atyre magjinë. Ai i mbledhi dhe i kërcënoi, gjithashtu i mori librat e tyre dhe i groposi. Pas vdekjes së Sulejmanit shejtanët erdhën tek njerëzit dhe u thanë: “Mbreti Sulejman jetën e tij e kaloi në magji.” Ata nxorën librat të cilat ai i kishte groposur dhepërhapën lajmin mes njerëzve përmes tellallëve se këto libra ishin marrë nga Sulejmani dhe se ai ishte magjistar. Këtë ideologji e përhapën edhe disa grupe hebrejsh. Por Allahu e pastroi Sulejmanin nga kjo shpifje dhe sqaroi se magjia ishte dëm i madh duke thënë: **“Dhe shkuan pas shpifjeve që bënëin djajtë kundër mbretërisë së Sulejmanit. E Sulejmani nuk ishte mohues.”**

(El Bekare 102) D.m.th duke mësuar magjinë apo duke u kënaqur me të **“Por djajtë ishin mohues. Ata u mësonin njerëzve magjinë dhe dijeninë që u ishte dërguar dy engjëjve në Babiloni - Harutit e Marutit. Këta engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: ‘Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!’ Dhe njerëzit mësuan nga këta të dy se si t’i ndajnë bashkëshortët. Por magjistarët nuk mund t’i bëjnë dëm askujt pa lejen e Allahut. E megjithatë, njerëzit mësojnë ato gjëra që i dëmtojnë e nuk u bëjnë dobi. Në të vërtetë, ata e dinin se ai që e përvetësonte këtë mjeshtëri, nuk do të kishte kurrfarë të mire në jetën tjetër. Eh, sa e keqe është ajo për të cilën shitën shpirtrat e tyre! Ah, sikur ta dinin ata!”** (El Bekare 102)

Kjo është madhështia e Kur'anit, sepse i urdhëron krijesat që t'i besojnë të gjithë pejgamberët duke i përmendur me cilësitë më të mira dhe duke i pastruar nga të gjitha shpifjet e thëna nga njerëzit për ta e që bien ndesh me mesazhin e tyre.

Allahu e sprovoi Sulejmanin duke e lënë mbi fronin e tij si trup të palëvizshëm në shenjë qortimi ndaj disa mangësive dhe për ta kthyer në bindjen dhe nënshtrimin e plotë ndaj Zotit të Lartësuar. Prandaj Zoti tha: **“Por ai iu drejtua Zotit”** Me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë, me aparencën dhe të fshehtën e tij **“O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet që të mos e ketë askush pas meje! Me të vërtetë, Ti je Dhurues i madh!”** (Sad 35)

Allahu iu përgjigj lutjes së tij dhe i dha atë që kërkoi prej mëshirës dhe faljes së mëkatit. Gjithashtu i dha të gjitha gjërat që ai i kërkoi siç u përmend më lart.

Allahu i Lartësuar i ka lavdëruar Daudin dhe Sulejmanin për dijen dhe sundimin e tyre, por e veçoi Sulejmanin me mendjemprenhtësi duke thënë: **“(Kujtoje) edhe Dautin dhe Sulejmanin, kur gjykuan mbi të lashtat në të cilat kishin kullotur natën bagëtitë e disa njerëzve.”** (Enbija 78)

D.m.th disa bagëti kishin hyrë në arë gjatë natës duke prishur bimët dhe pemët. Daudi gjykoi në bazë të asaj që pa të arsyeshme dhe përlllogaritjeve të tij se delet i takojnë të zotit të asaj are, duke menduar se ajo që u dëmtua në arë është njësoj sa çmimi i deleve. Më pas këtë çështje ia tregoi Sulejmanit dhe ai gjykoi për të zotin e bagëtive që të mbillte dhe të ujiste tokën e atij që kishte dëmtuar, derisa të kthehej në gjendjen e mëparshme dhe i zoti i deleve t'ia jepte delet që të përfitonte prej qumështit, gjalpit dhe leshit në këmbim të asaj që ai mund të përfitonte përmes arës së mbjellë gjatë kësaj kohe. Ky gjykim që

erdhi nga Sulejmani ishte më afër të vërtetës dhe më idobishëm si për të zotin e bagëtive, ashtu edhe për të zotin e arës (kullotës)

Për këtë arsye Allahu i Lartësuar tha: **“Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptonte drejtë çështjen dhe, që të dyje u dhamë mençuri e dituri.”** (Enbija 79)

I ngjashëm me këtë gjykim ishte edhe rasti tjetër i Daudit dhe Sulejmanit që gjykuan mes dy grave të cilat kishin dalë dhe secila kishte patur djalin e saj me vete. Ujku sulmoi djalin e gruas më të madhe në moshë dhe kjo e fundit pretendonte ndaj tjetrës se ujku kishte ngrënë djalin e saj dhe se djali që kishte shpëtuar nga ujku ishte djali i të madhes. E vogla në moshë e kundërshtoi këtë dhe tha: Përkundrazi, ujku hëngri djalin tënd dhe të dyja bashkë shkuan dhe kërkuan gjykim tek Daudi. Ai kur pa se anjëra nuk kishte argument bindës përveç fjalëve që thonin, mendoi që të gjykonte në favor të gruas më të madhe në moshë, edhe për ta respektuar për moshën e saj, me mendimin se e vogla kishte jetën përpara dhe Zoti do t'i mundësonte asaj të kishte fëmijë të tjerë në vend të atij fëmije.

Por çështja u ngrit tek Sulejmani (alejhi salam) i cili u tha të dyjave: “Më sillni një thikë ta ndaj fëmijën mes jush. E madhja pranoi, ndërsa e vogla kur pa se çështja ishte mes jetës dhe vdekjes, e mendoi se nëse do të jetonte me tjetrën do të ishte më e lehtë dhe zgjodhi të thoshte: ‘Ai është djali i saj, o profet i Zotit.’”

Sulejmani e kuptoi përmes kësaj natyrshmërie që është argumenti më i fortë, se ai nuk ishte djali i të madhes, sepse ajo pranoi që të ndahej përgjysëm dhe të vdiste dhe se pretendimet e saj ndaj gruas tjetër i kishte për shkak të smirës dhe zilisë dhe se ai ishte fëmija i gruas së vogël, e cila kur u trondit nga

prerja e tij lëshoi pe ndaj akuzave të saj. Prandaj dhe Sulejmani gjykoi në favor të saj.³⁸

S'ka dyshim se nxjerja e të drejtës me anë të fakteve, argumenteve, dëshmime dhe gjendjeve të ndryshme, konsiderohet mendjemprehtësi me të cilën Allahu përzgjedh kë të dojë.

Disa dobi dhe mësim të përfituara nga historia e Daudit dhe Sulejmanit

1- Allahu i Lartësuar i tregon profetit të tij Muhamedit (alejhi selam) historitë e popujve të mëparshëm me qëllim që zemra e tij të forcohet dhe shpirti i tij të qetësohet. I tregon për adhurimet, durimin e fortë dhe pendimin e tyre, gjëra që nxisin për garim në afrimin tek Allahu, sepse ata garonin për tu afruar sa më shumë tek Ai dhe për t'i përballuar lëndimet e popullit më lehtë. Për këtë arsye në fillim të sures Sad, Allahu përmend fjalët e përgënjeshtresve dhe lëndimet e tyre dhe pas kësaj Ai thotë: **“Ti duroje atë që thonë ata dhe kujtoje robin Tonë të fuqishëm, Daudin, që përherë i drejtohej Zotit.”** (Sad 17)

2- Fjala e Zotit kur thotë: **“Robin Tonë të fuqishëm, Daudin, që përherë i drejtohej Zotit.”** (Sad 17)

Ky është lavdërim i madh nga Allahu për shkak të këtyre dy tipareve: forcën e zemrës dhe të trupit në bindjen ndaj Allahut, si dhe kthimin e brendshëm dhe të jashtëm tek Allahu. Që të dyja bashkë realizojnë dashurinë ndaj Tij dhe njohjen e plotë. Tek Pejgamberët, këto dy tipare vijnë për të treguar përsosmëri, ndërsa për ndjekësit e tyre do të ketë merita për aq sa i ndjekin (në këto dy tipare) Ndërsa lavdërimi që Allahu u bën këtyre dy

³⁸ E përcjell Buhariu me nr. 3427, Muslimi me nr. 1720, 20 nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

tipareve nënkupton nxitjen për tu pajisur me të gjitha shkaqet që ndihmojnë për të arritur forcën dhe kthimin tek Allahu dhe se robi duhet të jetë gjithmonë i kthyer tek Zoti si në rastin kur është mirë, po ashtu edhe atëherë kur është në gjendje të vështirë. Pra në të gjitha rastet!

3- Nderimin që Allahu i bëri profetit Daud duke i dhënë zë të bukur dhe melodioz, duke bërë që edhe malet dhe shpendët t'i përgjigjen atij në madhërimin e Allahut bashkë me të, ky është tregues për shtimin e gradëve dhe pozitës së tij të lartë tek Allahu.

4- Mirësia më e madhe e Zotit ndaj robit është kur i jep dije të dobishme që i mundëson drejtimin e duhur në çështje ku njerëzit kanë kundërshtime si në fjalët apo ideologjitë e tyre, edhe në ngatërresat apo hasmëritë që mbajnë. Siç thotë i Lartësuari: **“Dhe i dhamë mençuri e dijeni për të gjykuar.** (Sad 20)

5-Mësojmë kujdesin që tregon Zoti i Lartësuar ndaj Profetëve dhe njerëzve të zgjedhur në rastet kur atyre u ndodhin disa gabime përmes sprovimeve që Ai u bën. Kështu Ai jo vetëm që ua largon atë, por ata kthehen në gjendje më të plotë nga ç'ishin më parë. Siç ndodhi në rastin e Daudit dhe Sulejmanit.

6- Profetët janë të pagabueshëm sa i takon kumtimit (përcjelljes) që ata i bëjnë shpalljes së Zotit, sepse Allahu na ka urdhëruar për bindje të plotë ndaj tyre. Qëllimi i mesazhit hyjnor nuk arrihet ndryshe, por tek ata mund të ndodhin ndonjëherë disa gjëra të natyrshme prej kundërshtive, e megjithatë Allahu i Lartësuar i pranon me butësinë e Tij dhe i korigjon (përmirëson) me anë të pendimit dhe kthimit tek Ai.

7- Shumicën e kohës Daudi (alejhi selam) e kalonte në faltoren e tij në shërbim të Zotit të Lartësuar. Po ashtu një pjesë

të kohës e kalonte duke zgjidhur problemet që kishin njerëzit. Në këtë mënyrë ai plotësonte detyrimin ndaj Zotit dhe ndaj krijesave të Zotit.

8- Etika duhet të jetë prezente në momentin kur hyn tek të tjerët, sidomos kur bëhet fjalë për udhëhqësit dhe prijësat e shtetit. Në momentin kur dy personat u futën tek Daudi në një mënyrë jo normale dhe jo nga dera, ai u frikësua dhe u ndje keq dhe e quajti jo të mirë këtë veprim.

9- Udhëheqësin nuk duhet ta pengojë nga gjykimi i drejtë sjellja e keqe e kundërshtarit apo veprimet e tij jo të hijshme.

10- Mësojmë butësinë e plotë të Daudit, sepse ai nuk u zemërua me dy personat që hynë tek ai pa marrë leje, nuk i ndaloi e as nuk i qortoi për këtë që bënë.

11- Lejohet që njeriu i shtypur t'i thotë të padrejtut: "Ti më ke bërë padrejtësi!" Apo t'i thërrasë: "O zullumqar!" Ose: "O i pafytyrë!" Nisur nga ajeti: **"Njëri nga të cilët i ka bërë padrejtësi tjetrit."** (Sad 22)

12- Ai që këshillohet edhe pse gëzon pozitë dhe dije të madhe, nuk duhet të ndihet keq apo të zemërohet. Përkundrazi duhet të nxitojë dhe ta marrë këshillën, pse jo dhe ta falënderojë atë që ia dha këshillën si dhe të falënderojë Allahun që ia mundësoi këshillimin tek ai person. Daudi nuk u ndie keq nga fjalët e dy të kundërshtuarve kur i thanë: **"Prandaj gjyko me drejtësi dhe mos u shmang (prej së vërtetës), por na udhëzo në rrugë të drejtë"**. (Sad 22)

Ai gjykoi me të drejtë e vërtetë.

13- Përzierja me të afërmit, shokët, punëtorët si dhe marrëdhëniet që kanë në mes si çështje pasurie, në shumicën e rasteve sjellin armiqësi dhe shumë herë njerëzit i hyjnë në

hak njëri-tjetrit. Këtë epidemi shkatërruese e largon vetëm devotshmëria, durimi, imani dhe veprat e mira që fatkeqësisht janë të rralla në mesin e njerëzve.

14- Mësojmë nderimin që Allahu i bëri Daudit dhe Sulejmanit duke i afruar në gradë të larta dhe duke u dhënë strehim të mirë (në botën tjetër), në mënyrë që të mos hamendësojë dikush se ajo që u ndodhi ishte mangësi për ta në pozitën që ata gëzonin tek Zoti. Kjo tregon mëshirën dhe butësinë e plotë të Allahut ndaj njerëzve të sinqertë, sepse kur Ai i fal dhe jua largon gjurmën e mëkateve, u largon gjithashtu edhe pasojat e mëkateve, me qëllim që kjo të mos ndikojë në zemrat e njerëzve. Kjo nuk është aspak e vështirë për Zotin, i Cili është Bujar i Madh!

15- Grada e gjykimit mes njerëzve është pozitive fetare të cilën e kanë marrë përsipër peygamberët e Allahut dhe njerëzit e zgjedhur. Prandaj ai që merr përsipër një detyrë të tillë duhet të gjykojë me drejtësi dhe të mos ndjekë dëshirat e tij. Të gjykosh me të drejtën do të thotë: Të kesh njohuri rreth çështjeve legislative dhe të kesh një ide të plotë për atë që je duke gjykuar dhe të dish si ta ndërthurësh me gjykimet e përgjithshme legislative. Ai që nuk njeh qoftë edhe njërën prej këtyre që thamë, nuk i lejohet të marrë përsipër gjykimin mes njerëzve.

16- Sulejmani konsiderohet fryt i babait (Daudit) dhe mirësi e Zotit që ia dhuroi atij (Daudit) Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne i falëm Daudit Sulejmanin, një rob të mrekullueshëm. Ai i drejtohej gjithnjë me pendesë Zotit!”** (Sad 30)

Këto fjalë janë rekomandimi më i mirë dhe krenaria më e madhe për Sulejmanin!

17- Mësojmë mirësitë e shumta që Allahu u jep njerëzve të zgjedhur, duke u mundësuar morale të bukura dhe vepra të mira, pas të cilave i lëvdon duke u siguruar edhe shpërblimin e lloj-llojshëm, edhe pse në realitet Ai ishte që u mundësoi shkaqet dhe solli pasojat (shpërblimet).

18- Sulejmani i dha përparësi dashurisë ndaj Zotit para çdo dashurie tjetër. Ai i vrau kuajt të cilët e hutuan nga përmendja e Zotit derisa dielli humbi mbas malit.

19- Çdo gjë që e pengon njeriun nga bindja ndaj Zotit konsiderohet vepër e kobshme, prandaj le të distancohet dhe të shkojë pas diçkaje që është më e dobishme për të.

20- Mësojmë se kur Sulejmani i vrau kuajt e shpejtë të cilët e hutuan nga bindja ndaj Zotit, si për t'ia zëvendësuar Allau i nënshtroi erën dhe shejtanët (me të cilët i kryente gjëra më shpejt), sepse kushdo që braktis diçka për hir të Allahut, Ai ia zëvendëson me diçka shumë më të mirë.

21- Nënshtrimi i djajve dhe i erës që i ndodhi Sulejmanit, nuk ka për t'i ndodhur askujt tjetër që do të vijë pas Sulejmanit (alejhi selam).

Për këtë arsye, Profeti (alejhi selam) kur deshi ta kapte dhe ta lidhte shejtanin në një shtyllë të xhamisë, sepse një natë pështyu drejt tij, tha: “Mu kujtua lutja e vëllait tim Sulejmanit dhe e lash atë.”³⁹

³⁹ E përcjell Buhariu me nr 461, Muslimi me nr 541 dhe 39 nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) i cili tregon se Profeti (alejhi selam) ka thënë: Një Ifrit prej xhindëve pështyu drejt meje mbrëmë që të ma ndërpriste namazin. Allahu më mundësoi që ta kisha nën pushtetin tim, prandaj e mora dhe desha ta lidhja tek një shtyllë prej shtyllave të xhamisë që ta shihnit të gjithë, por mu kujtua lutja e vëllait tim Sulejmanit **“O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet që të mos e ketë askush pas meje!”** dhe e lash të largohej i poshtëruar.

22- Allahu i dha Sulejmanit pushtet të madh, pushtet i cili nuk mund të arrihet me shkaqe normale por vetëm me caktimin e Sunduesit Dhurues. Siç ishte nënshtrimi i erës e cila lëvizte konform urdhrave të tij dhe nënshtrimi i shejtanëve apo ushtria e përbërë nga xhindët, njerëzit dhe shpendët. Këta të fundit i shërbenin shumë sepse i dërgonte në vende të ndryshme për të çuar lajme apo për t'i sjellë lajme prej vendeve nga vinin. Zoti u kishte dhënë edhe aftësinë për ta kuptuar gjendjen e njerëzve, siç na tregoi Zoti i Lartësuar në këtë histori, apo si rasti i atij që kishte njohuri nga libri kur u bë gati që ta sillte fronin e mbretëreshës së Shebës para se të hapte apo të mbyllte sytë. Këto janë mrekullitë e peygamberëve, prandaj sado që krijesat të arrijnë zhvillimin në njohuritë shkencore, në shpikjet dhe aftësitë e tyre, përsëri nuk mund të arrijnë tek ajo që iu dha Sulejmanit.

23- Mbretërit apo udhëheqësit duhet të interesohen për gjendjen e sunduesve të tjerë, njerëzve të dalluar dhe jo të mjaftohen vetëm duke pyetur për ta. Jo, duhet t'i vënë në provë dhe të zbulojnë njohuritë dhe zgjuarsinë që zotërojnë. Siç veproi Sulejmani me mbretëreshën e Shebës të cilën ai e provoi për të parë logjikën dhe zgjuarsinë e saj dhe nuk u mjaftua vetëm duke pyetur për të. Kjo metodë do të sillte dobi të mëdha dhe kjo është mëse e nevojshme, sepse: Sundimi i plotë është ai që udhëhiqet nga njerëz me tipare të plota!



HISTORIA E EJUBIT

(alejhi selam)

Ejubi ishte Profet i zgjedhur dhe i nderuar dhe i përkiste Beni Israilëve. Allahu i Lartësuar e ka përmendur atë në Librin e Tij dhe e ka lavdëruar për cilësitë e tij të larta në përgjithësi e sidomos për durimin ndaj sprovave në veçanti.

Allahu i Lartësuar e sprovoi në fëmijët, familjen, pasurinë si dhe në trupin e tij. Ai e sprovoi me gjëra që nuk kishte provuar ndokën nga krijesat e tij. Por ai duroi ndaj caktimit të Allahut dhe vazhdoi të ishte gjithmonë i kthyer tek Zoti i tij.

Kur sëmundja zgjati shumë kohë dhe e harruan shokët dhe të dashurit, ai u lut duke thënë: **“Mua më ka goditur fatkeqësia dhe Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!”** (Enbija 83)

Atij iu tha: **“Qëlllo me këmbën tënde”** Ai e qëllloi tokën me këmbë dhe prej aty buroi ujë i ftohtë dhe i thanë: **“Pi prej tij dhe lahu.”** Ai veproi siç i thanë dhe kështu Allahu ia largoi sëmundjen dhe sprovën e mundimshme.

Pas kësaj Zoti i Lartësuar ja ktheu familjen dhe pasurinë dhe i dha prej mirësive të mëdha dhe me këtë durim ai u bë prijës

i durimtarëve dhe ngushëlluesi i të sprovuarve, si dhe këshillë për atë që do të marrë këshillë.⁴⁰

Gjatë sëmundjes ai ishte zemëruar me gruan e tij e cila ishte treguar shumë e sjellshme me të dhe shumë e mëshirshme. Ai ishte betuar se do ta qëllonte me 100 shkopinj, por Allahu ia largoi këtë (barrë) dhe i tha: **“Merr me dorën tënde një tufë thuprash.”** Kur t'i mbështjellësh në bar apo diçka tjetër të ngjashme dhe aty të jenë edhe 100 shkopinj, qëllaje me to dhe mos e thyej betimin tënd. D.m.th me këtë betimi yt shkon në vend.

⁴⁰ Në hadith përcillet nga Enes bin Malik nga Profeti (alejhi selam) se ka thënë: “Vërtet Profeti i Allahut Ejubi (alejhi selam) qëndroi në sprovën e tij tetëmbëdhjetë vite. Atë e mohuan të afërmit dhe të largët përveç dy burrave prej vëllezërve të tij të cilët shkonin e vizitonin në mëngjes dhe mbrëmje. Njëri prej tyre i tha shokut tjetër: ‘E di çfarë? Vallahi, Ejubi duhet të ketë bërë ndonjë mëkat të cilin se ka bërë njeri para tij.’ Tjetri i tha: ‘Çfarë mëkati?’ Ai ja ktheu: ‘Ka 18 vite dhe Allahu nuk po e mëshiron për t’ia larguar këtë sprovë.’ Kur shkuan tek Ejubi njëri nuk duroi dhe ia përmendi këtë, ndërsa Ejubi i tha: ‘Nuk e di për çfarë po flisni, por Zoti e di më mirë se unë se një ditë kalova pranë dy burrave që grindeshin dhe përmendnin Zotin ndërsa unë kthehesha në shtëpi dhe e shpagova betimin në vend të tyre nga ajo se nuk doja të përmendej Allahu veçse në të vërtetën.’ Ai dille për të kryer nevojën dhe kur mbaronte, gruaja e tij e kape për dore derisa ta çonte në shtëpi. Një ditë ajo u vonua dhe në atë moment i erdhi shpallja **‘Bjeri me këmbë tokës dhe aty do të dalë një burim me ujë të ftohtë për larje dhe pirje!’** Ajo u vonua dhe e arriti, por ai shkoi ndërkohë që Allahu ia kishte larguar sëmundjen dhe gëzonte paraqitjen më të mirë. Ajo kur e pa i tha: ‘Zoti të dhëntë begati! A mos e ke parë profetin e Zotit, Ejubin, këtë njeri të sprovuar, sepse unë nuk po shoh tjetër njeri më të ngjashëm me të sesa ti, atëherë kur ai ishte shëndoshë e mirë?’ Ai i tha: ‘Unë jam Ejubi! Ai kishte dy enë, njëren me grurë dhe tjetrën me elb. Allahu i dërgoi dy re dhe kur njëra lëshoi shiun mbi enën me grurë, prej aty dolën monedha floriri, ndërsa tek tjetra dolën monedha argjendi.’” (E përcjell Ebu Jala me nr 3617 dhe e ka saktësuar Hakimi 2/581,582, ibn Hiban me nr 2091 po ashtu e ka saktësuar Albani në “Vargu i haditheve të sakta” me nr 17.

Nga kjo mësojmë se shlyerja e betimit nuk është lejuar për askënd para legjislacionit tonë dhe se betimi tek popujt e hershëm ka qenë i njejtë me zotimin, që duhet patjetër të shkojë në vend.

Gjithashtu mësojmë se ai që nuk e përballon një gjykim penal për shkak të dobësisë etj, mbi të zbatohet diçka e ngjashme, sepse qëllimi është largimi prej asaj gjëje dhe jo shkatërrimi apo shuarja e tjetrit.



HISTORIA E DHUL KARNEJNIT

Dhul Karnejni ishte mbret i mirë dhe i devotshëm. Allahu i kishte dhënë forcën dhe mjetet e sundimit dhe zgjerimit, të cilat nuk ia kishe dhënë dikujt tjetër më parë.

Allahu ka përmendur disa fragmente që flasin për biografinë e tij të mirë, mëshirën, forcën, sundimin e tij të fortë dhe zgjerimin e ushtrive të tij nga lindja në perëndim, mjaftueshëm sa për të dhënë një ide të plotë rreth historisë së këtij njeriu, gjendjen dhe rrethanat në të cilat jetoi. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë: **“Ata (hebrenjtë) të pyesin ty (Muhamed) për Dhulkarnejnin, thuaj: ‘Unë do t’ju tregoj disa lajme për të.’** (Kehf 83)

D.m.th disa fragmente nga historia e tij.

Është mëse i njohur fakti se historitë të cilat i tregon Allahu në Librin e Tij, janë më të mirat dhe më të dobishmet. Në rastin tonë, Ai tregoi se i kishte mundësuar Dhulkarnejnin mjete dhe rrugë për të arritur çdo gjë që lidhet me forcën, pushtetin, njohuri mbi mënyrën si të udhëheqë, mirëorganizimin, armët që përunjnin popujt, ushtrinë e madhe, mundësinë e lëvizjes dhe çdo gjë tjetër që i nevojitej.

Në fakt ai i shfrytëzoi mjetet të cilat iu dhanë, sepse jo çdokujt i jepen mjetet e dobishme dhe jo çdokujt që i jepen, di t'i shfrytëzojë dhe t'i vërë në zbatim.

Ndërsa Dhul Karnejnit ju plotësuan të dyja, sepse iu dhanë mjetet dhe ai shfrytëzoi. Me ushtritë e tij të pamposhtura ai mbërriti në ultësirat e Afrikës dhe në tokat më të largëta të saj, deri aty sa arriti në oqeanin perëndimor në një vend që kur perëndonte dielli **“Pa se ai po ulej në një burim të zi balte.”** (Kehf 86)

D.m.th e pa me sytë e tij sikur dielli perëndonte në det, ndërsa deti mbante ngjyrë si balta.

Që do të thotë se ai mbërriti deri aty ku nuk kishte shkelur këmba e njeriut, e as kuajt e ndonjë kalorësi, pra në vendet e Afrikës dhe atje gjeti një popull të përzier. Mes tyre kishte besimtarë dhe mohues, të mirë dhe të këqinj. Këtë e pohon fjala e Allahut që thotë: **“Ne thamë: “O Dhulkarnejn, mund t’i ndëshkosh ata ose mund t’u bësh mirë atyre.”** (Kehf 86)

Mundet që këto fjalë t’ia ketë thënë një profet prej profetëve të Zotit, ose ndonjëri nga dijetarët e atij vendi, ose qëllimi ishte se me anë të forcës që ai posedonte, kishte mundësinë të zgjidhte dhe të caktonte çfarë do bënte me ta! Por të mos harrojmë se në legjislacion nuk mund të barazohen të gjithë dhe të veprohet me ta njësoj, qoftë në bamirësi apo ndëshkim, prandaj ai tha: **“Sa i përket atij që bën të këqija, Ne do ta ndëshkojmë e pastaj do të kthehet te Zoti i vet, i Cili do ta ndëshkojë me një dënim të rëndë. Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe do t’i premtojmë atij lehtësira.”** (Kehf 87-88)

Kjo pohon drejtësinë e tij dhe se ai ishte mbret i mirë dhe dinte si të drejtonte. **“Pastaj ndoqi një rrugë tjetër.”** (Kehf 89)

D.m.th pas kësaj ai veproi me ato mjete që i ishin mundësuar pasi që i gjunjëzoi zonat e largëta perëndimore kështu që nisi të zgjerohej në çdo pëllëmbë toke derisa mbërriti në lindje të

diellit, në vendet e Kinës dhe brigjet e aqeanit paqësor dhe ky qe caku i fundit ku mund të kenë mbërritur çliruesit.

“Ai e pa të lindte mbi një popull, të cilit Ne nuk i kishim dhënë gjë, për t’u mbrojtur nga dielli.” (Kehf 90)

D.m.th nuk kishin me se të ruheshin nga rrezet e diellit, nuk kishin rroba për të veshur dhe as shtëpi ku të strehoheshin. Pra ai gjeti një popull në fund të lindjes së largët me këto tipare kafshërore e që kishin rënë në një gradë me kafshët të cilat strehohen në pyje të dendura, në stepa dhe skuadrone larg prej njerëzve. Në atë kohë këta njerëz jetonin në këto kushte për të cilat na tregon vetë Allahu i Lartësuar.

Qëllimi i kësaj që po them është se ai arriti atje ku nuk kishte shkelur njeri tjetër. Pas kësaj ekspetide u kthye përsëri nga veriu dhe ndoqi një rrugë tjetër që do t’i mundësonte të drejtonte popuj dhe t’i nënështronte dhe për këtë synoi shkuarjen nga veriu: **“Derisa, kur arriti në mes dy malesh.”** D.m.th arriti në një vend të mesëm mes dy malesh që ndodheshin aty që prej kur e kishte krijuar Allahu tokën, e që ishin varg malesh të mëdha, të thepisura dhe të ngjitura bashkë nga ajo zbrazëtia, e që çonin në detet lindore dhe perëndimore e që njihen si vendet ku jetuan Turqit.

Me këtë kanë rënë dakort komentuesit dhe historianët, por kanë pasur kundërshtime lidhur me faktin nëse janë vargmalet e Kaukazit apo diçka tjetër në malet e Azerbajxhanit, apo vragmalet e Tait, apo malet që lidhen me murin Kinez në tokat e Mongolisë, dhe ka më shumë gjasa të jetë kështu pasi ky është dhe mendimi më i qëndrueshëm. Ai gjeti në atë zbrazëti mes këtyre maleve një popull që nuk kuptonin anjë fjalë pos gjuhës që flisnin dhe kishin vështirësi të kuptonin gjuhën e popujve të tjerë.

Ata thanë: “O Dhulkarnejn, vërtet, Jexhuxhët dhe Mexhuxhët janë ngatërrestarë në Tokë.” (Kehf 94)

Ata janë të shumtë në numër dhe u përkasin pasardhësve të Jafith bin Nuh, pra prej rracës Turke siç përmenden të detajuara tiparet që ata kanë.

“A të të japim një pagesë që të ndërtosh një pendë midis nesh dhe atyre?” Ai tha: “Ajo të cilën ma ka mundësuar Zoti im.” (Kehf 94-95)

Prej forcës, mjeteve dhe mundësive “**është më e mirë (se pagesa juaj), por më ndihmoni mua me krahë pune!**” (Kehf 95)

D.m.th, ky ndërtim që do bëj është shumë i madh dhe kërkon ndihmë, forcë fizike dhe trupore.

“**Do të ndërtoj një pendë midis jush e atyre.**” (Kehf 95)

Ai nuk tha mur, sepse ajo që ndërtoi ishte vetëm penda mes dy mureve natyral pra mes vargmaleve.

Ai i oreintoi në mënyrën se si të bënin ndërtimin me anë të veglave, duke u thënë: “**Më sillni blloqe hekuri!**” (Kehf 96)

D.m.th mblihdhini të gjitha ato blloqet e hekurit që gjenden tek të vegjlit apo të mëdhenjtë dhe mos lini asgjë pa sjellë dhe vendoseni mes dy pendëve. Ata vepruan siç u tha, aq sa hekuri u bë si mal i madh. Prandaj tha: **Dhe, kur ai i rrafshoi dy anët e thepisura të maleve.**” (Kehf 96) Pra mes dy maleve që qëndronin pranë njëri-tjetrit afër atij grumbulli, tha: “**Fryjini zjarrit, derisa hekuri të skuqet si zjarri.**” Pastaj tha: “**Më sillni bakër të shkrirë që ta hedh në të.**” (Kehf 96)

Pra urdhëroi që hekuri të shkrihej me anë të zjarrit dhe lejoi që të hynte mes pllakave të hekurit dhe kështu u lidhën bashkë dhe u bënë si të ishin mal i madh dhe i lidhur mes dy kodrave.

Kjo e realizoi qëllimin për të penguar Jexhuxhët dhe Maxhuxhët prandaj dhe tha: **“Kështu, ata (Jexhuxhët dhe Mexhuxhët) nuk mundën që ta kapërcenin pendën.”** (Kehf 96) Pra që ta kapërcenin pendën **“dhe as nuk mundën që të hapnin vrimë në të.”** (Kehf 97-98)

Ai tha: **“Kjo është mëshirë nga Zoti im!”** D.m.th. Zoti im më dha sukses për ta kryer këtë punë të mirë dhe të vlefshme dhe këtë gjurmë të përhershme sepse Ai u mëshiroi në momentin kur u ruajti nga dëmi i Jexhuxhëve dhe Maxhuxhëve me këtë mjet me të cilin ju nuk kishit mundësi për ta bërë. **“Kur të vijë premtimi⁴¹ i Zotit tim, Ai do ta rrafshojë atë (pendën). Premtimi i Zotit tim është (gjithnjë) i vërtetë.”** (Kehf 98)

Kjo punë dhe kjo zgjidhje mes jush dhe Jexhuxhëve dhe Maxhuxhëve është e përkohshme deri në një afat të caktuar, sepse kur të vijë premtimi i Zotit dhe Ai tu japë mundësi nëpërmjet mjeteve të reja madhështore, forcës etj. që u mundëson Jexhuxhëve dhe Maxhuxhëve të shkelin në tokat tuaja, o ju që jetoni pranë tyre, madje kur të shkelin lindjen dhe perëndimin e tokës dhe çdo pjesë të saj siç thotë Allahu: **“Dhe, kur të dalin Jexhuxhët dhe Mexhuxhët e të shpejtojnë prej çdo lartësie.”** (Enbija 96)

D.m.th prej çdo vendi të lartë, si në rastin e kësaj pende, nga detet, malet, prej të gjithave kanë për të vërshtuar pa e vrarë mendjen dhe pa i ndaluar njeri. Shprehja prej çdo lartësie përfshin të gjitha vendet dhe tokat, luginat dhe tatëpjetat, ultësirat apo lartësitë. Allahu përmendi lartësitë sepse luginat dhe vendet e ulta janë më parësore që ata të ecin në to.

⁴¹ Dita e Kiametit.

Në cilësitë dhe tiparet e tyre janë përcjellë shumë hadithe, sidomos tek dy sahihet (Buhariu dhe Muslimi) të cilat pohojnë atë që përmendet në ajete për tiparet e tyre. Madje historianët e parë kanë përmendur tek cilësitë dhe gjendja e tyre disa fjalë që s'kanë patur transmetime e as vërtetësi dhe kështu kanë çoroditur mendjet e shumë njerëzve duke i penguar nga argumentimi me anë të ajeteve Kuranore dhe haditheve të sakta si dhe nga praktimi i tyre në realitet. Prandaj mbaju asaj që përcillet në Kuran dhe sunet dhe lëri të tjerat, sepse aty gjendet udhëzimi, orinetimi dhe drita.



HISTORIA E ISAIT

(alejhi selam)

dhe nënës së tij Merjemes,
si dhe historia e Zekerijas dhe Jahjas

Bashkëshortja e Imranit - njeriut më me autoritet të beni Israilët dhe më me vlera në mesin e tyre - kur që shtatëzënë ishte zotuar se foshnjen që mbante në barkun e saj do ta vinte në shërbim të faltres “Bejt el- Makdis” që të shërbente në shtëpinë e Zotit, të përgatitej për adhurimin ndaj Tij. Këtë zotim e bëri duke menduar se foshnja që mbante në barkun e saj ishte mashkull.

Por kur e lindi, në formë justifikimi dhe ankese për gjendjen e saj ajo tha: **“Zoti im! Unë linda femër, - Allahu e di më mirë se çfarë lindi ajo, - e mashkulli nuk është si femra.”**

(Al Imran 36)

D.m.th mashkulli që posedon forcën dhe fuqinë e asaj që kërkohet prej tij në shërbim të faltres “Bejt al-Makdis”

“Unë ia vura emrin Merjeme dhe i kam lënë atë me pasardhësit e saj nën mbrojtjen Tënde nga djalli i mallkuar”.

(Al Imran 36)

Unë po kërkoj mbrojtjen e Allahut nga armiku i saj, për të dhe pasardhësit e saj.

Kjo ishte mbrojtja e parë nga Allahu për të dhe për këtë arsye Allahu iu përgjigj në këtë botë duke thënë: **“Zoti e pranoi atë (Merjemen) me ëndje.”** (Al Imran, 37)

Që do të thotë se Allahu e qetësoi nënën e saj dhe ia pranoi zotimin më shumë seç mund ta pranonte po të kishte qenë mashkull. **“E bëri që të rritet mirë dhe e la nën kujdestarinë e Zekerias.”** (Al Imran, 37)

Tek Merjemja Allahu bashkoi mes përkujdesjes fizike dhe edukimit shpirtëror, sepse caktoi për të që kujdestar të ishte njëri nga profetët më të mëdhenj të beni Israilëve për atë kohë. Nëna e saj kur e çoi në “Bejtul Makdis” ata ranë në kundërshti se kush do ta merte në kujdestari, sepse ishte vajza e të parit të tyre, prandaj hodhën short duke hedhur lapsat e tyre dhe shorti i ra Zekerijas si mëshirë për të dhe Merjemen. Ai u kujdes në mënyrën më të mirë. Allahu e ndihmoi atë në këtë kujdestari duke i dhënë mirësi të madhe dhe kështu ajo u rrit dhe u zhvillua në një ambjent shumë të mirë dhe u bë e devotshme dhe e sinqertë. Ajo qëndroi në adhurim ndaj Allahut dhe rrinte në vendfaljen e saj. Zekerija gjithmonë kur hynte në mihrabin (vendfaljen) e saj gjente ushqim dhe e pyeste se nga i vinte ai ushqim, sepse ajo nuk kishte njeri tjetër që kujdesej për të veç Zekerijas? Ndërsa ajo ia kthente: **“Ky (ushqim) është nga Allahu, se Allahu e furnizon kë të dojë, pa kufi”.** (Al Imran, 37)

D.m.th rizku i Zotit vjen me mënyrat që dihen, por edhe në forma të tjera dhe se Allahu ka fuqi për çdo send.

Ky rast i kujtoi (Zekerijas) butësinë e Allahut dhe shpresën tek mëshira e Tij, prandaj iu lut Allahut që t'i dhuronte një fëmijë që ta trashëgonte dijen dhe profetësinë dhe të qëndronte pas tij

tek beni Israilët në mësimin dhe udhëzimin e tyre. **“E ndërsa lutej në këmbë, në faltore, engjëjt e thirrën (Zekerijan): ‘Allahu të jep lajmin e mirë për Jahjan, i cili do të vërtetojë Fjalën e Allahut (Isain a.s.)’”**. (Al Imran, 39)

Ai **“do të jetë një fisnik”** pra njeri me vlera tek Allahu për shkak të virtyteve të larta që ka për t’i dhuruar, njohurive të shumta dhe veprave të mira.

“I dëlirë” d.m.th i ruajtur me mbrojtjen e Allahut dhe me mbikqyrjen e Tij për të mos rënë në mëkate. Allahu e cilësoi atë me mbarësi në të gjitha aspektet e mirësisë dhe të ruajtur nga të gjitha shkaqet e ligësisë dhe ky është kulmi i përsosmërisë së njeriut.

Zekerija u habit nga kjo që ndodhi dhe tha: **“O Zoti im, si mund të kem unë djalë, kur bashkëshortja ime është beronjë dhe unë kam arritur pleqërinë e thellë?!”** I tha: **“Ashtu ka thënë Zoti yt. Kjo për mua është lehtë. Unë të kam krijuar edhe ty më parë, ndërkohë që nuk ekzistojë”**. (Merjem, 8-9)

Kjo është më e çuditshme se shtatzania e saj edhe pse është beronjë dhe ti i thyer në moshë!

Prej gëzimit të madh dhe dëshirës që zemra e tij të qetësohej plotësisht (Zekerija) tha: **“O Zoti im, më jep ndonjë shenjë!”** (Merjem, 10)

Që të më tregojë se unë do të kem fëmijë. Ai tha: **“Shenja jote do të jetë se nuk do të mund të flasësh me njerëzit për tri net, ndonëse do të jesh i shëndoshë.”** (Merjem 10) **“Por, Zotin tënd përmende shumë dhe adhuroje Atë në mbrëmje dhe në mëngjes”**. (Al Imran 41)

Kjo ishte një shenjë e madhe, sepse e privoi nga e folura që është gjëja më e lehtë që mund të bëjë njeriu, në një kohë kur nuk vuante nga asgjë. Ai nuk u fliste dot të tjerëve veçse me shenja. Por prapë gjuha e tij lëvizte në përmendjen e Allahut të Lartësuar duke bërë tesbijh (subhanallah) dhe tahmijd (elhamdulillah). Përgëzimi nga Allahu u plotësua dhe ai e kuptoi se ajo gjë do të ndodhte patjetër dhe kështu gruaja e tij lindi Jahjan. Allahu e rriti në mënyrë të çuditshme, sepse mësoi paçka se ishte në moshë shumë të vogël dhe u dallua në dije edhe pse në atë moshë. Prandaj Allahu i Lartësuar e përmend duke thënë: **“Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri.”** (Merjem, 12)

Është thënë se Allahu e dërgoi si Profet në moshë të vogël ashtu sikurse i dha dije të madhe i dha edhe tipare të plota e të lavdëruara duke thënë: **“Butësi prej Nesh dhe dëlirësi. Ai ishte besimtar i përkushtuar dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm. Paqja qoftë mbi atë ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe ditën kur do të ringjallet.”** (Merjem, 13-15)

Këto tipare përmbledhnin: Cilësimin e tij si njeri që zbaton detyrimet ndaj Allahut, detyrimet ndaj prindërve dhe detyrimet ndaj njerëzve. Dhe se Allahu do t'i sillte të mbramen me mirësi në të gjitha aspektet e tij.

Ndërsa Merjemja u tërhoq nga familja e saj në një vend në lindje, e vetme për të adhuruar Zotin e saj. **“Duke e fshehur veten nga ata.”** (Merjem, 17)

Me qëllim që të mos e preukoponte asgjë tjetër. Në këtë moment Allahu i dërgoi shpirtin besnik, Xhibrilin, në formë njeriu, të plotë dhe të pashëm dhe ajo mendoi se ai donte

t'i bënte keq dhe tha: **“Unë kërkoj që të më mbrojë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh Allahut.”**
(Merjem, 18)

Ajo i kërkoj që në emër të Allahut ta mbronte dhe ta ruante duke i kujtuar domososhmërinë e devotshmërisë që duhet ta ketë çdokush që i frikësohet Zotit. Për shkak të kësaj devotshmërie të treguar nga Merjemja, në atë situatë, ku çdokush i druhet një sprove të tillë, u bë shkak që Allahu ta lartësonte pozitën e saj duke e cilësuar me ndershmëri të plotë dhe që e ruajti virgjërinë e saj.

Xhibrili i tha: **“Në të vërtetë, unë jam vetëm një i dërguar i Zotit tënd, që të të dhuroj ty një djalë të pastër.”** Ajo tha: **“Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e pacipë?!”** Iu përgjigj: **“Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’.** (Merjem, 19-21) **Për të për ty dhe për mbarë njerëzit. Dhe kjo është punë e kryer.”** (Merjem, 21)

Prandaj mos u habit nga caktimi i Zotit! **“Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët.** (Merjem, 22). D.m.th u largua nga njerëzit në një vend të largët nga frika se mos e akuzojnë dhe mos e lëndojnë.

Dhimbjet e lindjes e detyruan atë të shkonte tek trangu i një hurme. Ajo tha: **“Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!”** (Merjem, 23)

Sepse e dinte se çfarë do të thonin njerëzit për të dhe se ata nuk kishin për ta besuar, dhe nga ana tjetër nuk e dinte se çfarë do të bënte Allahu me të.

“Një zë (Engjëlli) e thirri nga poshtë” Sepse ishte duke qëndruar në një vend të lartë. **“Dhe i strehuam rrëzë një kodre të qetë me burime uji.”** (Muminunë, 50)

“Mos u pikëllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje! (Merjem, 24)

Pra një lum të rrjedhshëm.

“Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta! (Merjem, 25) Duke mos patur nevojë të ngjitesh lart mbi pemë **“që të bien mbi ty hurma të freskëta!”** (Merjem, 25) D.m.th të freskëta dhe të pjekura.

“Ha, pi dhe qetësohu.” Me lindjen e Isait që të largohet frika dhe pikëllimi.

“Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.” Tek ata ishte e njohur mënyra e adhurimit me heshtje gjatë gjithë ditës, prandaj e sqaroi me fjalën e Tij: **“Prandaj sot nuk do të flas me askënd.”** (Merjem, 26)

Zemra e saj u qetësua dhe ajo që ndjeu tashmë ishte larguar.

Pasi e kaloi periudhën e lehonisë e përmirësoi gjendjen e saj dhe u forcua pas lindjes **“U kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën.”** (Merjem, 27)

U shfaq haptazi, e pa frikësuar e as e shqetësuar. Kur e pa populli i saj ndërkohë që e dinin se ajo nuk kishte patur burrë, u bindën se atë foshnje e kishte sjellë në formë tjetër dhe thanë: **“O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.”** Ajo bëri me shenjë nga i biri.” (Merjem, 27-29)

Sepse kështu ishte urdhëruar (nga Zoti). Por në shenjë mospranimi të asaj që panë ata thanë: **“Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?”** (Merjem, 29)

Edhe pse kishte disa ditë që kishte lindur foshnja në atë gjendje ai filloi të flasë duke thënë: **“Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!”** (Merjem 30-33)

Këto fjalë që tha foshnja dhe në atë gjendje, ishin prej argumenteve më të forta të Allahut dhe prej fakteve të profetësisë së tij dhe se ai ishte rob i Allahut dhe jo siç pretendojnë të krishterët (se është bir i Zotit apo Zoti vetë). Me këtë rast edhe nëna e tij u pastrua nga akuzat ndaj të gjithë atyre që mund të mendonin keq, sepse edhe po të kishte sjellë një mijë dëshmitarë për të provuar ndershmërinë e saj, askush nuk do ta besonte. Por këto fjalë që tha Isai duke qenë në djep larguan të gjitha dyshimet që mund t’u kanoseshin zemrave të njerëzve.

Pas kësaj që ndodhi njerëzit u ndanë në tri grupe:

1- Një grup që i besoi dhe e vërtetuan fjalën e tij dhe iu bindën pas profetësisë. Këta ishin besimtarët e vërtetë.

2- Një grup tjetër i kaloi kufijtë dhe ata ishin të krishterët të cilët thanë për të fjalët e njohura tashmë duke e vënë atë (Isain) në pozitën e Zotit, qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar Ai mbi atë, që thonë ata!

3- Një grup i tretë e mohuan dhe u distancuan prej tij dhe këta ishin hebrejtë të cilët e akuzuan nënën e tij me diçka prej të cilës Allahu e kishte pastruar.

Për këtë arsye Allahu i Lartësuar tha: **“E megjithatë, sektet u përçanë në lidhje me atë. Mjerë ata që nuk besojnë për takimin e një Dite të madhe (Ditës së Kiametit)! (Merjem, 37)**

Në kohën kur Allahu e dërgoi si Pejgamber në mesin e Beni Israilëve, atij i besoi një grup njerëzish dhe e mohuan disa të tjerë. Ai u rrëfente njerëzve faktet, argumentat dhe mrekullitë e çuditshme. Prej baltës ai bënte formën e zogut, i frynte dhe ajo kthehej në shpend të vërtetë me lejen e Zotit. Kuronte ose shëronte lebrozën, verbërinë e lindur dhe qerosjen, si dhe ngjallte të vdekurit me lejen e Allahut. U tegonte për gjërat që hanin dhe magazinonin në shtëpitë e tyre.

E megjithatë, armiqtë e tij u mblodhën dhe deshën ta vrisnin, por Allahu ngjashmërinë e tij e hodhi tek njëri prej përkrahësve (shokëve) apo dikush tjetër dhe kështu Allahu e ngriti lart (në qiell) tek Ai duke e shpëtuar nga vrasja e tyre. Ndërkohë ata morën të ngjashmin e tij, e vranë dhe e kryqëzuan duke mbartur mbi vete mëkatin e madh dhe krimin e rëndë. Të krishterët e besuan se atë e kishin vrarë dhe e kishin kryqëzuar, por Allahu e nderoi nga një gjendje e tillë duke thënë: **“Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur.” (Nisa, 157)**

Isai i ftoi shumë Beni Israilët, i përgëzoi ata dhe u tregoi për profetësinë e Muhamedit (alejhi selam) por kur ai erdhi me shenjat që ata i njihnin shumë mirë, ashtu siç i njohin fëmijët e tyre, thanë: **“Kjo s’është gjë tjetër, veçse një magji e hapur.”** (En Amë, 7) Njësoj siç thanë për Isain: **“Atëherë kur u solle atyre prova të qarta e mohuesit në radhët e tyre thanë: ‘Kjo është vetëm magji e kulluar!’” (Maide, 110)**

Dobitë, mësimet dhe dispozitat që përfitohen nga kjo ngjarje!

1- Zotimi ka qenë i ligjëruar edhe tek popujt e mëparshëm. Profeti ynë Muhamedi (alejhi salam) për zotimin ka thënë një fjalë të përgjithshme dhe kuptimplotë, si për zotimin e saktë që duhet çuar në vend po ashtu edhe për zotimin e pavlefshëm duke thënë: “Ai që zotohet për t’iu bindur Allahut le t’i bindet Atij, e kush zotohet që ta kundërshtojë Allahun të mos e kundërshtojë atë.”⁴²

2- Prej mirësisë që Allahu i jep një rob i është kur e lë atë nën kujdesin e njerëzve të mirë e të zgjedhur.

Edukatori dhe kujdestari kanë ndikim të madh në jetën e atij që e kanë nën kujdestari si në vlera morale, po ashtu edhe në sjelljet e tij. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i urdhëron edukatorët që të edukojnë me më të mirën e mundshme dhe nxit për të edukuar me moral të bukur dhe ua tërheq vërejtjen nga veset.

3- Pohimi i mrekullive që u ndodhin njerëzve të dashur të Allahut, sepse Allahu e nderoi Merjemen me disa gjëra: Ia lehtësoi që të ishte në kujdestarinë e Zekerijas, madje pati dhe mosmarrveshje për këtë gjë.

E nderoi duke i sjellë furnizim nga nuk e priste dhe për të cilin nuk ishte lodhur.

E nderoi me prezencën e Isait, lindjen e tij dhe të folurën që i bëri engjëlli që e qetësoi zemrën e saj, pastaj me të folurën e Isait në djep dhe kjo e fundit ka përmbledhur mrekullinë e një njeriu të dashur dhe mrekullinë e një pejgamberi.

⁴² E përcjell Maliku në Mueta me nr. dhe prej tij e përcjell Imam Buhariu me nr 6696 nga Aisha (Allahu qoftë i kënaqur prej saj.)

4- Mësojmë mrekullitë e mëdha që Allahu solli përmes Isait (alejhi selam) në ngjalljen e të vdekurve, shërimin e lebrozëve, etj.

5- Nderimi që Allahu i bëri Isait kur i mundësoi të kishte shokë mbështetës dhe përkrahës të kauzës së tij në këtë jetë dhe pas largimit të tij. Ata ishin që përhapën thirrjen, ndihmuan fenë e Allahut dhe kjo ishte arsyeja që ndjekësit e tij u shumuan. Prej tyre pati të udhëzuar dhe ishin ata që i besuan me vërtetësi fesë së tij dhe u besuan të gjithë peygamberëve, por kishte edhe të humbur të cilët i kaluan kufijtë dhe këta janë shumica, të cilët pretendojnë se janë ndjekësit e tij edhe pse në realitet janë shumë larg rrugës së tij.

6- Allahu e lavdëroi Merjemen me cilësitë e saj të plota duke e quajtur të sinqertë dhe se ajo u besoi fjalëve të Zotit të saj dhe librave të Tij e ishte nga të devotshmit!

Këto ishin cilësitë e saj, dija e thellë, adhurimi i përhershëm dhe frikërespekti ndaj Allahut. Allahu e zgjodhi atë dhe i dha mirësi ndaj të gjitha grave të botës.

7- Lajmërimi që i dërguari i Allahut i bën kësaj historie apo historive të tjera në këtë mënyrë të detajuar dhe që janë në përputhje me realitetin, konsiderohen fakte të pakontestueshme që vërtetojnë profetësinë dhe vërtetësinë e peygamberllëkut të tij. Allahu i Lartësuar thotë: **“Këto janë lajme të fshehta, që po t’i shpallim ty (o Muhamed). Ti nuk ishe i pranishëm kur ata hodhën short se kush prej tyre do të merrte nën kujdes Merjemen dhe nuk ishe i pranishëm kur ata diskutonin.”**

(Al Imran, 44)



BANORËT E SHPELLËS⁴³

Ata ishin disa djelmosha monoteistë, që Zoti i kishte frymëzuar me iman (besim). Ata e njohën Zotin e tyre dhe e refuzuan atë që bënte populli i tyre prej adhurimit të idhujve, prandaj dolën mes tyre për të shfaqur besimin, por nga frika se mos populli i detyronte të hiqnin dorë, ata thanë: **“Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t’i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe.”** (Kehf, 14) D.m.th nëse i lutemi dikujt tjetër veç Tij **“Atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe.”** (Kehf, 14) D.m.th do të ishte gjë e kotë, shpifje dhe padrejtësi.

“Ky populli ynë ka zgjedhur në vend të Tij zota të tjerë, ndonëse ata nuk u sjellin dot asnjë provë të qartë. E kush është keqbërës më i madh, se ai që trillon gënjeshtër për Allahun?” (Kehf, 15)

⁴³ *Banorët e Shpellës* ishin disa të rinj monoteistë, të arratisur nga qyteti i tyre, për t’i shpëtuar persekutimit të një tirani pagan, që donte t’i detyronte të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Për të ruajtur pastërtinë e këtij besimi, ata u strehuan në një shpellë jashtë qytetit dhe iu dorëzuan mëshirës hyjnore. Allahu i Madhëruar i bëri të flenë për treqind vjet dhe i zgjoi, kur gjendja në qytet kishte ndryshuar: banorët e tij ishin bërë monoteistë dhe qyteti qeverisej nga një mbret i urtë e i devotshëm. Zgjimim e tyre Allahu e bëri mrekulli për banorët e qytetit (dhe për tërë njerëzimin) që vërtetonte ringjalljen e plotë, ngaqë ata ishin ndarë në dy grupe: njëri grup thoshte se ishte veç shpirti ai që ringjallej, kurse grupi tjetër thoshte se ringjallej edhe trupi.

Kur ranë dakort dhe panë se nuk e kanë të mundur të shfaqin fenë e tyre para popullit ata i kërkuan Allahut që t’jua lehtësojë çështjen duke thënë: **“O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!”** (Kehf, 10)

Ata u strehuan në një shpellë të cilën Zoti jua lehtësoi në mënyrën më të mirë, shpellë me zgavër të gjerë. Në hyrjen e shpellës me drejtim nga veriu nuk depërtonin rrezet e diellit, as në kohën e lindjes po ashtu edhe kur perëndonte. Ata fjetën në shpellë në mbrojtjen dhe kujdesin e Allahut për treqind e nëntë vite. Zoti i Lartësuar e kishte fortifikuar zonën e tyre me një farë frike (që njerëzit mos të afroheshin) edhe pse ishin afër me qytetin e popullit të tyre.

Edhe brenda në shpellë Allahu i mori nën mbikqyrjen e Tij. Ai thotë: **“Ne i rrotullonim ata herë në krah të djathtë e herë në të majtë.”**(Kehf, 18)

Ky rrotullim bëhej me qëllim që toka të mos i treste trupat e tyre. Pas kësaj periudhe të gjatë Ai i zgjoi: **“Kështu pra, Ne i zgjuam që të pyesnin njëri-tjetrin.”** (Kehf, 19) Me qëllim që në fund të bisedës të gjenin realitetin e asaj që kishte ndodhur: **“Njëri nga ata tha: ‘Sa keni ndenjur (në gjumë?)’ - U përgjigjën: ‘Kemi qëndruar një ditë a një pjesë të ditës’. Disa thanë: ‘Zoti juaj e di më mirë se sa keni ndenjur. Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën e le të shikojë se cili ushqim është më i pastër. Le t’ju sjellë diçka prej tij, le të sillet mirë dhe askush të mos marrë vesh për ju.’”** (Kehf, 19)

E deri në fund të historisë që përmendet në Kur’an.

Kjo histori përmban fakte të qarta dhe dobi të ndryshme

1- Historia e banorëve të shpellës edhe pse është e çuditshme, përsëri ajo nuk është prej fakteve më të çuditshme të Zotit, sepse Allahu sjell fakte mahnitëse dhe ndodhi që kanë në përbërje mësim dhe këshillë për ata që duan të marrin mësim.

2- Ai që strehohet tek Allahu, Ai e ruan atë, tregon mëshirë ndaj tij dhe e bën shkak për të udhëzuar të humburit. Allahu tregoi mëshirë ndaj djelmoshave në këtë gjumë të gjatë që ata bënë, sepse u ruajti imanin dhe trupat e tyre nga sprova e popullit dhe vrasja dhe e bëri këtë gjumë të gjatë prej argumenteve me të cilat kuptojmë forcën absolute të Allahut dhe shumëllojshmërinë e mirësisë së Tij dhe se njerëzit duhet ta dinë se premtimi i Allahut është i vërtetë.

3- Është nxittje për të përfituar dijet e dobishme dhe të bisedohet rreth tyre. Sepse Allahu i ngjalli pikërisht për këtë, pastaj me anë të kërkimit të tyre dhe asaj që kishin dëgjuar njerëzit për gjendjen e tyre u realizua argumentimi dhe dija se premtimi i Allahut është i vërtetë dhe se ora e fundit ka për të ardhur dhe për këtë nuk ka asnjë lloj dyshimi.

4- Mësojmë sjelljen që duhet të kemi kur i ngatërrojmë njohuritë dhe t'u kthehemi atyre që dimë dhe secili të qëndrojë brenda kufijve të njohurive që posedon.

5- Saktësia e ndërmjetësit në shitblerje dhe saktësia e ortakllëkut, kjo bazuar në fjalën e tyre: **Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën e le të shikojë se cili ushqim është më i pastër. Le t'ju sjellë diçka prej tij, le të sillet mirë dhe askush të mos marrë vesh për ju.**" (Kehf, 19)

6- Lejimi i konsumimit të gjërave të mira dhe përzgjedhjes mes ushqimeve nga ato që i përshtaten njeriut dhe përputhen

me shijet e tij, përderisa kjo nuk kalon në cakun e shpërdorimit të ndaluar. Kjo bazuar në fjalët e tyre: **“E le të shikojë se cili ushqim është më i pastër. Le t’ju sjellë diçka prej tij.”** (Kehf, 19)

7- Nxitja për të qenë të kujdesshëm dhe të ruajtur duke qëndruar larg vendeve që e sprovajnë njeriun në fenë e tij si dhe mundësinë e përdorimit të ruajtjes (fshehjes) e cila ia largon njeriut të keqen.

8- Mësojmë dëshirën e madhe të këtyre djelmoshave për fenë dhe largimin e tyre prej çdo sprove që cënonte fenë e tyre, duke braktisur atdheun, madje dhe çdo gjë për hir të Allahut.

9- Mësojmë se si e keqja përmbledh në vetvete shumë dëme dhe shkatërrime të cilat të ftojnë për ta braktisur një orë e më parë dhe se kjo është metoda e besimtarëve.

10- Fjala e Allahut që thotë: **“Ata që e fituan çështjen e tyre, thanë: ‘Ne do të ndërtojmë një faltore mbi ta!’”** (Kehf, 21)

Është argument se ai popull tek të cilët këta u ringjallën, ishin njerëz fetarë sepse i nderuan me këtë lloj nderimi derisa vendosën që mbi shpellën e tyre të ndërtonin një faltore. Ky veprim edhe pse është i ndaluar sidomos në sheriatin tonë, ajo që duam të tregojmë është: Të sqarojmë se frikën e madhe që i kishte kapur banorët e shpellës në kohën e besimit të tyre dhe hyrjen në shpellë Allahu ua zëvendësoi me siguri dhe nderime prej njerëzve dhe ky është ligji i Allahut. Sepse ai që duron ndaj vështirësive për hir të Tij, këtij njeriu fundin ka për tja bërë të lavdëruar.

10- Hulumtimet e tepërta dhe stërgjatjet në disa çështje që skanë shumë rëndësi nuk duhet të ndodhin dhe nuk duhet të jepemi pas tyre, kjo bazuar në fjalën e Zotit: **Dhe mos polemizo**

rreth tyre, përveçse në mënyrë të përciptë dhe për ata mos pyet askënd!” (Kehf, 22)

11- Të pyesësh dikë që nuk di në një çështje të caktuar, apo që nuk është i besueshëm, është veprim i ndaluar, bazuar në ajetin Kur'anor: **“Dhe për ata mos pyet askënd!”** (Kehf, 22)



HISTORIA E VULËS SË PEJGAMBERËVE

Muhamedi
(alejhi salatu ues selam)

Dije se historia e Profetit tonë Muhamedit (alejhi selam) konsiderohet ndihmësi më i madh për të kuptuar librin e Allahut. Kur’ani zbriste menjëherë pas rasteve që ndodhnin në historinë e tij dhe në bisedat që ai bënte me njerëzit si përgjigje ndaj fjalëve që i thuheshin, me qëllim që të realizohej e vërteta me të cilën ai u dërgua dhe të prishej e kota e atyre rrugëve për të cilat erdhi që ti shkatërrojë dhe kjo është prej urtësisë së zbritjes së Kur’anit pjesë-pjesë dhe jo në një kohë të vetme, siç e ka përmendur Allahu këtë kuptim duke thënë: **“Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu. Sapo ata të të sjellin çfarëdo argumenti, Ne të sjellim të Vërtetën dhe shpjegimin më të mirë.”** (Furkan, 32-33)

Gjithashtu ka thënë: **“Ne po t’i tregojmë ty disa nga historitë e të dërguarve, për të ta forcuar zemrën. Në këtë sure ty të ka ardhur e vërteta. Ajo është këshillë dhe kujtesë për besimtarët.”** (Hud, 120)

Atëherë le të vëmë në dukje prej historisë së tij:

1- Gjendjet dhe rastet e përshtatshme për zbritjen e disa ajeteve specifike.

2- Raste të ngjashme që kanë të bëjnë me dijet e Kur'anit e që ndihmojnë në këtë qëndrim:

- Nisur nga kjo themi se qëndrimi i parë që flet për zbritjen e Kur'anit tek ai është se para shpalljes atij i qe bërë i urryer adhurimi i idhujve. Ai urrente çdo fjalë të keqe dhe vepër e shëmtuar, pasi po përgatitej në natyrshmërinë e tij të pastër për të qenë i gatshëm në pranimin e të vërtetës qoftë në teori apo praktikë.

Allahu ishte Ai që ia pastroi zemrën, e lavdëroi dhe e plotësoi në virtyte, prandaj ai kishte dëshirë të madhe që të shkonte dhe të qëndronte tek shpella Hira për ditë të tëra (në formë adhurimi). Merrte me vete ushqim me të cilin ushqente fukarenjtë e atje veçohej dhe lutej. Zemra e tij ishte në kulmin e lidhjes me Zotin dhe praktikonte adhurime të cilat i kishte arritur përmes dijes së tij në atë kohë të mbushur me injorancë dhe të zbrazur nga dija, e megjithatë ai ishte në kulmin e mirësisë dhe bamirësisë me të tjerët.

- Kur i mbushi dyzet vite dhe arriti forcën e tij mendore e u bë i gatshëm për të mbartur mesazhin më të madh që Allahu kishte dërguar ndonjëherë tek krijesat, atij ju shfaq Xhibrili. Ai pa një skenë që e trembi shumë dhe nuk e la të qetë, sepse kurrë më parë nuk i kishte ndodhur diçka e tillë. Para kësaj ndodhie, Zoti i çonte ëndrra të cilat kur i shihte, ato realizoheshin si të ishin dritë e mëngjesit.

-Fjalët e para që i zbritën ishin: **“Lexo në emrin e Zotit tënd.”** (Alak, 1)

Me këto ajete i erdhi Xhibrili duke i thënë: “Lexo!” Por Profeti i tregoi se nuk dinte të lexonte d.m.th nuk e njihnte leximin. Siç ka treguar edhe Allahu në Kur’anin Famëlartë: **“Ai të gjeti të paudhëzuar dhe të udhëzoi.** (Duha 7) Këtë ajete e sqaron një tjetër ku Allahu i Lartësuar thotë: **“Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç’është besimi. Por atë (Kur’anin), Ne e bëmë dritë, me anë të së cilës udhëzojmë kë të duam nga robërit Tanë.”** (Shura, 52)

- Xhibrili e shtrëngoi atë dy ose tri herë që ta përgatiste për të pranuar Kur’anin Famëlartë, që zemra e tij të përqendrohej, po ashtu edhe ambicia bashkë me gjendjen e tij të dukshme e të fshehtë, për të mbartur këtë mesazh. Kështu zbriti kjo sure e cila njoftonte për profetësinë e tij.

Ai e urdhëroi që të lexonte në emrin e Zotit të tij. Aty vërehen llojet e ndryshme të mirësive që Zoti ia dha njeriut, kur i mësoi shkrimin dhe i dhuroi njohuritë, të folurën dhe shkrimin. Me këto fjalë që i zbritën ai vajti tek Hatixhja. Profeti ishte i frikësuar, këmbët i dridheshin dhe në këtë gjendje i tregoi asaj se çfarë kishte pare. Hatixhja i tha: “Përgëzohu vetëm me të mira se vallahi Zoti ty nuk ka për të përçmuar asnjëherë, sepse ti i mban lidhjet farefisnore, respekton mysafirin, mban barrat e rënda, ushqen të varfërin dhe ndihmon njerëzit në hallet e tyre.”⁴⁴

Që do të thotë se ai që është i stolisur me këto virtyte, atij vetëm sa i shtohen mirësitë e Zotit dhe ky ishte sukses nga Allahu për Hatixhen dhe Profetin e tij si dhe lehtësim për brengën që e kishte kapluar.

⁴⁴ E përcjell Buhariu me nr. 3, 4953,6982, si dhe Muslimi me nr. 160, 252 nga Aisha (Allahu qoftë i kënaqur prej saj).

- Me këtë sure filloi profetësia e tij dhe pas kësaj shpallja u ndërpre për disa kohë me qëllim që Profeti të permallohej për të dhe të ndikonte më shumë në zemrën e tij. Ai e kishte parë engjëllin në pamjen e tij reale dhe kjo e kishte shqetësuar shumë dhe përsëri kishte vajtur tek Hatixhja i frikësuar dhe duke u dridhur e duke i thënë: “Më mbuloni, më mbuloni.” Atëherë Allahu i Lartësuar zbriti ajetet: **“O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroji dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)!”** (Mudethir, 1-5)

Në këto ajete i erdhi urdhëri që të ftonte njerëzit dhe t'i paralajmëronte ata. Kështu që Profeti iu përvesh punës ambicioze dhe qëndroi i paepur në thirrjen e tij për tek Allahu edhe pse e dinte se do të kishte rezistencë nga të afërmit dhe të largët dhe do të haste kundërshtitë më të mëdha nga populli i tij apo të tjerët dhe vështirësi të shumta, e megjithatë Allahu e ndihmoi, e forcoi në ambiciet e tij dhe e përkrahu me gjallëri nga ana e Tij dhe me fenë që ia kishte shpallur.

- Më pas, e pikërisht në periudhën e ndërprejres së shpalljes kur përgënjeshtresit filluan të thonë: “Zoti e braktisi Muhamedin” atij ju shpall sureja Ed Duha:

“Betohem në shkëlqimin e paradites dhe në natën kur terret e qetësohet, se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)! Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë, e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur. A nuk ishte jetim e Ai të dha strehë? A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi? A nuk ishte nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt? Prandaj, mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shty me ashpërsi dhe tregoi dhuntitë e Zotit tënd!” (Duha, 1-11)

Kjo ishte një përkujdesje madhështore e Zotit për pejgamberin e Tij, mohim i çdo mangësie dhe përgëzim se çdo gjendje që ai po kalonte ishte shumë më e mirë se ato të mëparshmet dhe se Allahu do t'i jepte fitore, njerëz që do ta ndiqnin, krenari të madhe dhe do ta përhapte fenë e tij aq sa ai do të kënaqej.

Statusi më i lartë i mesazhit ishte ftesa në monoteizmin e pastër dhe ndalimi i asaj që bie ndesh me të. Ai i ftoi njerëzit në këtë, sepse Allahu në librin e Tij e ka pohuar këtë fakt me mënyra dhe forma të ndryshme dhe shumë të qarta, të cilat pohojnë domosdoshmërinë e monotezimit dhe mirësinë e tij, duke e bërë detyrë që të jetë rrugë për tek Allahu dhe xheneti (vendi i nderit). Nga ana tjetër hodhi poshtë idhujtarinë dhe udhët e dëmshme të saj, në forma të ndryshme të cilat i ka përmbledhur Kur'ani në shumicën e sureve Mekase.

Në këtë rrugë filluan t'i përgjigjeshin njerëzit njëri pas tjetrit, paçka se hasnin në pengesa të madha nga populli, të cilët bënë rezistencë në padrejtësitë e tyre dhe në nxitjen e të tjerëve. Ata synonin ta shuanin mesazhin e tij me seriozitetin më të madh qoftë përmes fjalëve apo veprave. Ndërsa ai dialogonte me ta, i sfidonte që të sillnin një Kur'an të ngjashëm edhe pse e dinin se ishte i sinkertë dhe besnik, por nga mendjemadhësia i mohonin dhe përgënjeshtrojnë argumentet e Allahut. Siç tregon Allahu i Lartësuar: **“Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut.”** (En'amë, 33)

Për këtë arsye, në momentin kur dëgjimin e Kur'anit e bënë në formë mohimi dhe përgënjeshtërimi duke u përqëndruar në urrejtjen dhe armiqësinë ndaj tij, Allahu tregoi se në zemrat e këtyre njerëzve kishte vendosur perde që të mos e kuptonin atë, ndërsa dëgjimet e tyre i kishte shurdhuar dhe se nuk kishin për tu udhëzuar për shkak të këtij rregulli që kishin themeluar e që pengonte nga çdo e mirë dhe udhëzim.

Prej këtu mësojmë urtësinë e Krijuesit se si i humbet të humburit dhe se kur ata zgjodhën për vetet e tyre humbjen dhe e deshën atë, ai i la në atë që zgjodhën dhe i la ashtu në humbjen e tyre të verbër. Po ashtu në momnetin kur ata e refuzuan mirësinë e Zotit kur u erdhi, Allahu ua përmbysi zemrat, i bëri të shurdhër dhe ua verboi shikimet dhe zemrat nga e vërteta.

Këto cilësi që i thamë, i ka përmendur Allahu në Librin e Tij dhe ndihmojnë në kuptimin e shumë ajeteve ku Allahu tregon për humbjen e tyre dhe se si ua kishte mbyllur rrugët e udhëzimit duke mos e pranuar gjendjen dhe zemrën e tyre për të vërtetën ndërkohë që mëkati ishte mëkati i tyre dhe ishin ata vetë shkaktarët e kësaj që u ndodhi. Allahu i Lartësuar thotë: **“Disa Ai i ka udhëzuar në rrugë të drejtë, kurse disa të tjerë e kanë merituar humbjen. Ata kanë zgjedhur djajtë për mbrojtës në vend të Allahut dhe mendojnë se janë në rrugë të drejtë.** (Arafë, 30)

Me të kundërtën e kësaj mëson urtësinë e udhëzimit që Zoti u ka dhënë besimtarëve, sepse në momentin kur ata u treguan të drejtë dhe nuk kishin si qëllim veçse të vërtetën dhe nuk synonin vetëm se kënaqësinë e Allahut, Allahu i udhëzoi me këtë Kur'an, si rjedhojë njohuritë e tyre u shtuan, po ashtu imani, udhëzimi dhe dijet e ndryshme. Allahu i Lartësuar thotë: **“Me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.”** (Maide, 16)

Ky cilësim i bukur i besimtarëve është themeli i udhëzimit të tyre, i shtimit të imanit dhe nënshtrimit ndaj Allahut dhe nga këtu hapet një derë për të kuptuar ajetet që flasin për tiparet e besimtarëve dhe mënyrën e shpejtë të përgjigjes së tyre ndaj të vërtetës qoftë në gjërat bazike apo edhe në degët e legjislacionit.

Qëndrimi i Profetit ndaj atyre që e përgënjeshtrojnë ishte se ai i ftonte me urtësi dhe këshillë të mirë dhe dialogonte me ta në formën më të bukur. I ftonte një nga një por edhe në grup, u kujtonte Kur'anin dhe ua lexonte gjatë namazit të tij dhe jashtë namazit. Ata kur e dëgjonin i mbyllnin veshët e ndoshta edhe e shanin atë që e zbriti Kur'anin. Zoti i Lartësuar i shpalli shumë ajete në këtë kuptim ku tregonte gjendjen e tyre në momnetin kur dëgjonin Kur'anin dhe largimin prej tij duke thënë: **“Sikur të ishin gomerë të egër e të frikësuar që ikin prej luanit?!”** (Mudethir, 50-51)

Djajtë e tyre dhe paria e të keqes menduan dhe vendosën, diskutuan se çfarë të thonin për Kur'anin dhe ta cilësonin me diçka që t'i largonin njerëzit prej tij. Aq sa i pari i tyre Uelid bin Mugira (me të cilin Zoti do të meret Vetë me të) tha: **“Ky (Kur'an) nuk është gjë tjetër, veçse magji e trashëguar! Këto janë vetëm fjalë të një vdekatare!”** (Mudethir, 24-25)

Por Allahu deshi që kjo fjalë (Kur'ani) të ngrihet lart mbi çdo fjalë tjetër dhe kjo e vërtetë të mposhtë çdo lloj të kote.

Prej shpifjeve të tyre rreth Kur'anit ishte se ata thonin për Kur'anin fjalë me kundërthënie. Kishte raste kur thonin është magji, disa herë thonin është fall, është poezi, janë legjenda, etj., duke u munduar t'i mveshin Kur'anit fame të keqe. E gjithë kjo për shkak të urrejtjes që digjte zemrat e tyre derisa thanë për të fjalë të çmendura. Sa herë që shprehnin një mendim prej këtyre mendimeve, Allahu zbriste ajete të cilat ua hidhnin poshtë fjalët dhe sqaronte poshtërishtë, shpifjet dhe kundërthëniet e fjalëve të tyre.

Këto ishin prej fakteve dhe argumenteve më të mëdha që vërtetonin mesazhin dhe profetësinë e Muhamedit (alejhis selam) dhe se Kur'ani ishte prej Allahut. Ai që vëren me kujdes

do të shohë se është armë kundër tyre dhe argumenti më i madh se ata po përballen me të vërtetën dhe po përpiqen që ta shuajnë atë dhe se ata vetë qëndronin me të kotën që nuk kishte pjesë në logjikë ashtu sikurse nuk kishte pjesë në fe.

Ata thonin për profetin disa fjalë që në fakt nuk e tregonin atë që e mendonin në vetet e tyre dhe që nuk ishin mangësi për të. Ata thonin se nëse Muhamedi do të ishte i singertë, Zoti do t'i sillte engjëj që të dëshmonin për të dhe do t'i mundësonte që të mos kishte nevojë të ecte nëpër tregje dhe të kërkonte rrizkun siç e kërkojnë të tjerët, ose do t'i bënte këtë apo atë, prej gjërave që u thonte mendja e tyre e prishur.

Këtë fakt Allahu e përmend në shumë vende në Kur'anin Fisnik:

- Në disa raste e përshkruan vetëm për robërit, sepse ai që mediton e kupton kotësinë e tyre dhe se ato nuk janë dyshime, e lëre më të jenë argumente të pranueshme.

- Disa herë të tjera e tregon dhe e sqaron kotësinë e tyre me gjëra të qarta dhe kjo përmendet shumë në Kur'an.

Qëndrimi i idhujtarëve ndaj Profetit (alejhi selam)

Ata mundoheshin në maksimum që të mos i fyente zotat apo të sulmonte fenë e tyre. Donin që ai t'i linte të qetë dhe ata ta linin të qetë, sepse e dinin shumë mirë se nëse ai fillonte t'i cilësonte zotat e tyre ai do të nxirrte në pah tiparet e mangëta që ata i kanë dhe faktin se këta idhuj nuk kanë asnjë lloj tipari që tu japë të drejtë adhurimi. Si rjedhojë, njerëzit do të ndërgegjësoheshin dhe do ta pranonin këtë fakt.

Prandaj gjëja me e dashur për ta ishte manipulimi dhe lënia e gjërave ashtu, pa patur nevojë për të kërkuar të vërtetën, sepse

e dinin shumë mirë se kur shfaqet e vërteta atëherë njerëzve u bëhet e qartë e kota e asaj që ndjekin dhe kësaj mundoheshin t'i fshihen dhe distancohen. Qëndrimin e tyre e përmend Allahu i Lartësuar në disa ajete si p.sh fjala e Allahut kur thotë: **“Ata dëshirojnë që ti të bësh lëshime, kështu që dhe ata të bëjnë lëshime.** (El Kalem, 9)

Ndërsa fjala e Allahut kur thotë: **“Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija.** (En'amë, 108)

Kjo nëse me sharjen e përmendur ndodh që ata të shajnë Allahun, në këtë rast lihet për shkak të së keqes që vjen si pasojë.

Qëndrimet e ndryshme të idhujtarëve ndaj Profetit (alejhi selam)

Ata i propozonin mrekullitë sipas dëshirave të tyre duke thënë: Nëse je i vërtetë në atë që thua atëherë na e sill dënimin e Zotit, ose na sill atë që na premton, ose hidhi mbi ne malet e Mekës ose bëj që aty të dalin lumenj dhe burime uji. Apo derisa të ndodh kjo apo ajo, kërkesa që i ka përmendur Allahu në Kur'anin Fisnik. Ndërsa Allahu ju përgjigjej fjalëve të tyre duke treguar se Profeti i Tij është i ndihmuar nga Zoti me argumente dhe fakte dhe vetëm Allahu e di se çfarë argumentesh i sjell dhe Ai e di shumë mirë se cila është më e dobishme për ta dhe se faktet për të vërtetuar sinqeritetin e tij janë mëse të dukshme dhe mëse të qarta.

Fjalët e idhujtarëve të paditur që shpreheshin duke thënë: Sikur të kishte këtë apo atë, s'ka dyshim se vijnë si pasojë e injorancës, mendjemadhësisë dhe mosbindjes së qartë dhe të hapur.

Në raste të tjera i lajmëronte se nuk e pengonte asgjë për t'i sjellë ato argumente (mrekulli) përveç faktit që ata të jetonin, sepse nëse do të shfaqeshin mrekullitë që ata kërkonin dhe përsëri nuk do të besonin, në këtë rast Allahu do t'i përpinte të gjithë me dënimin e Tij.

Në raste të tjera u sqaronte se Peygamberi është vetëm paralajmërues i qartë dhe nuk ka asgjë në dorë madje as në çështjen e mrekullive dhe se ato i takojnë vetëm Allahut. Kërkesa që ata i drejtonin Profetit ishte vetëm padrejtësi dhe arrogancë dhe këto kuptime në Kur'anin famëlartë janë të shumta dhe përmenden në forma të ndryshme.

Në raste të tjera cënonin Profetin duke shfaqur mospranim të asaj që kishte zgjedhur Allahu duke thënë se sikur ky Kur'an t'i ishte dhënë një burri të madh tek dy fshatrat, ndërsa Muhamedi nuk ishte i tillë. Dhe se ti o Muahmed nuk je më meritues i kësaj mirësie sesa ne, me çfarë mundi e ke merituar këtë shpallje hyjnore? E shumë fjalë të tjera që buronin nga smira.

Por Allahu u përgjigjej duke u kujtuar mirësinë e Tij dhe se atë ia dhuron kujt të dojë. Ndërsa profetësinë ai e di më mirë se kujt ia dhuron dhe vendin e duhur për të. Nga ana tjetër u tregonte tiparet dhe cilësitë e këtij Profeti që ata e shihnin me sytë e tyre dhe faktin që ata e dinin por edhe të tjerët, se ai njeri ishte njeriu më i madh në botë. Dhe se nuk ekzistonte dhe smund të ekzistonte njeri që t'i afrohej në përsosmëri dhe këtë duke argumentuar edhe me fakte të prekshme dhe argumente të prera. Të gjitha këto Allahu i ka shfaqur dhe ua ka përsëritur në shumë vende në Kur'anin famëlartë.

Qëndrimi i Profetit (alejhi selam) ndaj besimtarëve

Mëshira e madhe, butësia, dashuria e plotë dhe qëndrimi me ta në të gjitha çështet e tyre. Për besimtarët, ai ishte më i mëshirshëm dhe më i butë se prindërit e tyre dhe më i dhemshur se çdokush tjetër.

Siç e ka cilësuar Allahu i Lartësuar duke thënë: **“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët”** (Teube 128)

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur’anin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.” (Al Imran, 164)

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme.” (Al Imran, 159)

Ai vazhdoi të ftonte në monoteizëm dhe në bazat e fesë duke e vërtetuar këtë me argumente dhe fakte të ndryshme dhe nga ana tjetër tërhiqte vërejtjen nga idhujtaria dhe e keqja në përgjithësi qysh prej momentit që u dërgua si Profet e deri kur Zoti e plotësoi çështjen e tij. Dhjetë vite ai ftonte në rrugën e Zotit me fakte dhe argumente.

Pas kësaj atij i ndodhi ngjarja e Israsë (udhëtimit të natës) nga xhamia e shentjë për në xhaminë Aksa në Jeruzalem, me qëllim që t'i tregonte argumentet e Tij, pastaj e ngriti lart mbi shtatë qiejt dhe aty e obligoi me faljen e namazit, me kohët

dhe mënyrat. Menjëherë pas asaj ndodhie, i erdhi xhibrili dhe i mësoi kohët e namazit dhe mënyrën e faljes dhe u fal me të dy ditë:

Në ditën e parë, Xhibrili fali pesë kohët në fillimin e hyrjes së kohës.

Ditën e dytë erdhi dhe u fal në përfundim të kohës dhe i tha: Koha e namazit është mes këtyre dy vakteve (kohës kur hyn dhe kohës kur del).⁴⁵

Kështu namazi u bë obligim në pesë kohë dhe kjo tre vite para hixhretit, ndërsa ezani nuk ishte ligjësuar atë kohë e as shtyllat e tjera të Islamit dhe kështu Islami u përhap në Medine dhe vendet e tjera përreth.

Prej shkaqeve kryesore: Ishte se fiset Eus dhe Hazrexh kishin komshinj hebrejtë dhe ata i kishin njoftuar se ishin duke pritur një profet që i është afruar koha për t'u shfaqur. Ata kishin përmendur në sifatat e tij gjëra që i orientuan drejt Profetit (alejhi selam) kështu që Eusët dhe Hazrexhët nxituan dhe u takuan me Profetin (alejhi selam) në Mekë dhe u bindën se ai ishte i Dërguari i Allahut.

Ndërsa hebrenjtë i mundi e keqja dhe zilia sepse në momentin kur u erdhi ajo që e njihnin, ata e mohuan atë. (El Bekare, 89)

Në Mekë, muslimanët jetonin në vështirësi të madhe dhe përjetonin lëndime të mundishme nga Kurejshët. Profeti (alehi selam) i lejoi që të shpërnguleshin për herë të parë drejt Abisinisë. Por kur banorët e Medines pranuan Islamin, ndodhi hixhreti i madh për në Medine.

⁴⁵ E përcjell Ahmedi 1/333, Ebu Daudi me nr 393, Tirmidhiu me nr. 149 dhe e ka saktësuar ibn Huzjemeh 1/168 nga Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

Mekasit kur u frikësuan nga kjo që po ndodhte, i mbledhën paritë e tyre dhe kryetarët e fiseve në shtëpinë e mbledhjeve dhe i vunë vetes synim të vrisnin Profetin (alejhi selam). Mendimi i tyre ishte me dakortësi që të përzgjidhnin nga fiset kureshite nga një burrë trim dhe të fortë dhe të bëheshin bashkë për ta qëlluar me shpatë në të njëjtën kohë. Ata thanë: Me qëllim që gjaku i tij të shpërndahet tek të gjitha fiset dhe fisi i Profetit (beni Hashimët) ta kenë të pamundur që të përballen me të gjithë kurejshët dhe të detyrohen të marrin kompensimin me deve. **“Ata bënë plane por edhe Allahu bënte plane sepse Allahu është më i miri që thur plane.”** (Enfalë, 30)

Shpallja erdhi tek Profeti dhe ai u bë gati të emigronte drejt Medines

Ai e njoftoi Ebu Bekrin dhe kërkoi prej tij që ta shoqëronte. Ebu Bekri iu përgjigj ftesës së tij. Ata dolën pikërisht atë natë kur paria ishte bledhur për të thurur plane kundër tij dhe urdhëroi Aliun që të flinte mbi krevatin e vet, ndërsa ai bashkë me Ebu Bekrin dolën dhe u strehuan në shpellë. Ata (Kurejshët) po i prisnin derisa zbardhi mëngjesi, ndërkohë Aliu doli dhe ata e pyetën: Ku është shoku yt? Ai tha: Nuk e di.

Ata shkuan ta kërkonin në çdo drejtim dhe dhanë çmime të majme për atë që e gjen dhe e sjell. Vendi përreth shpellës ku ishte strehuar Profeti (alejhi selam) ishte mbushur me njerëz që vinin për ta kërkuar. Ebu Bekri i tha: “O i dërguari i Allahut nëse ndonjëri prej tyre do të shihte poshtë këmbëve të tij do të na zbulonte.” Ai e qetësoi duke i thënë: “O Ebu Bekr, si mendon për dy persona ku Allahu është i treti i tyre.”⁴⁶

Allahu i Lartësuar zbriti këto ajete: **“Nëse ju nuk e ndihmoni atë (Muhamedin a.s.), Allahu tashmë e ka ndihmuar ditën**

⁴⁶ E përcjell Buhariu me nr 3653, Muslimi me nr 2381.

kur atë e dëbuan mohuesit vetë të dytin, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): “Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!” Atëherë, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të, e ndihmoi me një ushtri të padukshme (engjëjsh) dhe bëri që fjala e mosbesimtarëve të jetë më e poshtëruara, kurse Fjala e Allahut të jetë më e lartësuar. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (Teube, 40)

Ai emigroi për në Medine. Atje qëndroi dhe më pas iu bë e lejuar lufta pasi që para hixhretit e kishte të ndalur, për një urtësi të dukshme. Allahu i Lartësuar tha: “**Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi dhe, në të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm, që t’i ndihmojë.**” (Haxh, 39)

Dhe kështu nisën edhe ekspeditat ushtarake.

Në vitin e dytë të hixhretit

Allahu bëri obligim zekatin dhe agjërimin. Ajetet që flasin për agjërimin dhe zekatin zbritën atë vit kur edhe u bënë obligim. Ndërsa fjala e Allahut që thotë: “**Mjerë për idhujtarët të cilët nuk e japin zekatin.**” (Fusilet, 6-7) Ka për qëllim zekatin e zemrës, pastërtinë e saj me monoteizëm dhe largimin prej shirkut (idhujtarisë).

Po në vitin e dytë të hixhretit ndodhi beteja e Bedrit dhe arsyeja e fillimit të kësaj beteje ishte se një karvan i Kurejshëve mbante mallin e një tregtie të madhe që vinte nga shami. Profeti (alejhi selam) doli vetëm me disa prej shokëve të tij në kërkim të këtij karvani, ndërsa nga ana tjetër Kurejshët dolën me ushtri të madhe për ta mbrojtur atë dhe u vendosën në Bedër, pa kurrfarë plani për të ndodhur betejë sepse edhe karvani kishte shpëtuar.

Ata u përballën me Profetin (alejhi selam) dhe me shokët e tij. Idhujtarët numronin njëmijë luftëtarë dhe kishin kolërësi, ndërsa Muslimanët ishin treqind e katërmbëdhjetë vetë dhe kishin me vete rreth 70 deve që i përdornin me radhë.

Allahu i mposhti rëndë idhujtarët, në atë betejë u vranë kokat e tyre dhe u zunë rob shumë prej tyre. Kjo ngjarje ishte tepër e rëndë për ta, sikur të mos u kishte ndodhur ndonjëherë fatkeqsi e tillë.

Për rastin e kësaj beteje dhe detajet e saj Allahu zbriti suren El Enfal.

Pasiqë u kthye në Medine si fitimtar dhe triumfues, shumë të tjerë prej atyre që s'kishin pranuar Islamin u ndjenë të poshtëruar dhe disa prej tyre e pranuan Islamin sipërfaqësisht. Për këtë arsye të gjitha ajetet që flasin për hipokritët kanë zbritur pas betejës së Bedrit.

Në vitin e tretë të hixhretit

Ndodhi beteja e Uhudit ku idhujtarët kishin sjellë ushtrinë për të sulmuar Muslimanët derisa arritën në periferi të Medines.

Profeti (alejhi selam) bashkë me shokët e tij dolën të përgatitur, të rreshtuar dhe u ballafaquan në Uhud, tek mali i njohur në veri të Medines. Në fillim të betejës fitorja dukej qartë në anën e Muslimanëve.

Por në momentin kur harkëtarët braktisën pozicionet e tyre të cilat ua kishte caktuar Profeti (alejhi selam) duke u thënë: “Mos lëvizni dhe mos i lini të pambrojtura shpinat tona, përndryshe do të thyhemi!” Me këtë që ndodhi erdhën kuajt dhe i sulmuan nga pas dhe ndodhi ajo që ndodhi me muslimanët në uhud, ku u vranë shumë prej atyre që Zoti i nderoi me gradën e shehidit

në rrugën e Tij. Allahu i përmendi detajet e kësaj beteje në suren Al-Imran dhe sqaroi të gjitha detajet e lidhura me të.

Leximi në librat e historisë që flasin për këtë betejë të ndihmon për të kuptuar shumë ajete Kur'anore që kanë zbritur rreth kësaj beteje, siç ka ndodhur edhe për betejat e tjera.

Në vitin e katërt të hixhretit

Muslimanët dhe idhujtarët kishin lënë vend takim Bedrin. Ndërkohë që Muslimanët erdhën në vendin e caktuar, idhujtarët munguan me preteksin se ai vit kishte mbajtur thatësi të madhe. Por Allahu e quajti këtë fitore për Muslimanët duke thënë: **“Ata u kthyen me dhuntitë dhe mirësitë e Allahut, nuk i gjeti asgjë e keqe dhe fituan kënaqësinë e Allahut. Allahu është Zotëruar i mirësive të mëdha.”** (Al imran, 174)

Në vitin e pestë të hixhretit

Ndodhi betejat e Hendekut. Banorët e hixhazit si dhe të Nexhdit bashkë me ndihmën që u dhanë beni Kurejdhat, u bënë bashkë për të sulmuar Profetin (alejhi selam). Ata mbledhën ushtarë sa mundën.

U mbledhën rreth dhjetë mijë luftëtarë dhe u nisën për kah Medina dhe kur Profeti dëgjoi për planin e tyre bëri një hendek mbrojtës përreth Medines.

Muslimanët dolën për tek Hendeku ndërsa idhujtarët erdhën ashtu siç i përkshkruan Allahu me fjalët e tij: **“Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt..”** (Ahzab, 10)

Ata e rrethuan Medinen për disa ditë, por hendeku i pengoi që të bënin përballje mes ushtrive. Aty ndodhën vetëm dyluftime të vogla mes individësh dhe kuajsh.

Allahu i Lartësuar bëri sebeb disa shkaqe për t'i poshtëruar idhujtarët ku më pas i mbloodhën gjërat dhe ikën nga kishin ardhur. U kthyen pa arritur asgjë dhe nuk morën atë që kishin synuar të mernin.

Pas kësaj Profeti (alejhi salam) u preokupua me fisin Hebre Beni Kurejdha, të cilët i kishin ndihmuar idhujtarët me fjalë dhe i kishin nxitur që të sulmonin Medinen. Pa lënë në harresë dhe ndihmën e tyre konkrete ndaj Kurejshëve dhe prishjen e marrëveshjes që patën me Profetin (alejhi salam).

Profeti (alejhi salam) i rrethoi dhe ata pranuan gjykimin e Saed bin Muadhrit i cili gjykoi që të vriten luftëtarët dhe të robëroheshin të tjerët.

Për këtë betejë Allahu i Lartësuar e filloi suren Ahzab duke thënë: **“O besimtarë! Kujtoni dhuntinë e Allahut kur ju erdhi një ushtri (idhujtarësh),⁴⁷ e Ne dërguam mbi ata erë dhe një ushtri (engjëjsh) që ju nuk e shihnit; ndërsa Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju. Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek Allahu u lëkund. Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e fuqishme. Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: ‘Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit!’ Dhe një grup prej tyre tha: ‘O banorët e Jethribit⁴⁸, s’ka qëndrim këtu për ju, andaj kthehuni!’ Një grup tjetër nga ata kërkoi leje prej të Dërguarit, duke thënë: ‘Në të vërtetë, shtëpitë tona janë të pambrojtura!’ Por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin. Sikur armiku t’i pushtonte ata nga**

⁴⁷ Behet fjalë për betejën e Hendekut, të zhvilluar në vitin 5 h / 627 e.s..

⁴⁸ Emri i Medinës para emigrimit të Profetit Muhamed (a.s.) në të.

të gjitha anët e t'u kërkonte që të bëheshin idhujtarë, ata do të bëheshin duke ngurruar fare pak. Ndërsa më parë i qenë betuar Allahut, se nuk do të zmbrapseshin. Për këtë besëlidhje me Allahun do të përgjigjen! Thuaju: 'Nuk do t'ju bëjë dobi të ikurit, nëse ikni prej vdekjes apo vrasjes. Edhe atëherë, ju do të kënaqeni vetëm për pak kohë!' Thuaju: 'Kush është ai, që do t'ju ruajë nga Allahu, nëse Ai dëshiron që t'ju godasë e keqja?! Kush mund ta pengojë Atë, nëse Ai do që t'ju japë mëshirë?!' Ata nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës tjetër, përveç Allahut. Allahu i njeh mirë ata midis jush, që pengojnë (të tjerët nga vajtja në luftë) dhe u thonë vëllezërve të tyre: 'Ejani te ne!' Vetëm pak prej tyre vijnë në luftë, por edhe atëherë ngurrojnë që t'ju ndihmojnë. Kur frikësohen, ata të shikojnë ty (o Muhamed) për ndihmë, duke i rrotulluar sytë sikur të ishin në agoni. Por, sapo t'u kalojë frika, ata ju sulmojnë me gjuhë të mprehtë dhe janë koprracë me ju për çfarëdo të mire. Këta janë ata që nuk kanë besuar, andaj Allahu i ka asgjësuar veprat e tyre. E, kjo për Allahun është lehtë. Ata mendonin se ende nuk kishte ikur ushtria e aleatëve e, nëse do vinte ushtria e aleatëve, ata do të dëshironin të ishin në mesin e arabëve të shkretëtirës e të pyesin për ju. Por edhe sikur të mbeteshin me ju, pak do të luftonin. Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun. Kur besimtarët e vërtetë panë ushtrinë e aleatëve, thanë: 'Kjo është ajo që na ka premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij; sigurisht, premtimi i tyre u vërtetua!' Kjo ua forcoi atyre besimin dhe përluljen. Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.

Nuk ka dyshim se Allahu do t'i shpërblejë të sinqertët për sinqeritetin e tyre e do t'i dënojë hipokritët, nëse do ose do t'u pranojë pendimin. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë. Allahu i zmbropsi jobesimtarët (e ushtrisë së aleatëve) me hidhërimin e tyre dhe ata dolën duarbosh. Ai i kurseu besimtarët nga lufta. Vërtet, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm. Ai i nxori nga kështjellat e tyre ithtarët e Librit që ndihmuan ushtrinë e aleatëve⁴⁹ dhe mbolli frikë në zemrat e tyre, kështu që një pjesë të tyre i vratë dhe pjesën tjetër i zutë rob. Ai ju bëri trashëgimtarë të tokës, shtëpive dhe pasurive të tyre, si dhe të një toke që nuk e kishit shkelur më parë⁵⁰; Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.” (Ahzab, 9-27)

Në vitin e gjashtë të hixhretit

Profeti (alejhi selam) u nis për të kryer umren bashkë me shokët e tij. Atë kohë Shtëpia e Shenjtë nuk ishte e ndaluar për askënd, por idhujtarët vendosën që ta pengonin Profetin (alejhi selam) nga Qabja.

Kur arriti në vendin e quajtur Hudejbije dhe pa që idhujtarët i kishte mbërthyer injoranca dhe kërkonin të luftonin, ai bëri me ta një marrëveshje paqeje për të ndaluar gjakderdhjen në vendin e shenjtë, pa harruar edhe dobitë e shumta që kishte në atë marrëveshje. Akti i paqes detyronte që Profeti të kthehej mbrapsht këtë herë dhe të mos hynte në Mekë dhe kjo të ndodhte vitin tjetër dhe lufta mes tyre të pushonte.

Shumica e muslimanëve nuk e pëlqyen këtë marrëveshje, sepse menduan se ka përçmim ndaj muslimanëve dhe nuk

⁴⁹ Ata ishin hebrenjtë e fisit Beni Kurejdha.

⁵⁰ Bëhet fjalë për oazin e Hajberit.

i kishin vënë re dobitë e shumta që vinin me anë të kësaj marrëveshjeje.

Ai (alejhi salatu ue selam) u rikthye vitin tjetër për të kryer umren dhe kjo ndodhi në vitin shtatë të hixhreit. Rreth kësaj ndodhie Allahu i Lartësuar zbriti suren El Fet'h të plotë ku e fillon më fjalët: **“Ne të dhamë ty një fitore të qartë.** (El Fet'h, 1)

Kjo fitore erdhi si rezultat i marrëveshjes që u mundësoi muslimanëve të ftonin njerëzit në Islam dhe kështu njerëzit të hynin në fenë e Zotit sidomos kur panë me sytë e tyre mirësinë, përmirësimin dhe dritën e kësaj feje.

Pak më parë folëm për rastin e fisit beni Kurejdha dhe atë e përfshim tek ndodhia e Hendekut. Ndërsa fisin Hebre Beni Nadir para kësaj ngjarje, kur deshën të vrisnin Profetin (alejhi selam) dhe jetonin në periferi të Medines. Profeti i sumoi dhe ata u fshehën në kështjellat e tyre, ndërsa hipokritët dhe aleatët e tyre u premtuan se do t'i përkrahnin.

Por Allahu hodhi frikë në zemrat e tyre dhe Profeti e pranoi dorëzimin e tyre me kusht që të braktisnin vendin dhe të mernin me vete aq sa mbanin devetë e tyre, ndërsa tokën, truallët dhe atë që nuk e mernin dot me vete, ua lanë muslimanëve.

Allahu i Lartësaur për këtë ngjarje zbriti ajete nga fillimi i sures Hashr duke thënë: **“Është Ai, që i nxori nga shtëpitë e tyre ata që nuk besuan midis ithtarëve të Librit në kohën e dëbimit të parë. Ju nuk mendonit se ata do të iknin, kurse ata mendonin se fortesat e tyre do t'i mbronin prej Allahut. Por dënimi i Allahut u erdhi andej nga nuk e pritnin, duke mbjellë në zemrat e tyre frikën, e cila bëri që ata t'i shkatërronin shtëpitë e veta me duart e tyre, si dhe me duart e besimtarëve. Prandaj, mësoni nga kjo, o ju largpamës!”** (Hashr, 2)

Në vitin e tetë të hixhretit

Kurejshët e kishin prishur marrëveshjen që patën me Profetin (alejhi salam) kështu që Profeti u nis drejt Mekës me një ushtri shumë të madhe muslimane, afërsisht me dhjetë mijë luftëtarë dhe hyri në Mekë si çlirimtar!

Këtë ai e plotësoi me luftën e Hunejnit ndaj fiseve Hauazin dhe Thekijf dhe me këtë u plotësua fitorja dhe ndihma e Allahut ndaj Profetit dhe Muslimanëve. Për këtë ngjarje Allahu zbriti ajete në fillimin e sures Teube.

Në vitin e nëntë të hixhretit

Profeti (alejhi salam) u nis për në Tebuk dhe i nxiti muslimanët që të shkonin bashkë me të. Prej kësaj beteje nuk munguan vetëm se njerëzit me arsye, ose hipokritët si dhe tre burra nga të mirët e muslimanëve, Keab bin Maliku dhe dy shokët e tij.

Koha e nisjes ishte në një periudhë shumë të nxehtë dhe armiku ishte i madh në numër dhe përgatitja ishte e dobët. Ai mbërriti në Tebuk dhe qëndroi atje njëzet ditë dhe nuk pati përballje kështu që u kthye përsëri në Medine.

Allahu i Lartësuar për këtë betejë zbriti ajete të shumta nga surja Teube, ku tregon në detaje vështirësinë e saj, i lëvdon besimtarët dhe i nënçmon hipokritët dhe mungesën e tyre. Përmend pendimin e pranuar ndaj Profetit, muhaxhirëve dhe ensarëve, të cilën e ndoqën në këtë moment të vështirë dhe bashkë me ta edhe pendimin e atyre tre burrave që munguan. Kjo ndodhi pasi që u penduan dhe u kthyen për mëkatën që kishin bërë.

Në gërshetimet e këtyre betejave, Zoti i Lartësuar përkujton ajetet e luftës, obligimin, vlerën dhe shpërblimin e saj dhe atë që i pret prej poshtërisë dhe dënimit të mëvonshëm ata që zbrapsen prej saj.

Po ashtu në këtë periudhë Allahu i Lartësuar zbriste dispozitat fetare njëra pas tjetrës, siç e kërkonte urtësia e Tij.

Në vitin e nëntë të hixhretit apo edhe në vitin e dhjetë

Allahu i Lartësuar e bëri obligim kryerjen e haxhit për Muslimanët, ndërkohë që Ebu Bekri u kishte prirë njerëzve në haxhin e vitit të nëntë duke prishur marrveshjet e atyre idhujtarëve që si kishin mbajtur dhe duke i plotësuar marrëveshjet me ata që si kishin thyer.

Pas kësaj Profeti (alejhi selam) bëri haxhin bashkë me muslimanët në vitin e dhjetë dhe muslimanët mësuan prej tij dhe ai u mësoi ritet e haxhit dhe të umres, me fjalë dhe me vepra.

Allahu i Lartësuar zbriti ajete që flisnin për haxhin dhe dispozitat e tij, ndërsa në ditën e Arafatit Allahu zbriti këtë ajet: **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.”** (Maide, 3)

Nuk mbeti njohuri e dobishme pa ua mësuar atyre, sepse Kur’ani është sqarues për çdo gjë.

Dijet bazë, dijet e degëve, dispozitat, njohuritë e etikës dhe moralit, njohuritë rreth universit dhe çdo gjë për të cilën njerëzit kanë nevojë, prej asaj dite e derisa të bëhet Kijameti do ta gjejnë në Kur’an të sqaruar dhe aty kanë për tu orientuar.

Tek ai kthehet çdo gjë që ka të bëjë me realitetin fetar dhe logjik.

Nuk është e mundur që të vijë një dije e saktë që nuk preket me shqisa dhe nuk e kap logjika që të hedhë poshtë diçka me të cilën erdhi Kur’ani, sepse: **“Atij nuk mund t’i afrohet gënjeshtria nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.”** (Fusilet, 42)

“A nuk përsiatin ata për Kur’anin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”
(Nisa, 82)

“Në të vërtetë, ky Kur’an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.” (Isra, 9)

“Allahu thotë të vërtetën dhe udhëzon në rrugë të drejtë.”
(Ahzab, 4)

